

**Dr. Naser Ramadani**



**ETIKA E  
RELIGJIONEVE  
për klasën e V**

Shkup, 2010

**Komisioni recensues:**

- Doc. dr. Svetllana Kamxhijash - kryetar
- Mr. Gordana Nikcevska - zëvendës kryetar
- Dushanka Golluboviq Neshovska - anëtar

**Lektor:**

dr. Ismet Osmani

**Disenji:**

Besnik Hamiti

**Botues:**

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

**U shtyp në shtypshkronjën:**

Grafički centar - Shkup

**Tirazhi:** 1.000 kopje

**Me vendrimin nr. 22-4032/1 nga 29.06.2010 nga Ministri për arsim  
dhe shkencë në Republikën e Maqedonisë, ky tekst mësimor aprovohet  
për përdorim në shkollat fillore të Republikës së Maqedonisë.**

**CIP - Каталогизација во публикација Национална и универзитетска  
библиотека "Св.Климент Охридски" , Скопје 373.3.016:241(075.2)=163.3  
РАМАДАНИ, Насер Етиката во религиите за V одделение / Насер  
Рамадани. - Скопје :Министерство за образование и наука на Република  
Македонија, 2010. - 113  
стр. : илустр. ; 24 см**

**ISBN 978-608-226-008-2**

**COBISS.MK-ID 84092682**



Bismillahirr-rrahmanirr-rrahim

"Lexo me emrin e Zotit tënd,  
I Cili krijoi (çdo gjë).

Krijoi njeriun prej një gjaku të ngjizur.

Lexo! Se Zoti yt është më bujari!

Ai që e mësoi (njeriun) të shkruaj me penë.

I mësoi njeriut atë që nuk e dinte".

## PARATHËNIE

Të nderuar nxënës dhe nxënëse!

Gjatë këtij viti shkollor, krahas lëndëve tjera, do të mësohet edhe lënda 'Etika e religjioneve'. Etika dhe morali zënë vend të rëndësishëm në të gjitha religjionet monoteiste. Për këtë shkak, etika fetare është pjesë e pandashme e jetës së besimtarëve. Ajo është prezent në familje, në rrugë, në shkollë dhe në vende të tjera. Duke e falënderuar Zotin e Madhërisë, prej këtij viti, etika e religjioneve do të jetë lëndë mësimi edhe nëpër shkolla, me ç'rast për së afërm do të mund të njiheni me mësimet kryesore të etikës së religjioneve.

Ky tekost shkollor është i ndarë në tri pjesë. Në pjesën e parë do të mësoni në përgjithësi për etikën, duke përfshirë këtu: përbajtjen e etikës, rëndësinë e etikës, standardet etike, moralin, sjelljen morale dhe mirësjelljen si vlerë më e lartë etike.

Në pjesën e dytë do të mësoni për etikën te religjionet tjera. Më së pari do të mësoni për principet e përbashkëta të mësimeve fetare, pastaj pasuesit e secilit religzion do të mësojnë për etikën e religjioneve tjera. Kështu, nxënësit myslimanë do të mësojnë për etikën në mësimet ortodokse, katolike, hebraike dhe evangjeliste – metodiste, derisa nxënësit pjesëtarë të religjioneve tjera do të mësojnë për etikën në mësimet e fesë islamë.

Në pjesën e tretë të këtij teksti shkollor, pjesëtarët e secilës fe më gjërësish do të mësojnë për etikën e mësimeve të fesë të cilës i takojnë. Kështu, nxënësit myslimanë do të mësojnë për tri tema. Në temën e parë mësohet për bazat teorike të islamit, duke i përfshirë leksionet në vijim: Allahu xh.sh. në mësimet islamë, Muhammedi a.s. në mësimet islamë, Kurani në mësimet islamë, shtyllat e islamit në mësimet islamë, pastërtia në mësimet islamë, falja e namazit, zeqati, agjërimi dhe haxhi në mësimet islamë. Në temën e dytë do të mësoni për bazat etike të islamit, duke e përfshirë etikën islamë në shkollë, në familje, në punë, gjatë përshëndetjes, në xhami si dhe morali i individit në shoqëri. Në temën e tretë do të mësoni për bazat e moralit islam, duke përfshirë këtu cilësitë e besimtarit të mirë, ruajtja prej veprave të këqija, pendimi prej veprave të këqija, sjellja islamë nëpër festa dhe në fund do të mësoni përfestat dhe përhumanizmin e njeriut.

Qëllimi kryesor i kësaj lënde është që në mënyrë sistematike nxënësit në përgjithësi të njihen me etikën, pastaj me etikën në religjionet tjera dhe më në fund, me etikën e religjionit të cilit i takojnë. E gjithë kjo është bërë me qëllim që nxënësit të njihen me vlerat etike si dhe t'i praktikojnë ato në jetën e tyre të përditshme.

Allahu ju ndihmoftë në mësimin e këtyre njësive mësimore dhe në praktikimin e tyre.

Autori

# ETIKA

## Nacioni i etikës

Etika është shkenca që studion moralin. Të dyja nocionet, *etika* dhe *moral* kanë kuptim të njëjtë. Ato shpjegojnë mënyrën e sjelljes së njeriut.

Etika, fillimisht, u paraqit në kuadër të filozofisë, e më vonë u paraqit edhe në teologji. Sot ajo ekziston si shkencë filozofike, por edhe si shkencë teologjike. Etika studion dhe vlerëson vlerat morale. Me vlera morale nënkuftojmë gjërat që i çmojmë dhe që janë të rëndësishme në jetën e njerëzve, si për shembull: dashuria, shëndeti, paqja, miqësia e të ngjashme. Etika na mëson se si duhet të mendojmë drejt, se si të sillemi, se si të bëjmë vepra të mira, se si të kujdesemi për të tjerët dhe, në përgjithësi, na mëson të bëjmë gjithmonë vetëm gjëra të mira.

Fjala etikë rrjedh prej fjalës greke *etos* që do të thotë *traditë* ose *karakter moral*.

Duhet ta kemi gjithmonë parasysh se e mirë është çdo gjë që nuk i lëndon njerëzit e tjerë, madje, përkundrazi, i bën ata që ta ndiejnë veten të lumtur dhe të kënaqur. Për këtë shkak, duhet të jemi gjithnjë të kujdeshëm përfundimisht për fjalët ose veprat tonë, me qëllim që mos t'i lëndojmë kurrë njerëzit e tjerë. Nëse veprojmë kështu, atëherë gjykimi dhe sjellja jonë do të jetë etike.

Meqë etika merret me studimin e moralit të njeriut, mund të themi se lënda të cilën ajo studion është sjellja e njeriut. Ajo ofron rregulla se si njeriu duhet të sillët mirë. Këto rregulla i quajmë norma etike ose morale.

Dituria që fitojmë duke mësuar etikën mund të ndikojë tek ne. Ajo mund ta orientojë sjelljen tonë përfundimisht ndonjë njojje të madhe teorike, por që ne të mendojmë, të gjykojmë dhe të arrijmë shprehi përfundimisht një sjellje të mirë.



## Gjykimi etik

Njerëz të ndryshëm i vlerësojnë disa gjëra të caktuara në mënyra të ndryshme dhe, për këtë shkak, shpeshherë ndodh që të ketë mosmarrëveshje rrith asaj se çka është e mirë dhe çka nuk është e mirë. Ligjet sociale, zakonet dhe traditat, nëpër vende të ndryshme, mund të jenë të ndryshme. Për këtë arsy, rregullat etike mund të dallojnë ndërmjet njerëzve, varësisht nga kultura e tyre, apo nga shoqëria në të cilën jetojnë.

### Si të marrim vendime të duhura etike?



Për të mos u çorientuar kur jemi në dilemë se a jemi duke vepruar drejt apo jo, gjithmonë duhet të mendojmë dhe të udhëhiqemi prej parimeve që vijojnë:

- ajo që bëjmë dhe që na sjell lumturi duhet të jetë gjithnjë me vend.
- duhet t'i kemi gjithnjë parasysh pasojat e sjelljes sonë ndaj njerëzve të tjera.
- gjithmonë duhet të mendojmë se si të veprojmë drejt.
- veprimi ynë duhet të jetë i sinqertë, i ndershëm dhe i drejtë.
- nuk duhet ta lëndojmë askënd me sjelljen tonë.

### Përfundime të gabuara etike

Nëse mendojmë në mënyrat e mëposhtme, ka mundësi të arrijmë në përfundime të gabuara etike:

- nëse është e domosdoshme, atëherë është etike
- nëse nuk dënohet, atëherë është e drejtë
- kam pasur arsyе personale që ta bëja atë
- atë e kam bërë për ty, pavarësisht nga pasojat
- të gjithë e bëjnë këtë, pse të mos e bëj edhe unë?
- ashtu më erdhi që të veproja
- është në rregull nëse unë nuk humbas asgjë me këtë

**Lexojini tregimet lidhur me përjetimet e Fatimes dhe Aliut. Çfarë mendoni, cili prej tyre ka vepruar në mënyrë të drejtë etike, e cili jo? Pse?**

1. Fatimja: Arsimtarja e gjuhës shqipe na dha detyrë shtëpie të shkruajmë rrith temës: "Pranvera në qytetin tim." Unë, sinqerisht, kisha harruar se mësuesja na kishte dhënë detyra shtëpie. Në orën e gjuhës shqipe nuk i tregova mësueses se nuk i kisha bërë detyrat e shtëpisë, duke



menduar se arsimtarja nuk do të më pyeste pikërisht mua që ta lexoja përbajtjen. Mirëpo, ndodhi pikërisht ajo që nuk e prisja. Arsimtarja kërkoi prej meje që t'i lexoja detyrat e shtëpisë. Unë e hapa fletoren dhe fillova të flisja rreth temës "Pranvera në qytetin tim", duke u shtirur se isha duke lexuar në fletore. Thashë disa fjali, të cilat me siguri do të ishin më të mira sikur të isha përpjekur që t'i mendoja dhe t'i formuloja në shtëpi. Më në fund, disi dola nga situata. Mendoj se arsimtarja nuk e vërejti se unë nuk i kisha bërë detyrat e shtëpisë. Pasi kaloi e gjithë kjo, unë e ndiej veten shumë keq, por mendoj se nuk e kam lënduar askënd me veprimin tim dhe se unë kisha arsyë që të veproja ashtu.

2. Aliu: Sot është një ditë e lumtur për mua. Babai im u kthyte prej udhëtitimit dhe më solli dy fanella të dy futbollistëve të mi të preferuar. U gëzova shumë. Nuk dija cilën ta vishja për në stërvitje, kështu që vendosa që t'i merrja të dyja që të lavdërohesha para shokëve. Shokët u mahnitën shumë kur i panë fanellat. Të gjithë filluan të flisnin për fanellat që kishin dhe se cilave klube futbollistike i përkisnin ato. Vetëm Feridi heshte. Mendova me vete se, me siguri, atij nuk po i pëlqenin fanellat e mia. Shkova që ta pyesja se a i pëlqenin apo jo, kurse ai më tha:



-Kuptohet se po! Ata janë futbollistët e mi të preferuar... Edhe unë do të doja që të vishja një fanellë të tillë, mirëpo ... babai im mezi ia del që të ma paguajë trajnimin përfutboll, kështu që nuk do të ishte me vend që unë të kërkoja prej tij që të më blinte diçka që nuk është e domosdoshme...

Më pas, e pyeta atë se a dëshironë që të vishte njërin prej fanellave të mia gjatë kohës së stërvitjes. Sytë e Feridit shkëlqyen nga gëzimi, ashtu që prej gëzimit të tij nuk munda të mos i them:

-Në të vërtetë, po ta dhuroj!

Ndoshta për një moment u mërzita pak që mora një vendim të tillë përfundim t'i ia dhuruar fanellën time të preferuar, mirëpo gëzimi i Feridit ishte aq i madh, saqë pikëllimi im zgjati vetëm një moment dhe lumturia e shokut tim "më infektoi" edhe mua. Përfundimisht se sot është një ditë e lumtur për mua!

**A mund të tregosh edhe ti një përjetim të tillë të ngjashëm?**

## Etika dhe shoqëria

Gjithçka që është etike nuk është e shkruar gjithmonë në ligjin e shoqërisë. Për shembull, etike është që të themi të vërtetën dhe që të mos gënjejmë, por gënjeshtra jo gjithmonë dënohet sipas ligjit. Nëse gënjejmë, nuk do të ndihemi mirë dhe tërë kohën do të kemi frikë se dikush do ta zbulojë gënjeshtren tonë. Nëse e zbulojnë gënjeshtren tonë, edhe pse ndoshta nuk do të dënohem me ligj, prapëseprapë, në mënyrë verbale (me fjalë), do të gjyko hemi për sjelljen tonë jo morale prej njerëzve të cilët i kemi gënjiyer dhe kështu do ta humbasim besimin e tyre.

Ekziston një numër i madh rregullash etike që nuk janë të shkruara, të cilave ne duhet t'i u përbahemi, por, po ashtu, ka edhe shumë rregulla etike që janë të detyrueshme për t'u respektuar dhe për shkeljen e të cilave njerëzit janë përgjegjës para ligjit të shtetit. Kështu për shembull, për aktin e vjedhjes dhe për ushtrimin e dhunës, njerëzit dënohen sipas ligjit të shtetit.

### Aktivitete

Zhvillohen biseda në lidhje me kuptimin e nocionit etikë, duke përdorur tekste dhe ilustrime përmarrëdhëniet ndërmjet njerëzve.

### Le të mendojmë dhe le të bisedojmë

1. Çka studion etika si shkencë?
2. Çka janë vlerat morale?
3. Çfarë duhet të bëjmë kur mendojmë se po veprojmë drejt në mënyrë etike?
4. Kur është e mundshme të sjellim përfundime të gabuara etike?
5. Pse duhet t'i respektojmë rregullat etike që nuk janë përcaktuar me ligj?
6. Çfarë do të ndodhë sikur të mos ekzistonin rregullat etike të sjelljes së njerëzve në shoqëri?



## KUPTIMI I ETIKËS

Etika është shkencë edukative-arsimore e cila ka për qëllim që t'i ndihmojë njerëzit në formimin e karakterit të tyre. Ajo përmban rregulla ose ligje që u shërbejnë njerëzve për t'u sjellë në mënyrë të drejtë në familje, në shkollë, në shoqëri, në natyrë dhe gjithkund në përgjithësi. Sikur të mos ekzistonin rregulla të tillë, atëherë njerëzit do të bënin vetëm atë që dëshironin dhe jo atë që duhet të bënin dhe kështu, shumë shpejt, bota do të zhytej në një kaos të përgjithshëm.

Jeta e njerëzve në bashkësi nuk do të ishte e mundur nëse të gjithë njerëzit do të vidhnin, do të gjenjen ose do të bënin gjëra që do të ishin të mira vetëm për ata. Për këtë shkak, ekzistojnë standarde etike ose kodekse të sjelljes, të cilat njerëzit duhet t'i respektojnë, me qëllim që të jetojnë në harmoni me të gjithë njerëzit e bashkësisë.

### STANDARDET ETIKE

Etika studion vlerat themelore dhe qëllimet e jetës së njeriut: të mirën, të keqen, lumturinë, dashurinë, drejtësinë, ndershmërinë, të vërtetën etj. Ajo përmban standarde të formuluara mirë për atë se çka është e drejtë e çka është e gabuar. Ajo përcakton se çka është e mirë dhe se çka duhet të bëjnë njerëzit në raport me të drejtat, me obligimet, në raport me dobinë e shoqërisë, me drejtësinë apo në raport me disa virtyte të tjera. Për shembull, etika ka të bëjë me ato standarde që kërkojnë obligime të arsyeshme dhe të përbajturit e njerëzve nga gjenjeshta, përgojimi, vjedhja, dhuna, vrasja, mashtimi e të ngjashme. Standardet etike kërkojnë gjithashtu virtytet e sinqeritetit, ngushëllimit dhe lojalitetit të njeriut. Ato ekzistojnë në të gjitha lëmenjtë e veprimtarisë së njeriut dhe mund t'i quajmë edhe kodekse të sjelljes. Ekzistojnë kodekse të përcaktuara të sjelljes së punëtorëve shëndetësorë, të gazetarëve, të arsimtarëve, etj. Po ashtu, ekziston kodeksi etik në shkencë, në biznes dhe në të gjitha profesionet e tjera. Gjithashtu, ekzistojnë edhe kodekse të sjelljes së nxënësve nëpër shkolla. Këto janë rregulla sjelljeje të cilat duhet t'i dijë dhe t'i përdorë secili nxënës.

### Kodeksi i sjelljes së nxënësve nëpër shkolla

Nxënësi duhet të ketë një imazh të qartë të pozitës dhe rolit të tij në familje, në shkollë dhe në shoqëri. Ai duhet t'i dijë të drejtat dhe përgjegjësitë e tij dhe duhet t'u përshtatet atyre.

Çdo nxënës duhet të jetë i respektuar si personalitet i mëvetësishëm, pa marrë parasysh

aftësinë, talentin, gjininë, racën, kulturën, traditën, pozitën sociale, përkatësinë nacionale apo fetare të tij, e të ngjashme.

Nxënësi duhet:

- të kujdeset gjithnjë që të arrijë rezultate të mira
- të jetë i përgjegjshëm
- të ketë sjellje shembulllore
- të kujdeset gjithmonë dhe gjithkund përfjalon e tij, me qëllim që ai të jetë i qartë dhe me edukatë

-të shërbejë gjithmonë si shembull me pamjen e tij  
 -të kujdeset për sjelljen e tij morale  
 -të rritet si një personalitet tek i cili mund të ketë besim kushdo  
 -të ketë përgjegjësi ndaj mjeteve me të cilat punon dhe mëson  
 -të luftojë kundër shkaktarëve të sëmundjeve të varësisë dhe dukurive të tjera negative (droga, alkooli, duhani, kriminaliteti...)  
 -të vijë rregullisht dhe me kohë në orët e mësimit  
 -të jetë gjithmonë i përgatitur për punë dhe për aktivitete  
 -të kujdeset dhe të kontribuojë për ndërtimin e raporteve pozitive me të gjithë nxënësit, në bazë të miqësisë  
 -të përbahet prej përgojimit  
 -të jetë solidar me shokët e tij, posaçërisht kur bëhet fjalë për disa probleme sociale ose shëndetësore  
 -t'i ndihmojë nxënësve të tjerë, duke ua transmetuar dituritë e tij  
 -t'i respektojë arsimtarët dhe të gjithë të punësuarit në shkollë  
 -të mos përdorë fjalë ofenduese dhe jo të hijshme  
 -të jetë i sinqertë dhe lojal ndaj vetes dhe ndaj të tjerëve  
 -t'i informojë me kohë prindërit për punën dhe sjelljen e tij në shkollë  
 -t'i përbahet rendit të brendshëm të shkollës  
 -të kujdeset për shëndetin personal dhe për sigurinë në shkollë dhe jashtë saj dhe të mos e rrezikojë shëndetin dhe sigurinë e nxënësve të tjerë



### Le të mendojmë dhe le të bisedojmë

1. Çfarë rregulla përban etika?
2. Pse nevojitet të ekzistojnë standarde etike ose kodekse të sjelljes?
3. Prej çka duhet të përbahemi me qëllim që të sillemi në mënyrë etike?
4. Numëroji disa shembuj të sjelljes së mirë të nxënësit.
5. Numëroji disa shembuj të sjelljes jo etike.

## Ditari im i sjelljes shembullore

Sot...	E hënë	E martë	E mërkurë	E enjte	E premtë
Kam ardhur me kohë në shkollë					
Isha prezent në të gjitha orët					
E kam ndjekur mësimin me kujdes					
Nuk kam thënë asnjë gënjeshtër në shkollë					
Nuk kam ofenduar askënd					
Nuk kam përdorur fjalë të pahijshme					
Nuk jam zënë me asnjë shok					
Ia huazova një pajisje shkollore shokut tim, i cili nuk e kishte marrë me vete					
I lava duart para se të haja drekë					
I hodha mbeturinat në koshin e mbeturinave, sepse kjo është në dobi të mbarëvajtjes së mjedisit në të cilin jetoj					
E ftova shokun tim që të hante drekë së bashku me mua					
U shoqërova me shokët gjatë pushimit dhe u solla mirë me ta					
Kur u ktheva në shtëpi, iu tregova prindërve se si e kisha kaluar ditën në shkollë					
I ndihmova shokut që kishte munguar në shkollë, që ta mësonte mësimin e kaluar					
I bëra me rregull detyrat e shtëpisë					

\*Vizato ☺ në secilin kator kur ke arritur që ta realizosh atë që është shkruar. Mbaj ditar gjatë tërë javës. Nëse arrin që të grumbullosh, më së paku, pesëdhjetë ☺ deri në fund të javës, ti, me të vërtetë, kujdesesh për sjelljen tënde shembullore. Të lumtë! Vazhdo kështu dhe përpiku që javën tjetër ta kalosh rezultatin tënd personal dhe të grumbullosh sa më shumë ☺. Nëse nuk arrin që të tubosh pesëdhjetë ☺, le të shërbejë kjo si një nxitje për ty për javën tjetër.



## MORALI

### Nocioni i moralit

Morali është një përbledhje rregullash të pashkruara që kanë të bëjnë me sjelljen e njerëzve. Morali vlerëson se çka është e mirë e çka është e keqe. Ai është një ndër karakteristikat më të rëndësishme të njeriut. Njeriu i moralshëm ka ndjenjë dhe njohuri për atë se çka është mirë. Nëse për ne flitet se jemi të moralshëm, kjo do të thotë se ne sillemi mirë në jetë dhe se largohemi prej të keqes. Morali është sjellje e dëshiruar dhe, për këtë, gjithkund në botë vlerësohet pozitivisht. Njeriu i moralshëm e di se veprat e tij nuk e lëndojnë askënd dhe ai gjithmonë e ndien veten mirë dhe të dinjitetshëm.

Morali është prezent në shoqerinë njerëzore qysh në bashkësitet e para njerëzore. Njeriu jeton në bashkësi me njerëzit e tjerë dhe, për këtë shkak, është e rëndësishme që t'i përputhë nevojat e tij me nevojat e njerëzve të tjerë. Kështu, njerëzit janë përpjekur që të gjejnë zgjidhje rrëth asaj se si duhet të sillen ndaj njëri-tjetrit.

Nga përvoja e përditshme mund të arrijmë në përfundimin se njerëzit dallojnë nga njëri-tjetri për sa i përket sjelljes së tyre morale. Disa njerëz, me të vërtetë, përpiken që t'i respektojnë dhe t'i zbatojnë rregullat morale në jetën e tyre dhe në raport me njerëzit e tjerë, por ka edhe njerëz që janë të gatshëm që publikisht, apo më shpesh fshehurazi, t'i shkelin rregullat e moralit.

Morali nuk është i njëjtë në të gjitha shoqëritë, as në të gjitha religionet, por as në të gjitha periudhat e historisë njerëzore. Ajo që është konsideruar e moralshme në një periudhë historike ose në një shoqëri, ndoshta nuk është vlerësuar kështu në një tjetër. Por, megjithatë ekzistojnë disa vlera universale që janë respektuar gjithmonë dhe që vazhdojnë të respektohen

edhe sot, prej të gjithë njerëzve, pavarësisht se ku jetojnë dhe pavarësisht se cilin religion i përkasin. Për këtë shkak, si vlera kryesore morale, me të drejtë, mund të konsiderohen: e mira, e sakta dhe e drejta.

Moralja nuk është ndonjë lëmi e posaçme në jetën e njeriut. Ajo është prezente në të gjitha raportet e njeriut: në raportin e tij ndaj vërvetes, në raportin e tij ndaj njerëzve të tjerë, ndaj kafshëve, ndaj natyrës dhe ndaj gjithë asaj me të cilën ai hyn në ndonjë marrëdhënie të caktuar.



## Sjellja morale

Të gjithë njerëzit kanë aftësi që të jetojnë në mënyrë të moralshme: të krishterët, myslimanët, njerëzit e religjioneve të tjera dhe të gjithë ata që nuk janë religjiozë. Njeriu i moralshëm e kupton se duhet të sillet mirë dhe se duhet të largohet prej të keqes. Parimi i përgjithshëm, sipas të cilit mund ta dimë se a jemi duke bërë mirë apo keq, duhet të jetë dashuria. Veprat që bëjmë kanë të bëjnë gjithmonë me dikë apo me diçka. Për këtë arsy, për vlerësimin e veprimeve tona, se a janë të mira apo jo, ne duhet ta pyesim gjithmonë veten: çfarë pasojash do të kenë ato në raport me njerëzit e tjerë? Nëse veprojmë mirë – kjo është shenjë se ne dëshirojmë të jetojmë sipas ligjit të dashurisë, ndërsa nëse veprojmë keq – ne veprojmë kundër dashurisë.

Morali i përfshin të gjitha llojet e veprimit të njeriut. Për të vlerësuar se a është një njeri i moralshëm apo jo, ne analizojmë veprimet e tij, gjykimin e tij, sjelljen e tij ose, në përgjithësi, cilësitet e karakterit të tij. Nëse ato janë në pajtim me vlerat e pranuara të shoqërisë sonë, atëherë ne themi se ky njeri është i moralshëm. Pra, të moralshëm e konsiderojmë atë njeri i cili me sjelljen dhe me gjykimin e tij i pranon vlerat morale të shoqërisë në të cilën jeton dhe i cili me jetën dhe punën e tij krijon të mira për veten e tij dhe për njerëzit e tjerë dhe, në të njëjtën kohë, nuk i bën keq askujt.

Një veprë nuk vlerësohet, se a është moralisht e arsyeshme apo jo, vetëm në bazë të të mirave të saj për veten dhe për të tjerët, por duhet të shikohet edhe metoda që kemi përdorur për kryerjen e asaj vepre. Nuk lejohet që të bëjmë gjëra të këqija me qëllim që të arrijmë synime të mira. Veprimi i keq e shkatërron aktin e mirë dhe atëherë vepra, vetvetiu, nuk do të jetë më 'e mirë'.

Sillemi drejt moralisht kur:	Nuk sillemi drejt moralisht kur:
Themi të vërtetën I duam njerëzit dhe i ndihmojmë ata Kujdesemi për shëndetin tonë Kujdesemi për natyrën I kryejmë rregullisht obligimet tona të punës Jemi të drejtë ndaj të tjerëve	Nuk themi gjithmonë të vërtetën U bëjmë keq njerëzve Nuk kujdesemi sa duhet për shëndetin tonë E ndotim natyrën Nuk i kryejmë obligimet tona të punës Nuk jemi gjithmonë të drejtë ndaj të tjerëve

### Le të mendojmë dhe le të bisedojmë

1. Çka është morali?
2. Si duhet të veprojë njeriu që të jetë i moralshëm?
3. Alejohet që të bëjmë punë të këqija, por me qëllime të mira dhe anasjelltas?
4. Numëroni disa shembuj kur sillemi drejt moralisht.
5. Cilën sjellje e konsiderojmë jo të moralshme?

## RËNDËSIA E MORALIT

Morali ka rëndësi të madhe në formimin dhe në rregullimin e sjelljes së njerëzve në shoqëri. Ai është edhe faktori kryesor për suksesin e njerëzve në jetë. Njeriu është qenie morale, sepse posedon ndjenjën e përgjegjësisë morale. Në pajtim me ndjenjat morale, njeriu mund të konsiderohet fajtor ose përgjegjës kur vepron në kundërshtim me normat morale. Për këtë, ka rëndësi të madhe që njeriu të ketë sjellje të mirë dhe të bëjë vepra të mira në jetë. Atëherë themi se ai sillet drejt moralisht. Rregullat morale i respektojmë jo vetëm kur i pranojmë ato si vlera, por edhe kur përpinqemi që ta përshtatim sjelljen tonë në pajtim me ato rregulla.

Moral do të thotë se njerëzit jetojnë në mënyrë të dinjitetshme, se kanë qëllime të mira, se realizojnë vlera të vërteta, e të tjera të ngjashme me këto. Në këtë mënyrë, njerëzit janin kontributin e tyre në bashkësi. Gjatë historisë është parë shumë qartë se, në ato shoqëri ku nuk është respektuar morali, njerëzit kanë vuajtur dhe shoqëritë e tilli janë shkatërruar shumë shpejt. Kështu ndodhi, për shembull, me shoqëritë fashiste ose kolonialiste. Për këtë arsy, në një shoqëri është me rëndësi të madhe që morali dhe sjellja morale të respektohen thellësisht. Kjo sjell sukses dhe përparim si në shoqëri, ashtu edhe tek njerëzit që i përkasin asaj.

### Le të mendojmë dhe le të bisedojmë

1. A e ka njeriu ndjenjën e përgjegjësisë morale?
2. Pse është e rëndësishme që njeriu të sillet drejt moralisht dhe të bëjë vepra të mira?

## E MIRA SI VLERA MË E LARTË ETIKE

E mira është vlera më e lartë etike. Ajo është cilësi e njeriut dhe obligim i secilit individ. E mira është kusht për një jetë të mirë. Kjo nënkupton bashkëpunimin me njerëzit e tjera, dialogun, dashurinë dhe dinjitetin e personit.

Njeri i mirë konsiderohet ai që ka dashuri ndaj Zotit, ai që i do njerëzit e tjera dhe që sillet mirë ndaj gjithçkaje që gjendet në natyrë.

Por, në botë, më së shpeshti, e mirë konsiderohet ajo drejt së cilës njerëzit synojnë dhe e cila u ndihmon atyre që të jetojnë më lehtë dhe më mirë; e mirë është ajo që e bën jetën e njeriut dhe bashkësinë të përparojë; e mirë është ajo që konsiderohet e vlefshme në aspektin moral, ekonomik dhe kulturor; e mirë është ajo që kërkohet, miratohet, respektohet, çmohet, etj.

E mira ka tri elemente:

1. respektimin e njerëzve
2. mbrojtjen sociale dhe
3. paqen dhe sigurinë

Respektimi i njerëzve nënkupton obligimin e njerëzve që t'i respektojnë të drejtat themelore të secilit njeri.

Sigurimi social është nevojë të cilën shteti duhet t'ua mundësojë të gjithë njerëzve në shoqëri, në mënyrë që ata të kenë mundësi të posedojnë mjetet kryesore që janë të domosdoshme për të jetuar, si për shembull: ushqimin, veshmbathjen, mbrojtjen shëndetësore, punën, arsimimin e të tjera të ngjashme me këto.

E mirë në shoqëri konsiderohet edhe paqja dhe siguria e të gjithë njerëzve. Të gjithë njerëzit janë të ftuar që të jenë pjesëmarrës në jetën publike dhe, me këtë, të kontribuojnë për të mirën e përbashkët të shoqërisë.

### E mira e përbashkët apo e përgjithshme

Të gjitha të lartpërmendurat janë njëlloj të rendësishme për të gjithë njerëzit, pavarësisht prej faktit se ku ata jetojnë. Për këtë, mund të themi lirisht se këtu bëhet fjalë për një të mirë të përgjithshme apo të përbashkët për të gjithë njerëzit në botë. E mira e përgjithshme apo e përbashkët, në të vërtetë, nënkupton që të gjithë njerëzit të kenë mundësi që t'i shfrytëzojnë dhe t'i përdorin të gjitha të mirat, si për shembull, të gjithë njerëzit të kenë mundësi të jetojnë në një mjeshtë pastër jetësor, të kenë mundësi të ushqehen në mënyrë të mjaftueshme, të kenë mundësi të shkollohen, të punojnë dhe të fitojnë për ekzistencën e tyre.

## Kujdesi për të mirën e përbashkët

Nëse diçka është e përbashkët dhe është e mirë për të gjithë njerëzit, kjo do të thotë se të gjithë ne duhet të kujdesemi për të. E mira e përbashkët nuk mund të krijohet vetveti. Ajo kërkon bashkëpunimin dhe përpjekjen e përbashkët të të gjithë njerëzve. Për shembull, ruajtja e një parku varet prej faktit se a do të kujdesen të gjithë vizitorët që t'i hedhin mbeturinat e tyre në vendin e caktuar, apo do t'i hedhin gjithandej në mënyrë të pakujdeshme. Furnizimin dhe shfrytëzimin e ujit mund ta quajmë si të mirë të përgjithshme, sepse të gjithë njerëzit kanë nevojë për të. Por, që të mirëmbahet sjellja e ujit gjatë kohës së thatësirës, njerëzit duhet ta kursejnë ujin. Disa individë ndoshta mund të lëkunden që ta kryejnë pjesën e tyre të këtij obligimi, duke menduar se nëse njerëz të tjerë e kursejnë ujin, edhe ata do të mund të kënaqen me të mirat e furnizimit me ujë, edhe pse vetë ata nuk janë përpjekur që ta pakësojnë shpenzimin e ujit nga ana e tyre. Nëse shumë njerëz mendojnë në këtë mënyrë, e mira e përbashkët, që varet prej përkrahjes së tyre, do të shkatërrohen. Po ashtu, edhe nevoja e njerëzve për ushqim është e mirë e përgjithshme. Mirëpo, disa njerëz, shumë shpesh, blejnë më shumë ushqim sesa iu nevojitet dhe, shpeshherë, teprica e ushqimit prishet para se ta përdorin, apo t'ia japidikujt që nuk ka ushqim të mjaftueshëm...

### Aktivitete

Biseda, diskutime dhe aktivitete të tjera të ngjashme rreth të mirës si vlera më e lartë etike.

Shfrytëzimi i teksteve dhe i ilustrimeve për t'u njojur me vlerat morale dhe traditat e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë.

### Le të mendojmë dhe le të bisedojmë

1. Çka është e mira?
2. Cilin e konsiderojmë si njeri të mirë?
3. Çka konsiderohet e mirë në shoqëri?
4. Cilat janë tri elementet e së mirës?
5. Çka është e mira e përbashkët apo e përgjithshme?
6. Si duhet të kujdesemi për të mirën e përbashkët?
7. Cila sjellje konsiderohet si e pakujdeshme ndaj të mirës së përbashkët?

## PRINCIPET E PËRBASHKËTA ETIKE TË MËSIMEVE RELIGJIOZE


### Mësimet morale në librat e shenjtë të religjioneve

Secili religion paraqet marrëdhëniet e njeriut ndaj Zotit dhe, për këtë arsy, përmban në vete principe etike ose morale të sjelljes. Këto principe të mirësjelljes janë dhënë nga Zoti dhe janë shkruar nëpër librat e shenja religjioze.

Librat e shenjtë përbajnë mësime religjioze dhe morale. Çdo religion ka librin e vet të shenjtë. Kështu, libri i shenjtë i të krishterëve është Bibla, libri i shenjtë i myslimanëve është Kurani, ndërsa i hebrejnje është Talmudi. Besimtarët besojnë se tekstet religjioze që janë shkruar në librat e shenja kanë inspirim hyjnor dhe, për këtë arsy, mësimi i tyre është i urtë dhe i dobishëm, pasi vlera e tyre nukmplaket kurrë.

Pikërisht, mësimi moral është ai që është i ngashëm te shumica e religjioneve. Religjionet, ndoshta, dallojnë sa i përket mësimeve dhe rrëth asaj se si e kuptojnë Zotin, mirëpo në secilin religion, ligji moral bazohet në parimet e larta morale drejtuar njerëzve që ta respektojnë Zotin, vetveten, natyrën dhe të gjithë njerëzit e tjerë si krijesa të Zotit.

Ekziston një ligj moral i Zotit që ka të bëjë me respektimin e të gjithë njerëzve në botë. Ky ligj është prezent në të gjitha religjionet dhe gjendet gati në të njëjtën mënyrë në të gjitha librat e shenja. Për këtë arsy edhe është quajtur parimi i artë.



### Parimi i artë i respektimit të të gjithë njerëzve

Parimi i artë na mëson që t'i respektojmë të gjithë njerëzit në botë, pavarësisht se cilës fe, komb apo racë i takojnë ata. Ja se çfarë thotë ky parim, që gjendet i shkruar në librat e shenja të tre religjioneve më të mëdha në botë:

**-Në Krishterizëm:** Bëju të tjerëve atë që dëshiron të ta bëjnë ata ty.

**-Në Islam:** “Asnjëri prej jush nuk është besimtar i vërtetë, nëse atë që e dëshiron përvete, nuk e dëshiron edhe për të afërmin e tij.” ”Njeriu më i mirë është ai që është më i dobishëm për njerëzit.”

**-Hebraizëm:** Mos ua bëni të tjerëve atë çka është e keqe për ju. Ky është ligj i përhershëm.

## Raporti i religjioneve ndaj virtyteve

Virtytet janë cilësi të tilla të karakterit tonë që na mundësojnë të bëjmë një jetë të mirë dhe të lumtur. Në të vërtetë, vetë fjala virtyt nënkupton prirjen dhe forcën e brendshme të njeriut për të bërë punë të mira. Virtytet i sjellin mirësi dhe lumturi në jetë jo vetëm njeriut që i posedon ato, por edhe njerëzve që jetojnë me të në të njëjtën bashkësi. Për këtë arsy, ato janë të rëndësishme për secilin njeri dhe çmohen dhe vlerësohen njëloj te të gjitha religionet dhe te të gjitha shoqëritë.

Si virtyte konsiderojmë: fenë, shpresën, dashurinë, drejtësinë, sinqeritetin, dëlirësinë, falënderimin, maturinë, durimin, trimërinë, pastërtinë, kujdesin, urtësinë, sakrificën, përgjegjësinë, optimizmin, ndjeshmërinë, bukurinë, modestinë, subtilitetin, bashkëpunimin, disiplinën, mëshirën, dashurinë ndaj të vërtetës, dashurinë ndaj njeriut, të qenët jo egoist, jo i dhunshëm, të qenët i këndshëm, i kujdeshëm, i shoqërueshëm, i përbajtur, paqësor, etj.

\*A i ke të qarta të gjitha këto fjalë që i përmendëm si virtyte? Për shembull:

- **dashamirës i të vërtetës** është ai që e do të vërtetë dhe e thotë gjithmonë atë;
- **I sinqertë** është ai i cili tregohet gjithmonë ashtu siç është në të vërtetë dhe premtion vetëm atë që mund ta realizojë;
- **Jo egoist** është ai që nuk udhëhiqet në jetë vetëm nga nevojat e veta, por kujdeset edhe për nevojat e njerëzve të tjerë;
- **Solidar** është ai që bashkohet me idetë, qëllimet dhe veprimet e një tjetri dhe që iu ndihmon njerëzve që kanë nevojë për ndihmë;
- **Përgjegjës** është ai që i kryen në kohë të gjitha obligimet;
- **I këndshëm** është ai që sillet me kujdes, që lutet dhe falënderon gjithmonë;
- **I shoqërueshëm** është ai që ka dëshirë të shoqërohet me të tjerët, që ka shumë shokë dhe që i respekton të gjithë;
- **Optimist** është njeriu që i sheh gjithmonë ndodhitë në jetën e tij në mënyrë pozitive;
- **I drejtë** është ai që pranon se të gjithë njerëzit kanë të drejtat e tyre dhe që posedon gatishmëri të përhershme që t'ia japë se cilat atë që i takon;
- **I mëshirshëm** është ai që i gëzohet lumturisë dhe suksesit të njerëzve të tjerë, ndërsa kur sheh se dikush është në vështirësi, përpinqet ta ndihmojë ose ta ngushëllojë;
- **Paqësor** është ai që përpinqet gjithmonë për unitet dhe paqe në mesin e njerëzve;
- **Jo i dhunshëm** është ai që i zgjidh me të mirë dhe në mënyrë paqësore të gjitha mosmarrëveshjet...

\*Përpinquni me ndihmën e arsimtarit/arsimtares që të shpjegoni edhe virtytet e tjera.

\* Shkruaj në vendin e caktuar në tabelë emrat e shokëve të tu të klasës, sipas virthytit që çmon më së shumti te ata. Përpiqu të gjesh te të gjithë shokët e klasës ndonjë prej virthyteve të lartpermendura. Mund të shkruash edhe emrin tënd. Lexojeni ushtrimin në klasë.

Virthyet që posedojnë shokët e mi të klasës	
Virthyet	Emrat e shokëve
I disiplinuar/e disiplinuar	
I sinqertë/e sinqertë	
I ndershëm/e ndershme	
Shok i mirë/shoqe e mirë	
Falënderues/falënderuese	
Paqësor/paqësore	
I dashur/e dashur	
I këndshëm/e këndshme	
I drejtë/e drejtë	
I shoqërueshëm/e shoqërueshme	
Jo i dhunshëm/jo e dhunshme	
I guximshëm/e guximshme	
I mëshirshëm/e mëshirshme	
Solidar/solidare	
I ndjeshëm/e ndjeshme	
I kujdeshëm/e kujdeshme	
Modest/modeste	
I vëmendshëm/e vëmendshme	
Jo egoist/jo egoiste	
I përgjegjshëm/e përgjegjshme	
Sakrifikues/sakrifikuese	
I urtë/ e urtë	
I mençur/e mençur	
Besnik/besnike	
Kreativ/kreative	
Gazmor/gazmore	
Optimist/optimiste	

## Të mbajmë mend

Zhillohen bisedime për rregullat e mirësjelljes sipas religjioneve

Numërohen dhe përshkruhen rregullat e sjelljes në familje, në klasë dhe në bashkësi, sipas mësimeve religjioze.

Lexohen tekste për të drejtat themelore të njeriut, për të vërtetën, sinqueritetin, gjenjeshtren, mashtrimin etj.

## Le të mendojmë dhe le të bisedojmë

1. Çka është religjioni?
2. Numëroji religionet që di.
3. Cila është e përbashkëta e të gjitha religjioneve?
4. Çka përbajnë librat e shenjtë?
5. Cilat janë parimet e përgjithshme morale të religjioneve për njerëzit?
6. Çka do të thotë fjala virtuty?
7. Numëroji disa virtute.

## BAZAT TEORIKE TË ORTODOKSISË

### Krishterimi


Krishterimi, si religion, u paraqit në shekullin e parë të erës sonë dhe ka për bazë jetën dhe mësimet e Jezu Krishtit. Krishterimi, si religion universal kundrejt religjioneve të atëhershme nationale, predikon barazinë në mesin e të gjithë njerëzve para Zotit. Pasuesit e krishterimit quhen të krishterë për shkak të besimit tek Jezu Krishti. Era e krishterë fillon me lindjen e Jezu Krishtit, prej kur fillojnë të numërohen edhe vitet e erës së re. Gjatë historisë, krishterimi është shpërbërë në shumë sekte të krishtera: Kisha Ortodokse, Kisha Rimokatolike dhe Kisha Protestante.

### Feja e krishterë ortodokse

Feja ortodokse është një prej degëve kryesore të krishterimit. Mësimi i saj është i pandërprerë dhe i pandryshuar qysh prej themelimit të religionit të krishterë dhe për këtë arsy edhe quhet ortodokse, që do të thotë ”fe e vërtetë”. Mësimet e saj ruhen në mënyrë të pastër dhe të pandryshuar në Librin e Shenjtë – Bibël.

### Kush ka qenë Jezu Krishti?

Jezu Krishti u lind nga gruaja e quajtur Marije. Gjatë kohës së jetës së tij në këtë botë, Jezu Krishti ka jetuar i përulur. Ai nuk ka kërkuar famë, e as nuk ka kërkuar nderime prej njerëzve. Ka lindur në një shpellë, në një qytet të vogël të quajtur Betlehem. Fëmijërinë e tij e ka kaluar në qytetin Nazaret. Ai ua mësonte njerëzve fenë dhe ligjet morale, prandaj njerëzit e kanë konsideruar mësues të madh. Fjalët e tij, edhe pse ishin të fuqishme, ishin të qarta e të kuptueshme. Të gjithë njerëzit, edhe ata që ishin të rëndomtë dhe ata që ishin të ditur, nuk kishin asnjë vështirësi që ta kuptionin atë.



## Festat e krishterizmit

Festat më të mëdha që festojnë të krishterët kanë lidhje me jetën e Jezu Krishtit në tokë. Kështu, dita e lindjes së Krishtit festohet si Krishtlindje; dita kur Krishti ishte dorëzuar dhe ishte akuzuar rrejshëm festohet si e Enjtja e Madhe; dita kur Jezu Krishti ishte gozhduar në kryq festohet si e Premtja e Madhe, kurse dita e ringjalljes së Krishtit festohet si Pashkët. Pashkët është festa më e madhe e të krishterëve dhe festohet gjithmonë ditën e diel.

## Bibla – libri i shenjtë i krishterizmit

Të gjithë të krishterët e pranojnë Biblën si libër të shenjtë. Ajo quhet ndryshe edhe Shkrimi i Shenjtë. Bibla është libri që përmban shpalljet e Zotit. Zoti, nëpërmjet Biblës, ua sqaron njerëzve ligjet e përherershme me qëllim që, të mbështetur në urtësinë dhe dashurinë e Tij, të ecin në jetë. Ajo është e përbërë prej 77 librave, të cilat janë ndarë në dy pjesë: Dhiata e Vjetër dhe Dhiata e Re. Gjatë njëmijë e gjashtëqind viteve, shtatëdhjetë e shtatë librat e Shkrimit të Shenjtë u shkruan prej njerëzve që kishin jetuar nëpër vende të ndryshme dhe që kishin folur gjuhë të ndryshme. Mirëpo Zoti i kishte folur secilit shkrues në gjuhën e tij dhe, për këtë, porosia e të gjithë shkruesve të Shkrimit të Shenjtë është e njëjtë.



Për jetën dhe veprën e Jezu Krishtit në tokë mësojmë nga Libri i Shenjtë–Bibla, posaçërisht nga Dhiata e Re.



### Le të mendojmë dhe le të bisedojmë

#### Çfarë ke mësuar për etikën ortodokse?

1. Mbi mësimet e kuqt është themeluar religjioni i krishterë?
2. Prej kur kanë filluar të numërohen vitet e erës së re?
3. Kush ka qenë Jezu Krishti?
4. Kush është nëna e Jezu Krishtit?
5. Cili është libri i shenjtë i të krishterëve?
6. Cilat janë festat më të njohura në fenë e krishterë?

## BAZAT ETIKE TË KRISHTERIZMIT ORTODOKS

### Ngjashmëritë dhe dallimet në mes njerëzve

Sipas mësimeve të krishtera ortodokse, njeriu është krijuar si qenie e ndërlidhur. Kjo do të thotë se Zoti e ka krijuar njeriun:

- si qenie me trup dhe të mençur
- me vullnet të lirë,
- me aftësinë për të vendosur
- me ndjenjën e përgjegjësisë ndaj bashkësisë dhe
- me aftësinë që ta njohë Zotin (njeriu është religjioz).

**1. Liria** – Zoti i ka dhuruar njeriut ekzistencën e tij dhe i ka dhënë atij lirinë e zgjedhjes. Njeriu, me punën dhe me veprimet e tij morale, zhvillohet brenda njerëzishmërisë së tij dhe këshfu e arsyeton dhuntinë e ekzistencës së tij.

**2. Trupi** – Trupi i njeriut është mjet me të cilin ai bashkëpunon me njerëzit e tjerë. Trupi është manifestim i veçantës së njeriut. Secili njeri dallon më së shumti nga njerëzit e tjerë pikërisht nga pamja e tij trupore. Trupi i njeriut përbëhet prej të njëjtave elemente që përbëhet edhe toka. Kjo do të thotë se ai është një qenie e brishtë. Trupi i tij lindet, rritet, plaket dhe, një ditë, vdes.

**3. Mençuria** – Njeriu nuk dallon prej të tjerëve vetëm për nga pamja e tij trupore. Ai ka mendje dhe posedon aftësinë që të gjykojë (logjikojë). Në të vërtetë, me anën e mendjes njeriu zbulon botën, por mund ta njohë edhe ekzistimin e Zotit.

**4. Vullneti** – Njeriu nuk është vetëm kriesë që mendon, por ai është edhe kriesë që vendos. Sipas vullnetit të tij, ai vendos se si të veprojë: mirë apo keq.

**5. Ndjenja për bashkësinë** – Njeriu nuk është i vetëm në botë. Ai është krijuar që të jetojë në bashkësi. Njeriu nuk do të mund të ekzistonte dhe nuk do të mund ta zhvillonte njerëzishmërinë e tij pa njerëzit e tjerë. Për këtë arsy, njeriu krijon familje. Familja është qeliza kryesore e çdo bashkësie. Ajo është shtylla e shoqërisë.

**6. Religjioziteti** – Njeriu është kriesa e vetme në tokë që është e aftë që ta zbulojë Zotin dhe që ta pasojë rrugën e Tij. Në këtë mënyrë, ai mund t'i lidhë dhe t'i përsosë të gjitha aftësitë e tij në jetë.

## Përgjegjësitë e njerëzve në jetën e përbashkët

Të gjithë njerëzit në tokë janë krijuar prej një Zoti. Kjo është arsyja për shkak të së cilës ne duhet të jetojmë mirë me të gjithë popujt dhe të kemi mirëkuptim me njerëzit e religjioneve të tjera, si edhe me ata të cilët nuk besojnë në asnjë religion. Po ashtu, ne duhet të sillemi njëlloj ndaj të gjithë njerëzve: edhe ndaj atyre njerëzve që kanë lindur në Azi, edhe ndaj atyre që kanë lindur në Afrikë apo në Evropë, apo në ndonjë vend tjetër të botës. Kultura ndryshon, por njerëzishmëria duhet të jetë e përhershme.

Kisha ortodokse i ka respektuar gjithmonë njerëzit e religjioneve të tjera dhe ne e kemi për detyrë që ta respektojmë lirinë e njeriut. Dialogu mund t'i afrojë njerëzit vetëm nëse ekziston mirëkuptimi ndaj të tjerëve dhe nëse nuk imponohet bindja personale. Dialogu është parakusht për kuptimin reciprok, ndërsa kuptimi është parakusht për besimin e ndërsjellë, si edhe për sigurimin e kushteve për respekt dhe për bashkëpunim të përbashkët. Dialogu është rruga e vetme që pëlqehet nga Zoti.

### Le të mendojmë dhe le të bisedojmë

1. Me çfarë cilësish e ka krijuar Zoti njeriun?
2. Me çka dallohen njerëzit nga njëri-tjetri?
3. Çfarë përgjegjësish duhet të ketë njeriu në jetën e përbashkët?
4. Si duhet të sillemi ndaj njerëzve të tjerë?
5. A duhet t'i respektojë një i krishterë ortodoks njerëzit e religjioneve të tjera? Pse?
6. A janë të denjë të gjithë njerëzit për t'u respektuar? Pse?



## BAZAT E MORALIT TË KRISHTERË ORTODOKS

Morali i krishterë ortodoks i ka themelet e tij te Zoti – Zoti është dashuri. Zoti, me theks të veçantë, i ka ftuar njerëzit që të jetojnë në paqe dhe të jenë të lumtur. Për këtë arsy, në Dhiatën e Vjetër, Ai u ka shpallur njerëzve Dhjetë Urdhëresat e Zotit. Ato nuk janë ndalesa, por mjete për njohjen e punëve të mira nga të këqijat. Nëse njeriu i pason ato, ai do të jetojë më lehtë në paqe dhe do të ketë lumturi të vërtetë.

### Dhjetë Urdhëresat e Zotit

1. Unë jam Hyji, Zoti yt, mos adhuro zota të tjerë përveç Meje!
2. Mos krijo idhull apo imazh të asaj që është në qiell, të asaj që është poshtë në tokë dhe të asaj që është në ujë dhe nën tokë. Mos i adhuro ata dhe mos u shërbë atyre!
3. Mos e përmend së koti emrin e Hyjit, Zotit tënd!
4. Përmende Atë ditën e pushimit, me qëllim që ta festosh. Puno gjashtë ditë dhe kryeji të gjitha punët, kurse ditën e shtatë përkushtoja Hyjit, Zotit tënd!
5. Respekoje babanë dhe nënën tënde që të jesh mirë dhe që të jetosh gjatë në tokë!
6. Mos vrit!
7. Mos bëj kurvëri!
8. Mos vidh!
9. Mos dëshmo rrejshëm kundër të afërmit tënd!
10. Mos lakmo asgjë që është e huaj!

Në Dhiatën e Re, njeriu ftohet edhe më tepër prej Zotit që të jetojë një jetë të moralshme. Jezu Krishti tregon se si duhet të jetë morali i vërtetë. Ligji moral, të cilin e ka dhënë vetë Jezu Krishti, quhet ligji i dashurisë dhe është shpallur në Dhiatën e Re. Ky ligj, shkurtimisht, përmban:

### Dyurdhëresat më të mëdha të krishtera

1. Duaje Hyjin, Zotin tënd me gjithë zemrën tënde, me gjithë shpirtin tënd dhe me gjithë mendjen tënde;
2. Duaje të afërmin tënd sikurse vetveten.

Kjo do të thotë se morali i krishterë ortodoks duhet të njihet. Ai e nxit njeriun që ta tejkalojë drejtësinë e rëndomtë, t'i dojë të gjithë njerëzit, t'i falë dhe t'u ndihmojë të gjithëve njëlloj.

Sivirtytet më të mëdha në krishterimin ortodoks konsiderohen feja, shpresa dhe dashuria.

Feja, si virthyt, është diçka e shenjtë dhe secili njeri duhet ta ketë në vetvete. Feja e ndriçon dhe e përplotëson mendjen e njeriut në shumë aspekte, sepse ajo na mëson për të vërtetat që janë shumë të rëndësishme për të menduarit dhe për të vepruarit tonë.

Te secili njeri duhet të ketë shpresë. Shpresa është mendim pozitiv dhe besimi se diçka e mirë që presim të na ndodhë në jetë do të realizohet.

Ndërsa dashuria është më e rëndësishme se të gjitha. Pa dashuri, humbet kuptimi i jetës së njeriut. Detyra jonë më e madhe e krishterë është ta duam Zotin dhe t'i duam njerëzit ashtu siç e duam vetveten.

Urtësia, drejtësia, guximi, maturia, solidariteti, humaniteti, ngushëllimi, ndihmesa, falja, pajtimi, paqedashja, falënderimi, zelli për punë, besnikëria dhe besa, po ashtu, janë virthyte të rëndësishme të krishtera.

### Le të mendojmë dhe le të bisedojmë

1. Në çka bazohet morali i krishterë ortodoks?
  2. Numëroji dhjetë Urdhëresat e Zotit.
  3. Ligji moral, të cilin e ka sjellë Jezu Krishti, gjendet në dy urdhurat më të mëdha të krishtera.
- Cilat janë ato?
4. Cilat janë virthyet më të mëdha në krishterimin ortodoks?
  5. Numëroji disa virthyte të rëndësishme.

## BAZAT TEORIKE TË MËSIMEVE KATOLIKE

### Katolicizmi

Katolicizmi ose rimokatolicizmi është njëra prej feve të krishtera, bashkë me ortodoksizmin dhe me protestantizmin. Fjala katolicizëm do të thotë universalitet dhe ka të bëjë me universalitetin e mësimeve të Krishtit (Ungjilli) që janë të dedikuara për secilin njeri, popull, gjuhë, kulturë, civilizim dhe shoqëri. Kjo është një prej karakteristikave themelore të se cilës kishë të krishterë.

Në njëmijë vitet e para të Krishterimit, kur ai ishte një dhe nuk ishte i ndarë në shumë fe të krishtera, me fjalën katolicizëm nënkuptohej kuvendi ose bashkësia e të gjithë të krishterëve të botës.

Kisha katolike është bashkësia më e madhe e krishterë në botë. Udhëheqja e saj është e centralizuar dhe mbinacionale. Kreu i kishës katolike është papa – peshkopi romak. Ai, ndryshe, quhet edhe Ati i Shenjtë dhe konsiderohet si trashëgimtar i dishepullit të shenjtë, Pjetrit. Selia e tij gjendet në shtetin e Vatikanit. Papa, me ndihmën e Fronit të Shenjtë, udhëheq tërë kishën katolike në botë. Froni i Shenjtë është pushteti suprem i kishës katolike, me në krye papën.

Kisha përbëhet nga hierarkia kishtare (peshkopët, priftërinjtë, xhakonit) dhe besimtarët. Peshkopët janë trashëgimtarë të apostujve dhe udhëheqin bashkësitet vendore katolike. Kisha, në të cilën peshkopi ka selinë e tij dhe kryen ritualet fetare, quhet katedrale. Profeti i shenjtë Mojsi është i pari që ka shkruar libra, që janë pjesë të Biblës.

Një person mund të bëhet besimtar i kishës katolike nëpërmjet rritit të shenjtë të pagëzimit. Mund të pagëzohen edhe fëmijët, edhe të rriturit.

### Bibla – fjala e shkruar e Zotit

Bibla është Shkrim i Shenjtë, Fjalë e Zotit me të cilën Zoti u drejtohet të gjithë njerëzve, në të gjitha kohët. Atë e kanë shkruar shumë shkrues, të cilët kanë jetuar në rajone të ndryshme, në kohë të ndryshme dhe kanë pasur profesione të ndryshme.

Bibla është e ndarë në Dhiatën e Vjetër dhe Dhiatën e Re. Bibla është libër i jetës të cilën të krishterët duhet ta lexojnë dhe të udhëzohen në fe çdo ditë.

### Jezu Krishti

Sipas mësimeve katolike, Zoti është përpjekur që t'i afrohet njeriut që prej fillimit dhe këtë e ka bërë gjatë tërë historisë. Mirëpo, më së shumti, iu është afruar njerëzve me anën e lindjes së Jezu Krishtit.

Jezu Krishti është person historik. Për ekzistimin e tij në tokë ka shumë dëshmi. Ai ka lindur në

tokë në mënyrë të çuditshme, prej një vajze shumë të devotshme me emrin Marije. Jezusi është rritur në qytetin Nazaret. Për këtë, në Ungjill, quhet Jezusi nga Nazareti ose Jezus Nazaretni. Ai kishte zgjedhur dymbëdhjetë apostuj, të cilët kishin qenë gjithmonë me të dhe kishin dëshmuar për veprat e tij. Përveç apostujve, ai ishte pasuar gjithkund prej një numri të madh njerëzish, të cilët kishin dëshirë t'i dëgjonin mësimet e Tij ose të shëroheshin prej tij. Jezusi ka predikuar Lumturitë, dashurinë ndaj Zotit dhe ndaj të afërmve, agjërimin, lutjen, lëmoshën, drejtësinë dhe shumë gjëra të tjera. Ai ka bërë disa mrekulli, pasi i ka shëruar të sëmurët prej shumë sëmundjeve të rënda që ishin të pashërueshme.

## Nxënësit e Jezusit sot

Të gjithë të krishterët janë të ftuar që të janë apostuj, dëshmitarë të lajmit të gëzuar të Jezusit për dashurinë e madhe të Zotit ndaj njerëzve:

- peshkopët, me në krye papën, si trashëgimtarë të dymbëdhjetë apostujve;
- priftërinjtë si bashkëpunëtorët më të afërt të peshkopëve;
- murgjit dhe murgeshat dhe
- besimtarët.

Njëzet shekuj pas jetës së Krishtit në tokë, bota është më ndryshe, por në shumë gjëra është e ngjashme me kohën në të cilën ka vepruar Jezusi. Edhe sot ka njerëz të varfër, pa rroba e pa shtëpi, fëmijë të uritur e të paushqyer, punëtorë pa punë, skamnorë, njerëz që vuajnë, njerëz të lënë pas dore, të sëmurë, lysparë, fëmijë pa prindër...

Jezusi na ka treguar rrugën që duhet ta pasojmë dhe t'u ndihmojmë të tjerëve. Nuk ekziston asnjë rrugë tjetër, me të cilën do të ndërtohej një botë më e mirë, përveç rrugës së tij.

## Festat katolike

Festat më të mëdha të kishës katolike janë Krishtlindjet, që festohen për nder të lindjes së Jezu Krishtit dhe Pashkët, që festohen për nder të ringjalljes së Krishtit. Ekzistojnë edhe festa të tjera që i janë dedikuar Jezu Krishtit, Marisë dhe shenjtorëve.

### Le të mendojmë dhe le të bisedojmë

1. Cilat fe të krishtera njihni?
2. Çka do të thotë fjala katolicizëm?
3. Kush është lideri suprem i kishës katolike?
4. Ku gjendet selia e papës?
5. Si quhet kisha në të cilën peshkopi ka selinë e tij dhe në të cilën kryhen shërbimet?
6. Cili libër është i shenjtë për besimtarët katolikë?
7. Cilat festa i festojnë katolikët?

## BAZAT ETIKE TË MËSIMEVE KATOLIKE

### Njerëzit jetojnë bashkërisht


Të gjithë njerëzit në botë jetojnë në bashkësi. Edhe ne jetojmë në bashkësi.

Çfarë presim prej bashkësisë tonë dhe çfarë jemi të gatshëm të bëjmë për secilin prej nesh, në mënyrë që ai të ndihet i pranuar prej të tjerëve në bashkësi?

Kur jetojmë në bashkësi, jeta jonë është më e lehtë, sepse ne e ndihmojmë njëri-tjetrin. Kur na duhet ndihma, të tjerët na ndihmojnë, ndërsa kur dikush tjetër pret ndihmë prej nesh, ne duhet ta ndihmojmë.

Jeta e njeriut në bashkësi është sikurse një urë, gurët e së cilës, duke u mbështetur mbi njëri-tjetrin, mundësojnë që mbi urë të kalohet në mënyrë të sigurt. Kështu është edhe me jetën tonë. Fortësia dhe siguria jonë varet prej secilit njeri në bashkësi. Secili prej nesh kontribuon që jeta e përbashkët të jetë më e sigurt dhe më e rehatshme. Për këtë shkak, secili njeri ftoshet, sipas forcave dhe aftësive të tij, që të ndërtojë një jetë më të mirë për të gjithë njerëzit. Këtë do të mund ta realizojmë nëse ndërtojmë marrëdhënie të mira në sjellje ndaj:

- botës dhe gjëra e që na rrrethojnë;
- njerëzve të tjerë;
- vetvetes dhe
- Zotit.



### Ne dallojmë nga njëri-tjetri

Në jetën e përditshme, në familje, në shkollë, ne vërejmë se kemi dallime nga njëri-tjetri. Ne dallojmë nga mosha, nga pamja, nga ngjyra e lëkurës dhe nga gjinia. Ne mendojmë ndryshe, sillemi ndryshe dhe besojmë ndryshe. Nganjëherë nuk e kuptojmë tjetrin dhe për këtë shkak frikësohami. Mirëpo, prapë, është mirë që të jemi bashkë. Ne nuk mundemi pa njëri-tjetrin.

## Rregulla për marrëdhënie të mira, për respektim dhe për unitet

Të gjithë kemi nevojë për mirëkuptim dhe respekt nga njerëzit e tjerë. Njerëzit e tjerë mund të jenë shokët tanë, të cilët i duam, por ata mund të jenë edhe të huaj, prej të cilëve frikësohemi dhe fshihemi.

Edhe pse jetojmë bashkë, shpeshherë ne nuk i vërejmë nevojat e të tjerëve. Nganjëherë jemi të ashpër dhe të mbyllur ndaj njëri-tjetrit. Por me rëndësi është të mësojmë se të gjithë jemi të ftuar që të jetojmë bashkë. Që të kemi sukses për këtë, nevojitet që t'i respektojmë rregullat që na mundësojnë jetën e përbashkët.

### Rregullat e mirësjelljes në klasë

Edhe klasa jonë është një bashkësi. Ne kemi dallime, mirëpo, prapëseprapë, kemi qëllim të njëjtë: të arsimohemi dhe të edukohemi.

Në klasë sillemi mirë dhe me respekt ndaj shokëve tanë nëse:

- dëgjojmë me kujdes kur flet dikush, sepse secili meriton respekt dhe vëmendje;
- ilejojmë të tjerët që ta thonë deri në fund atë që mendojnë;
- nuk e përqeshim askënd;
- nuk e përgojojmë askënd;
- i gëzohemi suksesit të të tjerëve;
- kemi besim në vetvete;
- nëse duam të themi diçka, kërkojmë leje për ta marrë fjalën dhe flasim lirshëm dhe me sinqeritet;
- sillemi miqësish ndaj të gjithëve;
- undihmojmë të tjerëve;
- shoqërohem i me të gjithë;
- kemi respekt ndaj arsimtarëve dhe të punësuarve në shkollë.



### Le të mendojmë dhe le të bisedojmë

1. Pse njerëzit jetojnë në bashkësi?
2. Si mundemi të japim ndihmesën tonë për një jetë më të mirë për të gjithë njerëzit?
3. Çfarë paraqet klasa jote?
4. Cilat rregulla të mirësjelljes në klasë njeh ti?
5. Cilat prej rregullave të mirësjelljes përdor ti?

## BAZAT E MORALIT KATOLIK

### Bibla – libri me ligje për sjellje të mirë

Në Bibël janë të shkruara ligjet dhe rregullat e jetës. Zoti ua ka dhënë ato njerëzve që të udhëhiqen prej tyre dhe të kenë marrëdhënie të drejta me Krijuesin e tyre dhe me të gjithë njerëzit në tokë. Këto ligje u quajtën: Dhjetë Urdhëresat e Zotit. Në to thuhet:

Unë jam Zoti yt, mos adhuro zota të tjerë përveç Meje!

Mos krijo idhull ose imazh të asaj që është lart në qjell, të asaj që është poshtë në tokë dhe të asaj që është në ujë dhe nën tokë. Mos i adhuro ata dhe mos u shërbe atyre!

Mos e përmend së koti emrin e Hyjit, Zotit tënd!

Përmende atë ditën e pushimit, me qëllim që ta festosh. Puno gjashtë ditë dhe kryeji të gjitha punët, kurse ditën e shtatë kushtoja Hyjit tënd, Zotit tënd!

Respekoje babanë dhe nënën tënde që të jesh mirë dhe që të jetosh gjatë në tokë!

Mos vrit!

Mos bëj kurvëri!

Mos vidh!

Mos dëshmo rrejshëm kundër të afërmit tënd!

Mos lakmo asgjë që është e huaj!

### Ligji themelor i mbretërisë së Zotit

Mbretëria e Zotit, të cilën e ka zbuluar Jezu Krishti, dallon prej mbretërive të tjera. Aty marrëdhëni mes njerëzve sunojnë më ndryshe. Pasuria nuk matet sipas sasisë së parave dhe gjëra e të çmuara që posedojnë njerëzit, ndërsa pushteti nuk arrihet me ushtri dhe me forcë. Me të vërtetë, ajo është mbretëri e çuditshme.

Jezu Krishti ka paralajmëruar një botë të re, në të cilën të varfrit nuk do të jenë më të varfër, të uriturit do të ngopen, të robëruarit do të lirohen, kurse njerëzit do ta gjejnë miqësinë e Zotit. Kjo është mbretëria e Zotit.

Ligji themelor që duhet të respektohet, që të jemi pjesë e kësaj mbretërie, është ligji i dashurisë. Ekzistojnë dy urdhëresa të dashurisë, të cilat i ka thënë Jezu Krishti. Ato janë me rëndësi të madhe për të gjithë të krishterët. Në to thuhet:

Duaje Hyjin, Zotin tënd me gjithë zemrën tënde, me gjithë shpirtin tënd dhe me gjithë mendjen tënde;

Duaje të afërmin tënd sikurse vetveten.

## Dashuria – vlera më e madhe në jetën e njeriut

Zoti na do shumë. Jezusi na e ka zbuluar këtë në mësimet e tij. Kjo është arsyja që edhe ne ta duam Zotin. Ne duhet ta duam Zotin, jo se ky është urdhër, por për shkak se Zoti me të vërtetë na ka dhënë arsy që ta duam me dashurinë e Tij të fuqishme miqësore dhe atërore ndaj nesh. Kjo dashuri është e përhershme, ajo nuk ndalet kurrë. Për këtë themi se kjo dashuri ka vlerën më të madhe në jetën e njeriut.

Nëse e duam Zotin me gjithë zemrën tonë, me gjithë shpirtin dhe mendjen tonë, atëherë ne, në vete, bëjmë mirësi të madhe. Kur ne ta duam Zotin aq shumë, ne do të jemi të dëgjueshëm dhe do t'i pasojmë mësimet e tij. Kurse Ai e di më së miri se për çfarë kemi nevojë ne. Për këtë, ne nuk duhet të bëhem si fëmijët e padëgjueshëm që nuk e respektojnë as babanë e tyre.

Për hir të Zotit, ne do t'i duam të gjithë ata të cilët i do Ai – të gjithë të afërmit tanë, ashtu siç e duam vetveten. Sepse nëse duam dikë më pak sesa e duam vetveten, kjo nuk do të jetë dashuri e vërtetë. Nëse të gjithë njerëzit jemi të njëjtë para Zotit, atëherë këtë duhet ta respektojmë dhe kështu duhet të jetojmë.

Dashuria nuk njeh kufij. Ajo është e vërtetë nëse rritet në mirësi. Që të na afrojë këto urdhëresa, Jezusi na ka dhënë edhe këtë rregull të artë: "Gjithçka që dëshironi t'ua bëjnë njerëzit juve, bëjuani edhe ju atyre."



### Le të mendojmë dhe le të bisedojmë

1. Çfarë shkruhet në Bibël?
2. A duhet të respektohen Dhjetë Urdhëresat e Zotit vetëm nga katolikët?
3. Cili është ligji themelor dhe cilët janë dy urdhëresat e dashurisë?
4. Cila është vlera më e madhe në jetën e njeriut?
5. A i do Zoti të gjithë njerëzit, apo vetëm katolikët?
6. A duhet t'i duam ne të gjithë njerëzit?

## BAZAT TEORIKE TË MËSIMEVE EVANGJELISTE – METODISTE

### Themelimi i mësimeve evangjeliste – metodiste

Themelues i mësimeve evangjeliste – metodiste është Xhon Uesli, i lindur në vitin 1703, në Angli. Ai ishte prift në kishën anglikane dhe për këtë metodizmi, në fillim, u paraqit vetëm si një lëvizje në prehrin e kishës anglikane për përmirësimin e jetës shpirtërore.

Predikuese anglez, Xhon Uesli, ishte prekur thellë nga varfëria që kishte marrë hov akoma më të madh në shek. e XVIII-të, në Angli.

Fillimi i revolucionit industrial shkaktoi probleme të mëdha sociale (papunësi, eksploratim të madh të të rriturve, keqpërdorim të mundit të fëmijëve, alkoolizëm etj.). Xhon Uesli, bashkë me disa bashkëmendimtarë të tij, formoi një lëvizje, në kuadër të kishës anglikane, që të kujdesej për këta njerëz dhe për problemet e tyre. Motoja e tij kryesore ishte: "Unë e shoh tërë botën si një famulli. Kudo që të gjendem, ndiej në vete obligimin e shenjtë se duhet t'ua predikoj Ungjillin të tjerëve." Risia që kishte sjellë Xhon Uesli në kishën anglikane ishte se ajo, prej vitit 1739, kishte emëruar si predikues edhe laikë (njerëz që nuk ishin priftërinj).

Njerëzve që i prinin kësaj lëvizje ua kishin vënë nofkën "metodistë" për shkak se dallohen nga mënyra e disiplinuar e të jetuarit (leximit të përditshëm të Biblës, lutjes së përhershme dhe kujdesit për të tjerët).

Me kalimin e kohës, shumë njerëz emigruan nga Anglia në Amerikë. Kështu, lëvizja metodiste u përhap edhe në kontinentin e ri. Me pavarësimin e SHBA-ve, kisha anglikane u tërroq prej kolonive dhe mbeti vetëm nën patronazhin e kurorës angleze. Metodistët filluan që të themelojnë kishat e tyre në kolonitë e lëshuara. Kisha e parë Metodiste në Shtetet e Bashkuara të Amerikës u themelua në vitin 1784. Kjo lëvizje është e përhapur gjithkund nëpër botë.



Xhon Uesli, themelues i mësimit evangelist-metodist

## Mësimet themelore të kishës evangjeliste – metodiste

Kisha metodiste e kryen mësimin dhe mënyrën e shërbesës njëlloj sikurse kisha anglikane, mirëpo ajo bën edhe përshtatjen e mësimit ndaj ndryshimeve që ndodhin në botën moderne.

Bashkë me të krishterët e kishave të tjera, edhe metodistët besojnë në Zotin një. Ekziston vetëm një Zot i gjallë e i vërtetë, që ka fuqi, urtësi dhe mirësi të pafundme.

Ata besojnë se Jezu Krishti është Bir i Zotit që ka lindur në tokë nga virgjëresha Mari. Derisa ka jetuar në tokë, ai u ka predikuar njerëzve shkencën hyjnore.

Bibla është libër i shenjtë dhe metodistët udhëhiqen sipas saj për mësimin e fesë. Shkrimi i Shenjtë përmban librat e Dhiatës së Vjetër dhe Dhiatës së Re. Kjo do të thotë se edhe metodistët, njëlloj sikurse edhe të krishterët e tjerë, i respektojnë Dhjetë Urdhëresat e Zotit, të cilat Zoti ia kishte dhënë profetit Mojsi në Dhiatën e Vjetër, kurse si dy urdhëresat më të mëdha, ata i pranojnë urdhurat e Krishtit:

Duaje Hyjin, Zotin tënd me gjithë zemrën tënde, me gjithë shpirtin tënd dhe me gjithë mendjen tënde;

Duaje të aférmin tënd sikurse vetveten.

### Kisha

Kisha është bashkësia e besimtarëve, ku predikohen mësimet e Zotit. Që kisha të mund t'i kryejë obligimet e saj, ajo ka nevojë për njerëz që kryejnë shërbime të caktuara. Në kishën evangjeliste – metodiste ka dhjakë, klerikë (priftërinj – pastorë) dhe peshkopë. Peshkopët, po ashtu, janë klerikë, por me detyrime të posaçme dhe janë përgjegjës për jetën kishtare të besimtarëve në një lëmi. Ata sjellin vendime që kanë të bëjnë me mësimet dhe me disiplinën kishtare. Përveç dhjakëve, klerikëve dhe peshkopëve, në kishë ka edhe shërbyses të tjerë, për shembull, predikues laikë dhe ndihmës të predikuesve. Të gjithë këta persona, që predikojnë Ungjillin, duhet të dallohen për një disiplinë të madhe kishtare dhe duhet të janë shembull për besimtarët të cilëve ua mësojnë fenë. Të gjitha shërbimet në kishë janë të hapura njëlloj, si për meshkujt, ashtu edhe për femrat. Secili është i ftuar që të ketë qasje në punën dhe në shërbimin e jetës kishtare.



**Kisha evangjeliste – metodiste  
në Strumicë**

## Kisha evangjeliste – metodiste në Maqedoni


Kisha evangjeliste – metodiste në Maqedoni ekziston më shumë se 150 vjet dhe lidhet me ardhjen në Maqedoni të misionares metodiste amerikane Mis Elen Stoun. Ajo ishte kujdesur për edukimin e vajzave të reja, kishte udhëtuar nëpër Maqedoni dhe kishte mbajtur seminare për gratë dhe vajzat. Në vitin 1901, ajo u kidnapua nga çeta e Jane Sandanskit dhe Hristo Çernopeev-it dhe qëndroi 6 muaj të plota nëpër malet e Maqedonisë me luftëtarët për çlirimin e Maqedonisë. Ajo u lirua pasi Misioni kishte paguar për të 14.000 lira ari turke. Sot, bashkësia më e madhe evangjeliste – metodiste në Maqedoni gjendet në Strumicë. Ekzistojnë edhe bashkësi kishtare në Shkup, Radovish, Koçanë, Prilep dhe në Manastir.



Misionarja Mis Elen Stoun

## Festat fetare të kishës evangjeliste – metodiste

Sikurse shumica e kishave të krishtera, edhe kisha evangjeliste – metodiste feston këto festa: Krishtlindjet, Pashkët, Ngritjen e Jezusit, Rrëshajat dhe çdo të diel.



**Le të mendojmë dhe le të bisedojmë**

1. Kush është themeluesi i mësimit evangjelist – metodist?
2. Si i kanë quajtur njerëzit që kanë predikuar mësimin evangjelist – metodist?
3. A besojnë metodistët te Jezu Krishti?
4. Cili libër është i shenjtë për të krishterët metodistë?
5. Çka paraqet kisha për metodistët?
6. Kush janë shërbyesit në kishën evangjeliste – metodiste?
7. Cila misionare e ka predikuar e para mësimin evangjelist – metodist në Maqedoni?
8. Në cilat qytete të Maqedonisë ekzistojnë kishat evangjeliste – metodiste?
9. Cilat festa i festojnë të krishterët metodistë?

## BAZAT ETIKE TË MËSIMEVE EVANGJELISTE – METODISTE

Kisha metodiste nuk u krijua për shkak të dallimeve në mësimë, por për shkak të nevojës shpirtërore të njerëzve që shkuan në tokën e re (në Amerikë).

Përkushtimi fetar në jetë zë një vend qendror në mësimet e metodistëve. Ai ka të bëjë, para së gjithash, me dashurinë ndaj Zotit, ndaj të afërmve dhe me pastërtinë morale.

Në bazën e etikës së kishës evangjeliste – metodiste qëndron dashuria e Zotit ndaj të gjithë njerëzve. Bibla është themeli i besimit metodist, ndërsa Jezu Krishti është personaliteti qendror në fenë e metodistëve dhe në jetën e tyre.

Të krishterët evangjelistë – metodistë kuptojnë si përgjegjësi të tyre përparimin moral dhe shpirtëror, i cili duhet të jetë në pajtim me mësimet e Krishtit, të shkruara në Bibël. Kjo do të thotë se etika është e lidhur me mësimin e Biblës. Nëse sillemi në jetë ashtu siç na rekomandon Shkrimi i Shenjtë, atëherë ne do të jemi qytetarë të mirë në çdo shoqëri.

Etika evangjeliste – metodiste mëson se besimtarët duhet të kundërshtojnë: të keqen, kushtet jonjerëzore nëpër burgje, robërinë, alkoolizmin, eksplloatimin e fëmijëve, si edhe veprat e tjera johumane. Ata duhet të shprehin dashuri, mëshirë dhe drejtësi ndaj të gjithë njerëzve. Për metodistët është e rëndësishme që t'i ftojnë njerëzit në fe dhe t'u ndihmojnë atyre për njohjen e dashurisë së Zotit.



**Bibla – baza e etikës  
evangjeliste – metodiste**

### Këshillat etike të Xhon Ueslit, sipas të cilave duhet të udhëhiqen të krishterët metodistë

Të krishterët evangjelistë – metodistë duhet të përpiken që të mos bëjnë keq dhe, gjithashtu, duhet t'i largohen secilit lloj të së keqes. Posaçërisht, duhet të largohen prej atyre gabimeve të cilat bëhen më së shpeshti, si për shembull:

-përdorimi i kotë i emrit të Zotit;

-mosrespektimi i ditës së Zotit duke bërë punë të zakonshme ose duke blerë dhe duke shitur pikërisht në atë ditë;

- dehja, blerja dhe shitja e pijeve alkoolike, përveç në rastet ekstreme të nevojave;
- posedimi i robërve, blerja dhe shitja e robërve në të kaluarën;
- rrahja, zënka, gjykimi i vëllait kundër vëllait, kthimi i të keqes me të keqe ose çfarëdo hakmarrje

- bërja pazar me rastin e blerjes ose shitjes;
- blerja ose shitja e mallrave, për të cilat nuk është paguar taksë ose doganë;
- dhënia ose marrja e gjërave me kamata joligjore;
- biseda të kota dhe jo të këndshme;
- të folurit keq për dikë, posaçërisht për kryesorët;
- të bërit të tjerëve atë që nuk do të donim të na e bënин neve;
- këndimi i këngëve ose leximi i librave që janë në kundërshtim me mësimet e Zotit;
- huazimi pa u kujdesur se si do ta kthejmë borxhin.

Në vend të këtyre gabimeve, çdo besimtar i mirë duhet të kujdeset që të arrijë këto cilësi:

- të bëjë mirë në çdo aspekt, sipas forcave dhe mundësive personale;
- të jetë i mëshirshëm;
- të kujdeset për t'i ushqyer njerëzit e uritur;
- t'u japë veshmbathje njerëzve që nuk kanë;
- të vizitojë të sëmurët ose të burgosurit;
- t'i mësojë, t'ua tërheq vërejtjen dhe t'i trimërojë njerëzit në fe;
- të tregojë interesim më të madh për punën dhe për mësimin;
- të jetë modest dhe kursimtar.

Këto janë rregullat e përgjithshme të etikës evangjeliste – metodiste. Ato janë udhëtregues i vetëm në fe dhe në jetën e besimtarëve. Për këtë, secili besimtar duhet të përpinqet që të jetojë sipas tyre dhe që t'ua mësojë këto njerëzve të tjerë.

## Ndihma e të varfërve

Çdo njeri duhet të ndajë diçka prej pasurisë së tij dhe t'i ndihmojë të varfrit me të. Dhënia e lëmoshës duhet të jetë vullnetare dhe në varësi të mundësive të të krishterëve. Nëse ndonjë besimtar nuk ka mundësi që t'i ndihmojë materialisht të varfrit, ai duhet të mendojë se si mund t'i ndihmojë ata në ndonjë mënyrë tjeter. Për shembull, me anë të punës vullnetare në disa organizata humanitare, siç është për shembull Kryqi i Kuq, ose në organizatat që janë në përbërje të kishës për t'i ndihmuar të sëmurët, të varfrit, pleqtë dhe njerëzit e pafuqishëm.

## Raporti i kishës evangjeliste – metodiste ndaj kishave të tjera të krishtera dhe ndaj bashkësive religjioze

Metodistët përpiken për unitet me të krishterët e kishave të tjera të krishtera. Kjo për arsy se të gjithë të krishterët, nëpërmjet pagëzimit dhe kungimit, bashkohen me Krishtin dhe bëhen një trup me Krishtin. Për këtë shkak, uniteti i krishterë është dhuratë të cilën e pranojmë dhe e cila duhet të jetësohet në vepër. Çdo i krishterë, sipas metodistëve, duhet të përpiqet që ta ndihmojë këtë unitet në nivelin lokal dhe nacional, si edhe gjithkund nëpër botë. Metodistët i pranojnë kishat e tjera të krishtera dhe janë të gatshëm ta pranojnë sekretin e shenjtë të Zotit në darkë me të krishterët dhe me kishat e tjera simotra.

Kisha evangjeliste – metodiste mban raporte të mira, si me të krishterët, ashtu edhe me pjesëtarët e religjioneve të tjera. Me një raport të tillë ndaj të gjithë njerëzve, të krishterët metodistë përpiken të dëshmojnë në vepër se Zoti, i Cili e ka dërguar Jezu Krishtin për shpëtimin e botës, është Krijues i të gjithë popujve.

Metodistët përpiken dhe marrin pjesë në dialogun ndërkishtar dhe ndërengjioz në mes besimtarëve. Qëllimi i këtyre takimeve nuk është kërkimi i dallimeve në mes feve dhe religjioneve, por gjetja e lidhjeve të përbashkëta për respekt dhe bashkëpunim.

Kisha evangjeliste – metodiste në Maqedoni ka qenë gjithmonë e hapur për bashkëpunim me kishat dhe me bashkësitë e tjera religjioze. Ajo, posaçërisht, ka ndërtuar marrëdhënie të mira me Kishën Ortodokse Maqedonase, me Bashkësinë Islame, me Kishën Katolike dhe me Bashkësinë Hebraike.

### Le të mendojmë dhe le të bisedojmë

1. Cila është baza e etikës së kishës evangjeliste – metodiste?

2. Me çka duhet të përshtatet përgjegjësia e përparimit moral dhe shpirtëror të besimtarëve?

3. A është e lidhur etika evangjeliste – metodiste me mësimin e Biblës?

4. A do të jemi qytetarë të mirë të shoqërisë nëse sillemi ashtu siç e kërkon Bibla?

5. Cilat gjëra duhet t'i kundërshtojnë besimtarët sipas etikës së kishës evangjeliste – metodiste?

6. Cilat gabime duhet t'i largojnë posaçërisht të krishterët metodistë?

7. Cilat cilësi duhet të kujdeset që t'i përfitojë çdo besimtar i mirë?

8. Si duhet t'u ndihmojmë të varfërve?

9. Çfarë raportesh përpiqet të mbajë kisha evangjeliste – metodiste me kishat dhe me bashkësitë e tjera fetare?

10. A i respektojnë metodistët besimtarët e kishave të tjera të krishtera dhe të bashkësive të tjera fetare?

11. Cili është raporti i kishës evangjeliste – metodiste në Maqedoni me kishat dhe me bashkësitë e tjera në Maqedoni?

## BAZAT E MORALIT EVANGJELIST – METODIST

Sikurse për të gjithë të krishterët, ashtu edhe për metodistët, morali është shumë i rëndësishëm në jetë. Libri kryesor i metodistëve, prej nga ata e nxjerrin mësimin e tyre moral, është Shkrimi i Shenjtë – Bibla. Dhjetë Urdhëresat e Zotit janë themeli i mësimit të tyre moral. Dy urdhëresat e Krishtit, për dashurinë ndaj Zotit dhe ndaj të afërmve, vlejnë edhe te metodistët, sikurse te të gjithë të krishterët.

Mësimi i tyre fetar është i ngjashëm me atë të bashkësive të tjera protestante.

Parimi kryesor i metodistëve është që, përveçse të kujdesen për shpëtimin e shpirtrave të besimtarëve, të kujdesen edhe për nevojat trupore të njerëzve. Xhon Uesli mendon se menjëherë pas devotshmërisë duhet të jetë edhe pastërtia.

Në bashkësinë e metodistëve, njerëzit duhet të ndihmohen reciprokisht. Ata, gjithkund nëpër botë, ndiejnë përgjegjësi edhe për situatën sociale në shtetin e tyre. Kujdesi për të varfrit është obligim shumë i rëndësishëm për besimtarët e kishës evangjeliste – metodiste. Për këtë qëllim, Xhon Uesli ka themeluar edhe një fondacion në të holla për t'i ndihmuar të varfrit. Kisha evangjeliste – metodiste ka ndërtuar një qendër sociale në Strumicë, përmes së cilës kujdeset për besimtarët e varfër.

Religjioni, sipas metodistëve, nuk mund të ndahet nga realiteti dhe për këtë duhet të luftojë kundër çdo padrejtësie dhe kundër çdo të keqeje.

### Si ta kuptojmë se cila këshillë është e mirë, e cila e keqe?

”Eja,” - tha Agimi – ”eja pas meje!” Bujari hipit në bicikletë dhe u nis pas tij, duke u përpjekur që ta ndiqte. Ai e ndoqi në një shteg të ngushtë, më pas e kaloi rrugën, e ndoqi pas një ndërtese dhe, më në fund, kaloi në një rrugë tjeter. Djemtë u ndalën tek udhëkryqit që të merrnin frymë. Këtu ishte kufiri deri ku ishin lejuar që të shkonin. Mirëpo, Agimi vazhdoi që ta ngiste bicikletën dhe tha: ”Vazhdojmë!”



**Qendra sociale e kishës evangjeliste – metodiste në Strumicë**

Bujari deshi ta ndiqte, mirëpo e dinte se do të gabonte po të vepronte kështu. Ai kishte lexuar në Librat e Shenjta se prindërit duhet të respektohen, kurse tani, nëse do ta dëgjonte Agimin, nuk do t'i respektonte prindërit e tij, të cilët e kishin këshilluar të mos kalonte matanë atij vendi. Për këtë arsy, ai vendosi që të kthehej në shtëpi.

\*Ashtu sikurse ideja e keqe e shokut, edhe këshilla e keqe të bën që ta ndiesh veten jo mirë. Zoti të ndihmon që ta kuptosh se a është e mirë apo e keqe këshilla që ta jep dikush. Këshilla e mirë është gjithmonë në pajtim me Librat e Shenjta. Sa më shumë që i lexon Librat e Shenjta, aq më shumë do të dish të vlerësosh se cila këshillë është e mirë, e cila jo.

Diçka e drejtë ndoshta nuk është gjithmonë e dëshiruar. Bujari e dinte këtë. Ndoshta ai dëshironte që të vazhdonte ta pasonte Agimin, mirëpo ai vendosi që të kthehej në shtëpi.

A do të kërkosh prej Zotit të të ndihmojë që ta kuptosh dhe të bësh atë që është e drejtë?



### Le të mendojmë dhe le të bisedojmë

1. Prej ku buron mësimi moral në kishën evangjeliste – metodiste?
2. Cili kujdes konsiderohet si shumë i rëndësishëm në kishën evangjeliste – metodiste?
3. Çfarë qendre ka ndërtuar kisha evangjeliste – metodiste në Strumicë?
4. A duhet të kërkojmë këshilla prej njerëzve të tjerë?
5. Si mund të dimë të vlerësojmë se cila këshillë është e mirë, e cila e keqe?

## BAZAT TEORIKE TË HEBRAIZMIT

### Bazat e hebraizmit

Religjioni hebraik ose judaizmi predikon besimin në një Zot pa trup, besimin në një Zot vetëm shpirtëror. Zoti paraqet tërësinë e përsosurive morale dhe kërkon prej njerëzve dashuri dhe drejtësi. Religjioziteti hebraik realizohet duke qenë i dëgjueshëm ndaj "ligjit të Zotit."

### Librat e shenjta të hebraizmit

Libri i shenjtë, i njëjtë si për të krishterët po ashtu edhe për hebrenjtë, është Dhiata e Vjetër të cilën besimtarët hebraikë e quajnë Tora. Libri i shenjtë, Tora, flet për historinë, luftërat ideore dhe shoqërore të popullit hebraik, por ai përmban njëherësh edhe dispozita fetare dhe juridike. Përveç Torës, në jetën fetare të hebrenjve, një vend të rëndësishëm zë edhe Talmudi (hebraisht: mësim). Ai është një përbledhje e gojëdhënave të përgjithshme me komentime dhe shërben për rregullimin e raporteve religjioze-juridike të popullit hebraik. Talmudi përbëhet nga dy pjesë: Mishna (teksti i mësimit) dhe Gemara (shpjegimi i mësimit). Për hebrenjtë janë të obligueshme edhe një numër i madh i dispozitave të ritualeve, si dhe dispozitat rrëth pastërtisë dhe përdorimit të ushqimit.



Talmudi

### Simbolet e hebraizmit

Ylli i Davidit dhe menora janë simbolet kryesore të religionit hebre. Ylli i Davidit e ka marrë emrin nga mbreti hebre Davidi (lexo për jetën dhe veprën e mbretit David në Shkrimin e Shenjtë të Dhiatës së Vjetër). Menora është një mbajtëse qirinjsh me shtatë degë, të cilën hebrenjtë e përdorin gjatë ritualeve të tyre fetare.



Ylli i Davidit

## Tempulli dhe Sinagoga

Hebrenjtë kanë besuar se duhet të ekzistojë vetëm një tempull. Tempulli ishte vendi i vetëm ku ata kishin mundur t'i kryen ritualet e sakrificave të tyre. Kur të gjithë hebrenjtë jetonin në Jude, ata kishin pasur mundësi që të shkonin të përkuleshin në tempullin e Jerusalemit. Mirëpo, tempulli i Jerusalemit, në vitin shtatëdhjetë të erës së re, u rrënuar nga ushtria romake dhe hebrenjtë u shpërngulën gjithkund nëpër botë. Të organizuar në bashkësi më të vogla nëpër vendet në të cilat jetonin, hebrenjtë filluan të ndërtonin sinagoga. Sinagoga është ndërtesa në të cilën kryhen lutjet dhe ritualet fetare të hebraizmit. Nëpër sinagoga hebrenjtë luten, këndojnë këngë fetare, lexojnë libra fetare dhe mësojnë fenë e tyre. Por, ata nuk i kryejnë aty ritualet e sakrifikimit, siç kishte qenë zakon derisa kishte ekzistuar tempulli i Jerusalemit.



Tempulli i Jerusalemit

## Rabini

Rabin (në gjuhën hebraike: mësuesi im) është klerik hebre dhe kryesues i një komune fetare. Statusi i rabinit arrihet me studimin shumëvjeçar të Torës dhe Talmudit.



## Festat më të rëndësishme hebraike

Shabat – dita e shenjtë e pushimit – festa më e rëndësishme  
 Roshha-Shana – Viti i Ri – përvjetori i krijimit të botës  
 Jom Kipur – dita e pajtimit dhe e pendimit  
 Sukot – festa e tendës  
 Hanuka – festa e dritat  
 Purim – festa e shpëtimit  
 Pas'ha – festa e çlirimt



## Le të mendojmë dhe le të bisedojmë

1. Në çfarë Zoti besojnë hebrenjtë?
2. Cilat libra konsiderohen të shenjta në hebraizëm?
3. Cilat janë simbolet fetare të hebraizmit?
4. Si quhet vendi ku hebrenjtë tubohen përlutje?
5. Si quhet kleriku hebre?
6. Cilat festa fetare festohen në hebraizëm?

## BAZAT ETIKE TË HEBRAIZMIT

### Urdhëresat e Zotit në hebraizëm

Zoti ia ka dhënë ligjin njeriut që t'i tregojë atij se si duhet të jetojë në tokë, se si të sillet drejt dhe si të bëjë mirë. Këto ligje janë të shkruara në librin që, në gjuhën hebraike, quhet Tanah. Pjesë përbërëse e Tanahut është edhe Tora. Atë që të krishterët e quajnë Shkrimi i Shenjtë i Dhiatës së Vjetër, ajo për hebrejtë është libri i shenjtë, Tora.

Qysh në fillim të zhvillimit të religionit hebraik, Zoti kishte dhënë ligje morale të sjelljes së njerëzve në tokë. Ato janë të shkruara në Torë dhe quhen Aseret Hadiberot, që të përkthyera do të thonë: Dhjetë Fjalët e Zotit (Urdhëresat). Katër urdhëresat e para të Zotit rregullojnë raportin e njeriut ndaj Zotit, ndërsa gjashtë të tjera flasin për marrëdhëniet reciproke në mes njerëzve. Këto ligje të Zotit vlejnë edhe sot, si për hebrejtë, ashtu edhe për popujt dhe përfetë e tjera.

Në këto libra ekzistojnë edhe dispozita të tjera etike: përpjekja për drejtësi dhe dashuri ndaj të afërmve, marrëdhëniet ndaj të varfërve dhe vejushave, përmoralin tregtar etj.

Njeriu është krijuar me vullnet të lirë dhe atij i është dhënë mundësia që të zgjedhë: a do të pasojë rrugën e mirë për të cilën Zoti do ta shpërblejë, apo do të zgjedhë rrugën e keqe, për të cilën pason dënimini. Mirëpo, pasi që Zoti është i mëshirshëm, njeriu gjithmonë mundet të pendohet sinqersisht për sjelljen e tij të keqe dhe të kthehet në rrugën e mirë për të cilën na mëson hebraizmi.

### Micva – ligji

Micva në gjuhën hebraike do të thotë urdhri kryesor i Zotit. Zoti ia ka dhënë Mojsiut Urdhëresat dhe Torën në Malin e Sinait. Në hebraizëm ekzistojnë 613 urdhëresa. Disa prej tyre kanë të bëjnë me atë se çfarë duhet të bëjë njeriu, ndërsa disa të tjera janë ndalesa rrith asaj se çfarë nuk duhet të bëjë njeriu.

Në kohën e sotme, fjala micva përdoret edhe si sinonim për kryerjen e veprave të mira. Micvot (shumësi i micva) përcakton rregulla dhe obligime rrith sjelljes në jetën e përditshme, dispozita përmirëmbajtjen e pastërtisë së trupit dhe dispozita rrith ushqimit.

## Kosher – ligji hebraik për ushqimin

Kosher është ligji fetar hebraik për ushqimin, që gjendet i shkruar në Tora. Atje shkruhet se cilin ushqim e kanë të lejuar ta hanë hebrenjtë, e cilin e kanë të ndaluar.

Detyrë e amvisës tradicionale hebraike është që të ruajë pastërtinë religjioze në shtëpi dhe një prej obligimeve të saj të shumta është që të kujdeset që ushqimi që hahet të jetë i pastër (kosher). Kosher është ushqimi që i plotëson kërkuesat e ligjeve fetare hebraike. Sipas ligjit hebraik, mishi dhe prodhimet e qumështit nuk duhet të shërbehen në të njëjtën sofër. Nëse hahet mish, atëherë nuk duhet të ketë gjalpë në sofër, e as nuk duhet të pihet qumësht. Me qëllim që këto ushqime të mos përzihen, përdoren enë të veçanta për përgatitjen e mishit dhe të prodhimeve të qumështit. Lejohen të hahen vetëm disa lloje mishi, si për shembull: i qengjit, i viçit dhe i pulës. Mishi i derrit dhe guacat hyjnë në ushqimet e ndaluara.

Me rastin e therjes së kafshëve, duhet të respektohen dispozitat e ligjit hebraik. Në ligj ekzistojnë instruksione të sakta se si të theret kafsha, në mënyrë që gjaku të rrjedhë më shpejt prej trupit, me qëllim që kafsha të përfjetojë më pak dhembje. Mishi i kafshës, pasi ajo të theret sipas dispozitave, duhet të futet në ujë të ftohtë dhe të kripet, me qëllim që të largohen të gjitha mbetjet e gjakut.

Hebrenjtë iu përbahen këtyre dispozitave të ushqimit dhe ata lutën para çdo ngrënje.



### Le të mendojmë dhe le të bisedojmë

1. Sipas hebraizmit, pse Zoti i ka dhënë urdhëresa njeriut?
2. A duhet t'i respektojnë hebrenjtë Dhjetë Urdhëresat e Zotit?
3. Çka do të thotë fjala micva?
4. Çka është kosher?
5. Çfarë ushqimesh nuk guxojnë të përzicnjë hebrenjtë gjatë ngrënies?

## MORALI NË HEBRAIZËM

### Familja – themeli i bashkësisë hebraike

Themeli i bashkësisë hebraike gjithmonë ka qenë dhe ka mbetur familja. Qysh prej kohërave më të lashta ka ekzistuar micva (urdhri) për respektimin e prindërve. Kjo është e shkruar qartë në Dhjetë Urdhëresat e Zotit. Ashtu sikurse fëmijët që e kanë për obligim që t'i respektojnë prindërit, ashtu edhe prindërit e kanë për detyrë prindërore që t'i edukojnë fëmijët në fenë hebraike, që t'i arsimojnë dhe t'i orientojnë saktë në jetë, në mënyrë që ata të bëhen anëtarë të mirë të shoqërisë dhe që ta respektojnë pasurinë e tyre.

Sipas ligjit hebraik, hebre konsiderohet ai që ka lindur prej një nënë hebraike. Në ditën e tetë pas lindjes, fëmijët meshkuj bëhen synet. Ky është një ritual religjioz dhe me këtë rast fëmija merr emrin e tij hebraik. Në vitet e para, nëna është përgjegjëse për edukimin e tij religjioz. Rreth moshës pesëvjeçare, hebreu ndjek orët që mbahen në sinagogë për ta mësuar fenë. Një prej aktiviteteve, në orët e mësimit të fesë, është edhe mësimi i gjuhës hebraike dhe studimi i librit të shenjtë.

Në religionin hebraik, është një manifestim i madh për prindërit dhe fëmijët kur vajzat i mbushin 12 vjet, kurse djemtë 13 vjet. Në këtë moshë ata konsiderohen fetarisht të moshërritur. Ekziston edhe një ritual fetar me të cilën shpallet moshërritja. Për djemtë ky ritual quhet bar micva (djali i urdhrit), kurse për vajzat bat micva (vajza e urdhrit). Pas këtij akti, secili bëhet përgjegjës për veprimet dhe veprat e tij.

### Vlerat morale të hebraizmit

Të jetosh sipas vlerave morale hebraike do të thotë të kesh një jetë të përforcuar me anën e drejtësisë dhe shenjtërisë dhe një ndikim pozitiv të sjelljes ndaj vvetes dhe ndaj të tjerëve.

Në religionin hebraik, çmohen posaçërisht këto virthye:

- të qenët i qetë,
- miqësia,
- realizimi i drejtësisë dhe mëshira,
- e vërteta,
- falja,
- mikpritja,

-të qenët i sjellshëm,  
-dashuria dhe respekti ndaj të tjerëve,  
-guximi,  
-gëzimi dhe lumturia,  
-kujdesi për trupin,  
-përkrahja,  
-frikë/respekti,  
-kujdesi dhe  
-paqja në shtëpi dhe në familje.



Fëmijët mësojnë fenë hebraike  
(fotografi në fillim të shek. XX)



### Le të mendojmë dhe le të bisedojmë

1. Cili është themeli i bashkësisë hebraike?
2. Çfarë obligimi kanë hebrenjtë ndaj fëmijëve të tyre?
3. Çfarë obligimi kanë fëmijët ndaj prindërve të tyre?
4. Kur e arrijnë moshën e rritjes vajzat dhe djemtë në hebraizëm?
5. Numëroj disa virtute që janë posaçërisht të çmuara në hebraizëm.

## BAZAT TEORIKE TË ISLAMIT

Allahu xhel-le she'nuhu është Krijues i gjithësisë dhe Krijues i njeriut. Andaj çdo njeri është i obliguar t'i njohë detyrat dhe obligimet e tij ndaj Krijuesit të vet.

Fjala “Islam”, në kuptimin etimologjik do të thotë dorëzim, ndërsa në atë terminologjik “fe e shpallur nga ana e Allahut xhel-le she'nuhu te të gjithë pejgamberët, që ka për qëllim rregullimin e jetës së njerëzve në tokë”. Nga kjo nënkuptohet se besintari i dorëzohet Allahut xhel-le she'nuhu në të gjitha veprimet e tij.

Islami si fe është një sistem i kompletuar, i cili rregullon jetën e njeriut në të gjitha sferat, e në veçanti atë etike, shpirtërore dhe edukativo-morale.

Në lëndën “Etika në mësimin islam”, nxënësit do të edukohen dhe do të arsimohen në atë mënyrë që të gjitha veprat e tyre duhet t'i lidhin me Allahun xhel-le she'nuhu. Pra, në shtëpi, në shkollë, në punë, në rrugë, në xhami e gjetiu, duhet të ketë bindjen se Allahu e përcjell atë kudo.

Ndonëse njeriu është i formuar prej shpirtit dhe materies, atëherë etika islame i mëson nxënësit se si t'i plotësojnë të gjitha nevojat shpirtërore, morale dhe materiale.

Bazuar në këtë, mund të thuhet se roli i fesë në jetën e njeriut është shumë i rëndësishëm, sepse feja njeriun e mbanë në lidhje të vazhdueshme me Allahun xhel-le she'nuhu. E urdhëron për çdo vepër të mirë që i sjell dobi atij, familjes, rrethit ku jeton dhe mbarë shoqërisë dhe e ndalon nga çdo vepër që e dëmon tonë, familjen, rrethin ku jeton dhe mbarë shoqërinë.

Përbajtjet e etikës në mësimin islam i plotësojnë lëndët e tjera, sepse nuk ka kundërshtim midis të vërtetave shkencore dhe parimeve fetare islame. Feja burim e ka fjalën e Allahut, ndërsa shkenca objekt studimi e ka natyrën, e cila gjithashtu është krijuar i Allahut. Prandaj, nuk mund të ketë kundërshtim mes fjalës së Allahut dhe kriesave të Tij.

Lënda “Etika në mësimin islam” i edukon dhe i arsimon nxënësit, se me zbatimin e ligjeve dhe rregullave fetare njeriu siguron një jetë të lumtur, ndërsa në botën tjetër siguron shpërblim dhe shpëtim në xhenetin e Allahut xhel-le she'nuhu.

**Rabbi jessir ve la tuassir, rabbi  
temmim bil hajri. Amin**

O Zot, na i lehtëso e mos na i vështirëso  
punët tonë!

O Zot, na i plotëso ato me të mirë! Amin.



## MOS HARRO!

- Allahu xhel-le she'nuhu ka krijuar gjithçka që ekziston;
- Allahu xhel-le she'nuhu ka krijuar njeriuun në formën më të bukur;
- Të gjithë njerëzit janë të barabartë para Allahut xhel-le she'nuhu, pa marrë parasysh racën, gjininë, gjuhën etj.
- Më i afërt me Allahun xhel-le she'nuhu është vetëm ai që është më i devotshëm;
- Feja i plotëson të gjitha nevojat e jetës së njeriut;
- Nuk ka kundërshtim midis Islamit dhe të vërtetave shkencore;
- Feja islame siguron lumturi në këtë botë dhe shpëtim në ahiret.



## Le të mendojmë dhe le të bisedojmë

1. Çka ka krijuar Allahu xhel-le she'nuhu?
2. Kë e ka krijuar Allahu xhel-le she'nuhu në formën më të bukur? Përshkruaje si?
3. A janë të barabartë të gjithë njerëzit para Allahut xhel-le she'nuhu?
4. Si i plotëson feja të gjitha nevojat e jetës së njeriut?
5. Pse nuk ka kundërshtime mes Islamit dhe shkencës?

## BAZAT E MËSIMIT ISLAM (BESIMI ISLAM)

I tërë islami është i lidhur ngushtë me tri çështje kryesore: me bindjen në Allahun xhel-le she'nuhu, me bindjen në Muhamedin alejhis-selam si pejgamber dhe me bindjen në Kuranin si libër i shpallur nga ana e Allahut.

## KUSHTET E BINDJES (IMANIT)

Islami është bindje me mend, dashuri me zemër dhe zbatim me vepra.

Islami përbëhet prej gjashtë kushteve themelore:

1. Bindja në Allahun xhel-le she'nuhu (amentu bil-lahi)
2. Bindja në melekët e Tij (ve melaiketih)
3. Bindja në librat e Tij (ve kutubihi)
4. Bindja në pejgamberët e Tij (ve rusulihi)
5. Bindja në Ditën e Gjykimit (vel jevmil ahiri)

Bindja në caktimin e Allahut dhe se ringjallja pas vdekjes është e vërtetë (ve bil kaderi hajrihi ve sherrihi minellahi teala vel ba'thu ba'del mevti hakkun)

### KUSHTI I PARË I BESIMIT

#### Bindja në Allahun xhel-le she'nuhu (amentu bil-lahi)

Muslimani duhet të bindet se Allahu xhel-le she'nuhu është Krijues i gjithësisë. Çdo gjë që është në natyrë, duke përfshirë qiellin, diellin, hënën, yjet, tokën dhe të gjitha kriesat e gjalla, përfshirë këtu edhe njeriun, janë krijesa të Allahut xhel-le she'nuhu. Të gjitha këto rregulla që dominojnë në natyrë dhe në kriesat e ndryshme, bëjnë të qartë ekzistimin e Allahut xhel-le she'nuhu.

### KUSHTI I DYTË I BESIMIT

#### Bindja në melekët e Allahut xhel-le she'nuhu (ve melaiketih)

Melekët janë krijesa të padukshme, të krijuara nga drita. Ata nuk gabojnë asnjëherë. Nuk hanë, nuk pinë, nuk flenë, nuk martohen e as nuk kanë gjini. Detyra e tyre është adhurimi i Allahut xhel-le she'nuhu. Numri i melekëve është i madh, por këtë numër e di vetëm Allahu

xhel-le she'nuhu

Melekët më të njohur janë: Xhebraili, Mikaili, Israfil, Meleku i vdekjes (Azraili), Kiramen katibin, Munkiri dhe Nekiri etj.

Detyrat e tyre janë:

**Xhebraili** ka përcjellë shpalljet e Allahut te pejgamberët në tokë.

**Mikaili** është i angazhuar me caktimin e furnizimit, si dhe me dukuritë natyrore: shiun, diellin, erën etj.

**Israfil** ka për detyrë dy herë të fryj në Sur. Kur të fryj herën e parë, të gjitha krijesat e gjalla do të vdesin, ndërsa kur të fryj herën e dytë, të gjitha krijesat do të ngjallen dhe do të dalin para Allahut xhel-le she'nuhu

**Azraili** merr shpirtrat e njerëzve në momentin e vdekjes. Këtë e bënë së bashku me melekët e tjera.

**Kiramen katibinë** përcjellin njeriun gjithnjë, duke i shkruar të gjitha veprat e tij, qofshin të mira ose të këqija.

**Munkiri** dhe **Nekiri** pyesin të vdekurit pas varrimit. Ata të vdekurin e pyesin: Kush është Zoti yt? Kush është pejgamberi yt? Cila është feja juaj?

### KUSHTI I TRETË I BESIMIT

#### Bindja në librat e Allahut xhel-le she'nuhu (ve kutubihi)

Librat e Allahut janë shpallje, të cilat Allahu xhel-le she'nuhu ua ka zbritur pejgamberëve nëpërmjet melekut Xhebrail. Këto shpallje përfshijnë udhëzime, këshilla, lutje dhe rregulla për jetë. Shpalljet e Allahut xhel-le she'nuhu janë përfshirë në 100 suhufe (fletushka) dhe 4 libra të mëdha.

Ato janë:

1. **Tevrati** – i është shpallur Musait alejhis-selam
2. **Zeburi** – i është shpallur Davudit alejhis-selam
3. **Inxhili** - i është shpallur Isait alejhis-selam
4. **Kurani** - i është shpallur Muhamedit alejhis-selam



### KUSHTI I KATËRT I BESIMIT

#### Bindja në Pejgamberët e Allahut xhel-le she'nuhu (ve rusulihi)

Pejgamberët e Allahut xhel-le she'nuhu janë njerëz të zgjedhur, të cilëve Allahu ua ka zbritur shpalljet nëpërmjet melekut Xhebrail. Në Kuran përmenden 25 pejgamberë, ndërsa sipas hadithit të Muhamedit alejhis-selam flitet për 124.000 pejgamberë.

Pejgamberët më të njohur janë: Ademi, Nuhi, Ibrahim, Musai, Isai dhe Muhamedi alejhimus-selam. Pejgamber i parë është Ademi alejhis-selam, ndërsa i fundit Muhamedi alejhis-selam, me të cilin kanë përfunduar shpalljet.



## KUSHTI I PESTË I BESIMIT

### **Bindja në Ditën e Gjykimit (vel jevmil ahiri)<sup>1)</sup>**

Dita e Gjykimit është ditë kur Allahu xhel-le she'nuhu i jep fund jetës së krijesave në këtë botë. Kur Israfil i fryjn Surit për herë të dytë, të gjithë të vdëkurit do të ngjallen dhe do të dalin para Allahut për të dhënë llogari për veprat e tyre. Secilit person në Ditën e Gjykimit do t'i paraqiten veprat që i ka bërë, të cilat i kanë shkruar melekët kiramun katibine. Të gjitha veprat do të maten në peshoren e njojur me emrin Mizan.

Ai që ka vdekur besimtar dhe ka më shumë vepra të mira do të shpërblehet me xhenet, ndërsa mosbesimtarë do të futet në xhehenem. Xheneti është vend në ahiret, ku do të vendosen besimtarët në mënyrë të përhershme, varësisht prej veprave të tyre që i kanë bërë. Xhehenemi është vendbanim i përhershëm i mosbesimtarëve, ku do të dënohen për mëkatet e tyre.

Allahu xh.sh, e ka caktuar paraprakisht Ditën e Gjykimit, por kur do të ndodhë ajo, e di vetëm Ai.

## KUSHTI I GJASHTË I BESIMIT

### **Bindja në caktimin e Allahut xhel-le she'nuhu (ve bil kaderi hajrihi ve sherrihi minellahi teala)**

Duhet të besohet se çdo gjë që ndodhë, është me caktimin e Allahut xhel-le she'nuhu. Ai i cakton të gjitha gjërat që do të ndodhin edhe në të ardhmen. Njerëzit janë krijesat e vetme që e kanë të drejtën e veprimit. Për këtë, ata do të japin llogari për veprat e tyre. Nëse ndodhë diçka kundër vullnetit të njerëzve, ata duhet të durojnë dhe ta pranojnë si caktim të Allahut xhel-le she'nuhu.



### MOS HARRO!

Kushtet e besimit islam janë:

**“Amentu bil-lahi ve melaikethi ve kutubihi ve rusulihi vel vejmil ahir ve bil kaderi hakrihi ve sherrihi minellahi teala”**

“Besoj në Allahun, në melekët e Tij, në librat e Tij, në Pejgamberët e Tij, në Ditën e Gjykimit, në caktimin e Allahut dhe se ringjallja pas vdekjes është e vërtetë”.

<sup>1)</sup> Dita e Gjykimit ndryshe quhet edhe:  
-Dita e Kiametit që do të thotë e ringjalljes;  
- Dita e Ahiretit që do të thotë e fundit  
<sup>2)</sup> ) Suri është mjet në formë të fyellit.



## Fjalor

**melek:** engjell, krijesë e krijuar prej dritës që kurrë nuk vepron keq

**kitab:** libër

**resul:** i dërguar

**kijamet:** ngritje në këmbë, ringjallje

**kader:** caktim

**mizan:** peshojë


**sur:** fyell, bori

**ahir:** i fundit



## Le të mendojmë dhe le të bisedojmë

1. Numëro kushtet e bindjes në islam?
2. Cili është kushti i parë i bindjes?
3. Ç'janë meleket dhe cilat janë më të njohura?
4. Cilat janë detyrat e melekëve më të njohur?
5. Çfarë e pyesin Munkiri dhe Nekiri të vdekurin pas varrimit?
6. Cilat janë librat e shpallura nga ana e Allahut xhel-le she'nuhu dhe kujt i janë shpallur?
7. Sa pejgamberë janë përmendur në Kur'an dhe cilët janë më të njohur?
8. Ç'është Dita e Gjykimit dhe kur do të ndodhë?
9. Ç'është kaderi (caktimi i Allahut)?



## ALLAHU XH.SH. NË MËSIMIN ISLAM

Duke i mësuar përbajtjet do të mund:

- të mësosh cilësitë e Allahut xhel-le she'nuhu;
- të mësosh se Allahu është Një dhe Atë gjithçka e madhëron;
- të mësosh se si të falënderosh Allahun xhel-le she'nuhu;
- të mësosh se Allahu xhel-le she'nuhu është mëshirues i madh dhe falës i mëkateve.

E gjithë kjo që na rrëthon, dëshmon qartë se Allahu ekziston. Allah është emër i Zotit të vetëm dhe të vërtetë, Krijuesit dhe Sunduesit të botëve. Nëse ju bëhet një vështrim krijesave, do të vërehet se çdo gjë është e përkryer dhe funksionon në formën më të mirë. Çdo gjë e kryen detyrën e vet, përfundohet se të gjitha këto krijesa janë të krijuara nga Allahu xhel-le she'nuhu.

Por, shtrohet pyetja se në çfarë mënyre arrijmë te besimi dhe bindja se Allahu xhel-le she'nuhu ekziston? Këtë mund ta arrijmë me anë të studimit dhe hulumtimit në natyrë. Shohim lloje të ndryshme të gjallesave, bimëve etj., si dhe një rregull të çuditshëm në natyrë. Gjithçka që ekziston në natyrë, qofshin krijesa të mëdha ose të vogla, nuk kanë mundur të krijohen vetë e as të gjenden rastësisht. Andaj, mund të përfundohet se të gjitha këto krijesa janë të krijuara nga Krijuesi absolut, i Gjithëdijsëm dhe i Plotfuqishëm.

### Aktivitete

- Arsimtari së bashku me nxënësit, zhvillojnë diskutime si dhe citojnë vjersha dhe ilahije;
- Arsimtari së bashku me nxënësit dalin në natyrë dhe bisedojnë rrëth bukurive që i ka krijuar Allahu xhel-le she'nuhu

### Le të mendojmë dhe le të bisedojmë

1. Kush e krijojti qëllin dhe çdo gjë që gjendet në të?
2. Kush e krijojti tokën dhe çdo gjë që gjendet në të?
3. Kush e krijojti njeriun në formën e tij më të bukur?
4. Çka është Allahu?
5. Si mund të bindemi se Allahu ekziston?



## ALLAHU DHE CILËSITË E TIJ



Allahu xhel-le she'nuhu ekziston. Për ekzistimin e Tij dëshmon e gjithë hapësira dhe gjithçka që ndodhet brenda saj. Ekzistimi nënkupton edhe të pasurit e cilësive, të cilat tregojnë përkryerjen e plotë të Zotit dhe pa të meta.

Prej cilësive të Allahut të përmendura në Kuran veçojmë:

### **Allahu është Një** (vahdanijet-tevhid)

Ekziston vetëm Një Allah. Ai nuk ka prindër, fëmijë e as grua. Ai është i Pashoq dhe nuk ka nevojë për ndihmën e askujt. Besimi në tevhid - njëshmëri (se ekziston vetëm një Zot) është kushti parësor i të qenit musliman. Se Allahu është Një, vërtetojnë argumente të shumta. Ne këtë e shprehim sa herë që e shqiptojmë shehadetin:

“Eshhedu en la ilah il-lallah ve eshhedu enne Muhammeden abduhu ve resuluhu”.

“Dëshmoj se nuk ka zot tjetër pos Allahut dhe dëshmoj se Muhamedi është robi i Tij dhe i Dërguari i Tij”.

### **Allahu është i pafillim** (kidem)

Allahu ka ekzistuar kur nuk ka ekzistuar asgjë. Ai, pra, është i Pa fillim dhe Krijues i jetës në këtë hapësirë.

### **Allahu është i pafund** (beka')

Allahu sikur që është i Pa fillim, Ai është edhe i Pafund. Pra, çdo gjë në këtë hapësirë do të zhduket, ndërsa Ai do të mbetet.

### **Allahut nuk i përngjan asgjë** (muhalefetun lilhavadithi)

Allahut nuk i përngjan asgjë, as në Qenien e Tij as në Cilësitë e tij e as në Veprat e Tij. Ai, pra, është i Pashoq në çdo gjë.

### **Allahu është i pavarur në çdo gjë** (kijamun binefsihi)

Allahu në çdo gjë është i pavarur dhe nuk ka nevojë për askënd.

### **Allahu është i gjallë** (hajat)

Allahu cilësohet se është i gjallë, por jo siç jemi ne të gjallë me anë të shpirtit. Jeta e Tij është e Pafund.

### **Allahu di çdo gjë** (ilm)

Dituria e Allahut është absolute. Ai e di të kaluarën, të tashmen dhe të ardhmen. Ai i di edhe gjërat më të imëta, bile edhe atë që e planifikon njeriu në mendjen e tij.

**Allahu dëgjon çdo gjë** (sem')

Të dëgjuarit e Allahut është absolut. Ai dëgjon çdo gjë në gjithësi, qoftë zë i madh ose i vogël.

**Allahu sheh çdo gjë** (basar)

Të parit e Allahut është absolut. Ai sheh çdo gjë në gjithësi. Ai sheh edhe gjërat e imëta në errësirën e natës.

**Allahu vepron sipas dëshirës së Vet** (iradet)

Allahu në dëshirën e Tij është absolut. Ai çdo gjë që e vepron e bën sipas dëshirës së Tij dhe asgjë nuk mund t'i imponohet.

**Allahu është i Gjithëfuqishëm** (kudret)

Fuqia e Allahut është absolute. Çdo gjë që dëshiron ta krijojë e bën, dhe nuk ka gjë që nuk mund ta bëjë.

**Allahu flet** (kelam)

Allahu flet, por jo në formën që ne flasim. Fjalët e Tij janë të përmbledhura në librat e shenjta që i theksuan më parë.

**Allahu secilës krijesë ia jep formën** (tekvin)

Allahu secilës krijesë ia jep formën që e dëshiron Ai. Format e ndryshme të krijesave flasin për këtë cilësi të Allahut xhel-le she'nuhu.



Thuaj: Ai, Allahu  
është Një!  
Allahu është Ai që  
çdo krijesë i  
drejtohet (i  
mbështet) për çdo  
nevojë.  
As s'ka lindur kë, as  
nuk është i lindur.  
Dhe Atij askush  
nuk i është i  
barabartë.

**Le të mendojmë dhe le të bisedojmë**

- Çka është vahdanije-tevhid-njëshmëri?
- A ka fillim dhe mbarim Allahut? Sqaro pse?
- A ka diçka çka i ngjason Allahut?
- Dituria, të parit dhe fuqia e Allahut është absolute apo relative?
- Në cilën sure përfshihen cilësitë e Allahut? Lexo suren dhe sqaro?

## KRIJIMI I NJERIUT TË PARË

Allahu xhel-le she'nuhu pasi e krijoj gjithë këtë hapësirë, duke përfshirë botën bimore dhe atë shtazore, me vullnetin e Tij deshi të krijojë një kriesë, e cila do të ngarkohej për të zbatuar ligjin e Tij në tokë.

Njeriu i parë është Ademi alejhis-selam. Ai është krijuar prej dheut dhe më pas i është dhuruar edhe shpirti nga ana e Allahut. Kjo nënkupton se njeriu përbëhet prej dy komponentëve: materies dhe shpirtit.

Pas krijimit të Ademit alejhis-selam, Allahu xhel-le she'nuhu me dëshirën dhe me fuqinë e Tij, nga brinja e Ademit e krijoj Havën, gruan e tij. Kështu u formua çifti i parë bashkëshortor. Më pas, prej këtyre dyve, Ademit dhe Havës u shtuan shumë burra e gra dhe Allahu xhel-le she'nuhu i ndau në popuj dhe fise.

### Aktivitete

Arsintari së bashku me nxënësit bisedojnë rrëth kuptimit të ajeteve të mëposhtme: "O ju njerëz, vërtet Ne ju krijuam juve prej një mashkulli dhe një femre, ju bëmë popuj e fise që të njiheni ndërmjet vete" Kur'an: El Huxurat:13.

### Le të mendojmë dhe le të bisedojmë

1. Kush e krijoj njeriun?
2. Me se e krijoj Allahu njeriun?
3. Prej cilave komponente është krijuar njeriu?
4. Kush është babai i parë e kush nëna e parë e gjithë njerëzimit?
5. Me se e krijoj Allahu Havën?
6. Për çka njerëzit janë të ndarë në popuj dhe fise?

## FALËNDERIMI DREJTUAR ALLAHUT

Allahu xhel-le she'nuhu pasi krijoj njeriun, ia plotësoi të gjitha kushtet për jetë normale në tokë. Çdo gjë është krijuar për njeriun. Njeriut i janë dhuruar cilësi, të cilat ia mundësojnë të jetë mëkëmbës dhe udhëheqës në këtë botë. Atij i është dhuruar shikimi (sytë), të dëgjuarit dhe të menduarit.

Për të gjitha këto të mira që Allahu ia ka dhuruar njeriut, ai duhet ta falënderojë Atë. Falënderimi i Allahut arrihet duke e adhuruar Atë me faljen e namazit, dhënien e zekatit, agjërimin, haxhin, etj., duke hequr dorë nga punët e këqija dhe të ndaluara.

Ai falënderohet edhe duke e përmendur fjalën “elhamdu-lilah” për çdo gjë që vjen nga ana e Allahut xhel-le she'nuhu. Nëse ne e falënderojmë Allahun xhel-le she'nuhu, Ai edhe më shumë do t'i shtojë të mirat e Tij.



### Aktivitete

Arsintari me nxënësit lexojnë së bashku suren el fatiha.



### Le të mendojmë dhe le të bisedojmë

1. Çka i dhuroi Allahu xhel-le she'nuhu njeriut?
2. Ç'duhet të bëjë njeriu për të mirat që i janë dhuruar?
3. Çka duhet të thotë muslimani për ta falënderuar Allahun?
4. Nëse njeriu e falënderon Allahun, me çka do të shpërblehet?

### FJALË E URTË

*“Kush nuk i falënderon njerëzit nuk e falënderon as Allahun” (Hadith).*

## MUHAMEDI ALEJHIS-SELAM NË MËSIMIN ISLAM

Allahu xhel-le she'nuhu e krijoi njeriun dhe e bëri qenie më të përsosur në hapësirë, duke e pajisur atë me cilësi, me të cilat i mundësohet bartja e përgjegjësive dhe me të cilat e ka obliguar Allahu xhel-le she'nuhu.

Allahu xhel-le she'nuhu njeriut ia dhuroi të parit, të dëgjuarit dhe mendjen. Njeriu nëpërmjet mendjes dallohet nga të gjitha kriesat e tjera. Megjithatë, të menduarit e njeriut është i kufizuar dhe nuk mund të depërtojë në botën metafizike.

Kështu, Allahu xhel-le she'nuhu njerëzisë gjithnjë i ka dërguar pejgamberë, të cilët ua paraqisin njerëzve shpalljet e Allahut xhel-le she'nuhu. Pejgamberët janë të shumtë. Prej tyre në Kur'an janë përmendur 25, ndërsa atyre që u janë shpallur libra janë katër: Musai alejhis-selam, Davudi alejhis-selam, Isai alejhis-selam dhe Muhamedi alejhis-selam.

Të gjithë pejgamberët janë të barabartë para Allahut në pejgamberi, ndërsa dallohen mes vete në vlerë.

Muhamedi alejhis-selam është pejgamberi i fundit dhe vula e gjithë pejgamberëve. Pas Tij nuk ka as pejgamber e as shpallje. Ai është si të gjithë njerëzit e tjerë të thjeshtë. Ka lindur nga një nënë e një baba. Është rritur dhe zhvilluar si gjithë të tjerët. Është martuar dhe ka pasur familje dhe në fund ka vdekur si gjithë të tjerët. Muhamedi alejhis-selam dallohet nga njerëzit e tjerë se është pejgamber, ndërsa dallohet nga pejgamberët e tjerë se është pejgamber i fundit. Muhamedit alejhis-selam i ka zbritur edhe libri i fundit nga ana e Allahut xhel-le she'nuhu, Kurani.

Muhamedi alejhis-selam ka lindur më 571 në qytetin e shenjtë Meke dhe ka vdekur në vitin 632, në moshën 63 vjeçare në Medine, ku edhe është varrosur.

Sa herë të përmendet emri i Muhamedit, duhet thënë: "alejhis-selam".

### Le të mendojmë dhe le të bisedojmë

1. Çka i dhuroi Allahu xhel-le she'nuhu njeriut?
2. Me çka e dalloi njeriun nga kriesat e tjetra?
3. A janë të gjithë pejgamberët të barabartë?
4. Cili është pejgamberi i fundit?
5. Me çka dallohet Muhamedi alejhis-selam nga njerëzit e tjerë dhe me çka nga pejgamberët tjerë?
6. Cili libër i Allahut i është zbritur Muhamedit alejhis-selam?
7. Kur dhe ku ka lindur Muhamedi alejhis-selam?
8. Ku dhe kur ka vdekur Muhamedi alejhis-selam?

## JETA E MUHAMEDIT ALEJHIS-SELAM

Muhamedi alejhis-selam është pejgamberi i fundit i dërguar nga ana e Allahut xhel-le she'nuhu. Atij i ka zbritur edhe libri i fundit nga ana e Allahut xhel-le she'nuhu, Kurani.

Ardhja e Muhemedit alejhis-selam solli një ndryshim rrënjosor në historinë njerëzore. Ai, me dëshirën e Allahut, bëri një revolucion duke ua treguar njerëzve rrugën e lumturisë dhe të shpëtimit.

Për Muhamedin alejhis-selam është shkruar shumë, por ne këtu në pikat e shkurtra do të njihemi me veprimtarinë e rëndësishme të jetës së tij.



## LINDJA, FËMIJËRIA DHE JETA FAMILIJARE E MUHAMEDIT ALEJHIS-SELAM

Muhamedi alejhis-selam u lind në Mekë më 20 prill 571. Babai i tij Abdullahu ka vdekur dy muaj para lindjes së Muhemedit alejhis-selam, ndërsa nëna e tij Emineja, ka vdekur kur Muhamedi alejhis-selam ka qenë gjashtëvjeçar.

Pas vdekjes së nënës, për të është përkujdesur gjyshi i tij Abdulmutalibi. Gjyshi i tij e donte shumë, por së shpejti vdiq edhe ai, dy vjet pas vdekjes së nënës së tij.

Pas vdekjes së gjyshit të tij, në përkujdesje e mori axha i tij Ebu Talibi. Moshën e gjirit, Muhamedi alejhis-selam e kishte kaluar në familjen Benu Sa'd, ku ishte mëkuar te gruaja me emrin Halime Sa'dije.

Tek axha i tij Ebu Talibi, Muhamedi alejhis-selam rritej si të gjithë fëmijët e tjerë, por dallohej me moralin e tij. Ai në moshën e vegjëlisë i ndihmonte axhës së tij dhe merrej më ruajtjen e deleve.

Në moshën 12 vjeçare, ka udhëtuar me axhën e tij për në Busra, qytet afér Damaskut. Prej Busras ishte kthyer shpejt, pasi një prift krishterë me emrin Behira, kishte parë te ai disa shenja të pejgamberisë dhe kërkoi prej axhës së tij që të kthehen menjëherë për në Mekë, nga frika se mund t'i ndodhë diçka e keqe.

Në moshën 20 vjeçare përsëri udhëtoi për në Busra, por tanë si përgjegjës i tregtisë me

pasurinë e Hatixhes.



Muhamedi alejhis-selam, dallohej me virthyte të larta. Ai në mesin e arabëve njihej me emrin “el emin” (besnik).

Pasi Hatixheja e kishte parë besnikerinë e Muhamedit alejhis-selam, ajo kërkoi martesë me të. Kështu, kur Muhamedi alejhis-selam ishte në moshën 25 vjeçare u martua me Hatixhen.

Allahu xhel-le she'nuhu, Muhamedit alejhis-selam me Hatixhen i kishte dhuruar gjashtë fëmijë: Kasimin, Zejneben, Rukijen, Fatimen, Ummi Kulthumin dhe Abdullahin.

Fëmijët djem kanë vdekur të vegjël, ndërsa vajzat kanë jetuar më gjatë. Prej vajzave të tij, fëmijë ka bërë Fatimeja, e cila ishte martuar me Aliun r.a. Dy fëmijët e tyre ishin Hasani dhe Husejni, të cilët Muhamedi alejhis-selam i donte shumë.

Muhamedi alejhis-selam sillej shumë korrekt më gratë dhe me fëmijët e tij. Asnjëherë nuk e ka ofenduar e as nuk e ka rrahur askënd. U ka ndihmuar grave në kryerjen e detyrave shtëpiake dhe i ka këshilluar gjithnjë fëmijët.



## FILLIMI I SHPALLJES DHE THIRRJA NË MEKË

Kur Muhamed i alejhis-selam iu afrua moshës dyzet vjeçare, filloi të mendojë rrith krijesave në përgjithësi.

Disa muaj para fillimit të shpalljes, ai dilte në kodrat e Mekes dhe mendonte në krijesat e Allahut xhel-le she'nuhu. Aty qëndronte ditë dhe netë të tëra.

Në një natë prej netëve të Ramazanit, konkretisht në natën e Kadrit, Muhamed i alejhis-selam duke qëndruar në shpellën Hira, i erdhi diçka në formë të njeriut dhe i tha: “Lexo! Nuk di të lexoj, iu përgjigj Muhamed i alejhis-selam. Njeriu këtë e përsëriti tri herë, por edhe përgjigjja ishte e njëjtë. Më në fund, meleku në formë njeriu i tha: **“Lexo me emrin e Zotit tënd, i Cili krijoj (çdo gjë). Krijoi njeriun prej një gjaku të ngjizur. Lexo! Se Zoti yt është më bujari! Ai që e mësoi (njeriun) të shkruaj me penë. I mësoi njeriut atë që nuk e dintë”**.

Pas kësaj, iu paraqit meleku dhe i tha: *“O Muhamed, ti je i Dërguari i Allahut, ndërsa unë jam Xhibrili”*.

Kështu ka filluar shpallja e Kuranit dhe ka zgjatur afër 23 vite, ndërsa Muhamed i alejhis-selam ishte i Dërguari i fundit nga ana e Allahut xhel-le she'nuhu. Ai është i dërguar për gjithë njerëzinë që t'i nxjerrë ata nga errësirat në dritë.

Pasi Muhamed i alejhis-selam u shpall për pejgamber, ai filloi fshehurazi të thërrasë në fenë islame. Gruaja e parë që i besoi ishte Hatixheja, burri i parë Ebu Bekri r.a., ndërsa i riu i parë Aliu r.a.

Thirrja fshehurazi ka zgjatur plotë tri vite dhe e kishin besuar vetëm një numër i vogël i mekasve.

Pas trembëdhjetë viteve që i kaloi Muhamed i alejhis-selam në Meke, duke thirrë në fenë e Allahut, ku dhe përjetoi maltretime të shumta, së fundi u detyrua të emigronte prej saj në Medine.

Muhamed i alejhis-selam së bashku me shokun e Tij më të ngushtë Ebu Bekrin r.a. u nisën prej Mekës për në Medine.

Kur arriti lajmi se Muhamed i alejhis-selam ishte afruar afër Medinës u prit me shumë gëzime duke bërë tekbi dhe duke kënduar ilahi.

Më në fund, Muhamed i alejhis-selam u vendos në Medine së bashku me shokët e tij muslimanë të Mekës.

I Dërguari i Allahut, së pari ndërtoi një xhami dhe afër saj një shtëpi për vete dhe familjen e Tij.

Muslimanët e Mekës që kishin emigruar quhen “muhxhirinë”, ndërsa muslimanët e Medines quhen “ensarë”.

Me hixhretin që bëri Muhamedit alejhis-selam nga Mekja për në Medine fillon edhe kalendari hixhri i muslimanëve.



## MOS HARRO!

- Shpallja Muhemedit alejhis-selam i erdhi në moshën 40 vjeçare.
- Shpallja e Kuranit ka zgjatur 23 vjet
- Fillimi i shpalljes ishte në shpellën Hira.
- Hixhreti ka ndodhur më vitin 622.
- Viti 622 llogaritet fillimi i kalendarit islamik.
- Xhaminë e parë në Islam e ndërtoi Muhamedit alejhis-selam
- Shokët e Muhemedit alejhis-selam quhen "sahabë".
- "Muhaxhirinë" janë muslimanët e Mekës, ndërsa "ensar" muslimanët e Medinës.



## Le të mendojmë dhe le të bisedojmë

1. Në cilën moshë i erdhi shpallja Muhemedit alejhis-selam?
2. Në cilën natë dhe në cilën shpellë filloj shpallja?
3. Trego ngjarjen e fillimit të shpalljes dhe ajetet e para të shpallura?
4. Sa ka zgjatur shpallja e Kuranit?
5. Kush ishin njerëzit e parë që besuan Muhamedin alejhis-selam?
6. Sa vjet zgjati shpallja në Meke?
7. Me cilin sahab bëri hixhret Muhamedit alejhis-selam për në Medine?
8. Si u prit Muhamedit alejhis-selam në Medine?
9. Çka bëri Muhamedit alejhis-selam pas arritjes në Medine?
10. Si quhen shokët e Muhemedit alejhis-selam?
11. Kush janë "muhaxhirinët" e kush "ensarët"?
12. Prej kur ka filluar kalendari hixhri i muslimanëve?

## JETA E MUHAMEDIT ALEJHIS-SELAM NË MEDINE DHE VDEKJA E TIJ

Pas emigrimit të Muhamedit alejhis-selam dhe shokëve të Tij në Medine, u rritë dukshëm numri i muslimanëve. Kështu muhaxhirinët dhe ensarët formonin shoqërinë e parë islame në Medine.

Punë të para që bëri Muhamedi alejhis-selam në Medine ishin:

- themelimi i xhamisë;
- vëllazërimi mes muslimanëve dhe
- përpilimi i kushtetutës së parë që përfshinte të drejtat e muslimanëve dhe jomuslimanëve në shtetin islam.

Organizimi i mirë dhe përparimi i shpejtë i muslimanëve në Medinë i shqetësoi idhujtarët. Kështu, në vitin e dytë sipas hixhretit, ndodhi edhe lufta e parë në Islam. Kjo ishte lufta e Bedrit.

Në këtë luftë, nga ana e muslimanëve morën pjesë 314 luftëtarë, ndërsa nga ana e idhujtarëve 950. Muslimanët e fituan luftën. Kjo fitore edhe më shumë u dha muslimanëve kuraje për organizim dhe përparim.

Më pas vazhduan luftërat e njëpasnjëshme, sikur ajo e Uhudit, Handekut, marrëveshja e Hudejbijes, etj.

Në vitin e tetë sipas hixhretit, Muhamedi alejhis-selam së bashku me një numër të madh të muslimanëve u nissën për çlirimin e Mekes. Më 20 Ramazan të vitit të tetë hixhri, muslimanët në krye me të Dërguarin e Allahut, Muhamedin alejhis-selam arritën në Mekë dhe e çliruan atë.

Pas disa ditësh qëndrimi në Mekë, Muhamedi alejhis-selam së bashku me një numër të madh të muslimanëve u kthye në Medinë.

Në vitin e dhjetë të hixhretit, Muhamedi alejhis-selam bëri haxhin e lamtumirës. Gjatë këtij haxhi, Muhamedi alejhis-selam ua mësoi muslimanëve mënyrën e kryerjes së haxhit dhe në Arafat mbajti hutben historike të njohur me emrin “hutbeja e lamtumirës”.

Në këtë ditë zbritën ajetet që flasin për komplementimin e fesë: **“Sot përsosa për ju fenë tuaj, plotësova ndaj jush dhuntinë Time dhe zgjodha për ju islamin fe”**. El Maide: 3.

Pas kryerjes së haxhit, Muhamedi alejhis-selam kthehet në Medinë, ku jetoi edhe 81 ditë dhe më pas vdes.

## Vdekja e Muhamedit alejhis-selam

Në mëngjesin e ditës së hënë, Muhamedin alejhis-selam e kaploj një dhembje e madhe. Kështu, në paraditen e të hënës, duke qenë në kraharorin e gruas së tij Aishes r.a, e ngriti gishtin tregues përpjetë dhe duke thënë: “te Shoqëruesi më i Lartë, te Shoqëruesi më i Lartë”, e dorëzoi shpirtin e tij te Allahu xhel-le she'nuhu.

Vdekja e tij ishte në ditën e hënë, 12 Rabiul evel të vitit 11 hixhri ose 08 / qershor / 632.

Lajmi për vdekjen e Muhamedit alejhis-selam u përhap shumë shpejt. Shumë prej muslimanëve nuk donin të besonin një gjë të tillë, derisa erdhi Ebu Bekri dhe ua lexoi disa ajete kuranore, ku më pas u bindën për vdekjen e tij.

Muhamedi alejhis-selam është varrosur në Medinë, në vendin ku ka vdekur, përkatësisht në dhomën e gruas së tij Aishes r.a.

Pas vdekjes së Muhamedit alejhis-selam, kalif (udhëheqës) i muslimanëve bëhet Ebu Bekri r.a., pas tij Omeri r.a., pas tij Osmani r.a., pas tij Aliu r.a. Këta katër kalifë njihen me emrin “hulefair-rashidin”.

Afër Muhamedit alejhis-selam janë varrosur Ebu Bekri r.a. dhe Omeri r.a. Gjatë vitit, miliona njerëz shkojnë e vizitojnë ata.

### MOS HARRO!

- Lufta e parë në Islam ishte lufta e Bedrit në vitin e dytë hixhri.
- Çlirimi i Mekës ishte më 20 Ramazan të vitit të tetë hixhri.
- Vdekja e Muhamedit alejhis-selam ishte në ditën e hënë, më 08/06/632.
- Muhamedi alejhis-selam ka vdekur dhe është varrosur në Medinë.
- Afër varrit të Muhamedit alejhis-selam gjendet edhe varri i Ebu Bekrit r.a. dhe i Omerit r.a.

### Le të mendojmë dhe le të bisedojmë

1. Kush e formoi shoqërinë e parë islame në Medinë?
2. Cilat ishin punët e para që i bëri Muhamedi alejhis-selam në Medinë?
3. Cila ishte lufta e parë në islam dhe kur u zhvilluar ajo?
4. Kur u çlirua Meka?
5. Ç'bëri Muhamedi alejhis-selam në vitin e dhjetë të hixhretit?
6. Sa ditë ka jetuar Muhamedi a.s. pas kthimit në Medinë?
7. Kur dhe ku vdiq Muhamedi alejhis-selam?
8. Ku është varrosur Muhamedi alejhis-selam?
9. Kush janë hulefairrashidinët?



## KURANI NË MËSIMIN ISLAM



### BINDJA NË KURANIN SI FJALË TË ALLAHUT

Gjatë historisë njerëzore, Allahu ka dërguar pejgamber të ndryshëm. Disave prej tyre u ka shpallur edhe libra. Siç theksuanë më parë, librat e shpallura janë: Tevrati, Zeburi, Inxhili dhe Kurani.

Kurani është libri i fundit i shpallur nga ana e Allahut xhel-le she'nuhu deri te Muhamedi alejhis-selam. Pra, Kurani është fjalë e Allahut, i cili nëpërmjet melekut Xhebrail i është zbritur te Muhamedi alejhis-selam.

Kur arriti Muhamedi alejhis-selam moshën 40 vjeçare, atij i filloj shpallja e Kuranit. Gjersa Muhamedi alejhis-selam ishte në shpellën Hira, i erdhi Xhebraili dhe i tha: Lexo! Nuk di të lexoi iu përgjigj Muhamedi alejhis-selam. Xhibrili të njëjtën e përsëriti tri herë, por edhe përgjigjja ishte e njëjtë. Në fund Xhibrili tha: **“Lexo me emrin e Zotit tënd, i Cili krijoi (çdo gjë). Krijoi njeriun prej një gjaku të ngjizur. Lexo! Se Zoti yt është më bujari. Ai që e mësoi (njeriun) të shkruaj me penë. I mësoi njeriut atë që nuk e dinte”**. El Alak: 1-5.

Shpallja e Kuranit ka zgjatur përafërsisht 23 vjet, prej të cilave 13 në Mekë dhe 10 në Medinë. Kurani në përgjithësi është libër i kompletuar, i cili në brendinë e tij përfshinë vlera shpirtërore, morale, etike, edukativo-arsimore, intelektuale, estetike etj.

Kurani kërkon prej njeriut që t'i studiojë të gjitha shkencat dhe të mendojë në krijesat që Allahu i ka krijuar. Kurani synon formimin e personalitetit të njeriut nga të gjitha aspektet.

Zbatimi i urdhavrave dhe rregullave kuranore, njeriut i garantojnë lumturi në këtë botë dhe shpëtim në ahiret.

Kurani si libër i shpallur nga ana e Allahut xhel-le she'nuhu është ruajtur origjinal ashtu siç është zbritur. Pra, duke qenë Muhamedi alejhis-selam gjallë, Kurani është shkruar dhe është mësuar përmendësh nga ana e shokëve të Tij (sahabëve). Edhe sot e kësaj dite, Kurani është i shkruar në miliona ekzemplarë dhe është mësuar përmendësh nga ana e miliona hafizëve.

Leximi i Kuranit është prej punëve më të mira, me të cilat muslimani afrohet te Allahu xhel-le she'nuhu. Andaj çdo musliman duhet të mësojë diçka nga ky libër i shenjtë.



## Aktivitete

- Arsimtari merr një kopje të Kuranit me përkthim dhe ua sqaron nxënësve shkurtimisht përbajtjen e tij;
- Arsimtari i mëson nxënësit rrëth mënyrës së leximit të Kuranit.



## MËSOJMË DHE PËRSËRISIM ÇDO ORË ME NXËNËSIT

**Kush është Zoti ynë?**

Zoti ynë është Allahu xhel-le she'nuhu.

**Kush është pejgamberi ynë?**

Pejgamberi ynë është Muhamedi alejhis-selam.

**Cila është feja jonë?**

Feja jonë është feja islame.

**Cili është libri ynë?**

Libri ynë është Kurani.

**Çka jemi ne?**

Ne jemi muslimanë.

**Cila ëshët kibla jonë?**

Kibla jonë është Qabja.

**Kush janë vëllezërit tanë?**

Vëllezërit tanë janë të gjithë muslimanët.

**Cili është pikësynimi ynë?**

Pikësynimi ynë është xheneti.



## Le të mendojmë dhe le të bisedojmë

1. Cilat janë librat e shpallura nga ana e Allahut xhel-le she'nuhu
2. Cili është libri i fundit i shpallur dhe kujt i është shpallur?
3. Çka është Kurani dhe cili melek e ka zbritur?
4. Në cilën moshë i filloj shpallja Muhamedit alejhis-selam?
5. Si quhej shpella, në të cilën filloj shpallja?
6. Çka i tha Xhibrili Muhamedit alejhis-selam?
7. Cilat ishin fjalët e para të shpallura në Kur'an?
8. Sa kohë gjithsej ka zgjatur shpallja? Sa në Meke e sa në Medine?
9. Çka përfshinë Kurani në brendinë e tij?
10. A kërkon Kurani studimin e shkencave të tjera?
11. Çka synon Kurani?
12. A është ruajtur Kurani origjinal ashtu siç është zbritur?
13. Me cilat forma është ruajtur Kurani?
14. Si quhen personat që e dinë përmendësh Kur'anin?
15. A është vepër e mirë leximi i Kur'anit?



## KUSHTET E ISLAMIT NË MËSIMIN ISLAM

Feja islame është fe e kompletuar. Ajo përfshinë pjesën teorike dhe atë praktike.

### KUSHTET (SHARTET) E ISLAMIT

Në islam nuk mjafton që vetëm të besohet, por është patjetër të kryhen edhe obligimet praktike.

Obligimet praktike dhe më kryesore në mësimin islam janë:

- Shehadeti;
- Falja e namazit;
- Dhënia e zeqatit;
- Agjërimi i Ramazanit dhe
- Shkuarja në haxh.

Të gjitha obligimet e lartpërmendura islame janë të cekura në Kuran dhe janë obligime të domosdoshme (farz). Personi, i cili i kryen këto obligime do të shpërblehet nga ana e Allahut xhel-le she'nuhu me mëshirën e Tij në këtë botë dhe me xhenet në ahiret, kurse ai që nuk i kryen këto obligime do të ndëshkohet.

#### Kelimei shehadeti

Kushtet islame janë të lidhura ngushtë me kushtet e besimit, ashtu siç janë të lidhur ngushtë trupi me shpirtin. Pozita e shehadetit në Islam është si pozita e zemrës në trup. Andaj, njeriu llogaritet musliman kur të shqiptojë shehadetin në këtë formë:

**“Eshhedu en la ilahe il-lallah ve eshhedu enne Muhammeden abduhu ve resuluhu”**

“Besoj dhe dëshmoj se nuk ka zot tjetër përpos Allahut dhe besoj e dëshmoj se Muhamedi është rob i Allahut dhe i Dërguari i Tij”

Fjala “shehadet” do të thotë dëshmi. Me këtë fjali nënkuqtohet se njeriu dëshmon me zemër dhe me gjuhë përbesimin e vet.

Nëpërmjet shehadetit vërtetojmë dy të vërteta elementare:

-me shprehjen: “Eshhedu en la ilahe il-lallah”, (Besoj dhe dëshmoj se nuk ka zot tjetër përpos Allahut), dëshmojmë se Allahu është Një dhe mohojmë ekzistimin e çdo zoti tjetër përpos Allahut.

-me shprehjen: “ve eshhedu enne Muhammeden abduhu ve resuluhu” , (dhe besoj e

dëshmoj se Muhamedi është rob i Allahut dhe i Dërguari i Tij”, vërtetojmë se Muhamedi alejhis-selam është njeri si të gjithë njerëzit, por është i Dërguari i fundit i Allahut xhel-le she’nuhu.

Zbatimi i pesë kushteve të Islamit garanton dobi individuale dhe shoqërore. Kështu, nuk fiton vetëm personi që i praktikon këto kushte, por edhe njerëzit e tjerë, qoftë me anë të ndihmës materiale ose shpirtërore. Zbatimi i këtyre kushteve në mënyrë individuale dhe kolektive garanton shoqëri të shëndoshë në të gjitha aspektet.

### SHEHADETI

Unë më zemër besoj dhe me gojë dëshmoj:  
La ilahe il-lallah Muhammedun resulullah.

Që s'ka zot tjetër përpos Allahut, nuk dyshoj,  
Muhamedit-Pejgamberit salavate i dërgoj.

Për paqe dhe shpëtim të gjithë nevojë kemi  
Në rruga të Allahut gjithmonë të jemi.



### MOS HARRO!

Kushtet e Islamit janë pesë:

- Shehadeti;
- Falja e namazit;
- Dhënia e zeqatit;
- Agjërimi i Ramazanit dhe
- Shkuarja në haxh.

### Le të mendojmë dhe le të bisedojmë

1. Cilat janë kushtet e Islamit?
2. Me çka njeriu bëhet musliman?
3. Si shprehet shehadeti dhe çka do të thotë?
4. Prej sa pjesëve përbëhet shehadeti?
5. Cila është dobia e zbatimit të këtyre kushteve?

## PASTËRTIA NË MËSIMIN ISLAM

Duke mësuar përbajtjet do të mund:

- të aftësohesh për mbrojtjen e higjenës në trup, rrobe, vendin ku jeton dhe ruajtjen e ambientit;

- të kuptosh se pastërtia përbënë gjysmën e besimit;
- të aftësohesh për marjen e abdesit dhe larjen e tërë trupit;
- të aftësohesh për ruajtjen e shëndetit

Pastërtia zë vend shumë të rëndësishëm në fenë islame. Nga pastërtia varet pranimi i shumë obligimeve fetare. Andaj, pastërtia për muslimanin është farz-obligim i patjetërsueshëm.

Pastërtia në Islam zë vend gjatë tërë jetës së njeriut. Ajo më së shumti shfaqet në këto veprime:

1. duke i prerë thonjtë me rregull;
2. duke i pastruar duart para dhe pas ngrënies;
3. duke i larë dhëmbët disa herë gjatë ditës;
4. duke e përdorur ujin gjatë kryerjes së nevojës;
5. duke e ruajtur trupin dhe rrobat nga urina dhe fëlliqësitetë e tjera;
6. duke e larë trupin rregullisht, së paku një herë në javë;
7. duke marrë abdes për pesë kohët e namazit në ditë;
8. duke e pastruar vendin ku falemi;
9. duke mos hedhur mbeturinat kudo qoftë, por në vende të caktuara;
10. duke e ruajtur higjenën në shtëpi, shkollë, rrugë dhe gjetiu;
11. duke e mbrojtur ambientin nga ndotja.

Allahu xhel-le she'nuhu dhe i Dërguari i Tij, Muhamedi alejhis-selam e dojnë pastërtinë dhe të pastërtit. Allahu xhel-le she'nuhu thotë: **“Allahu i do ata që pendohen dhe ata që ruajn pastërtinë”** El Bekare: 222.

Muhamedi alejhis-selam thotë: “*Pastërtia është gjysma e besimit (imanit)*”.



### MOS HARRO!

- Pastërtia është gjysma e besimit (imanit).
- Avdesi është pastrimi i disa pjesëve të trupit.
- Gusuli është larja e tërë trupit.
- Ruajtja e higjenës dhe ambientit është shumë me rëndësi në Islam.


## Të mbajmë mend

**Farz** është vepër e obliguar në mënyrë të prerë.  
**Sunnet** është vepër e preferuar dhe jo e obliguar.  
**Mubah** është vepër e parapëlqyer, e cila mund të veprohet dhe të mos veprohet.  
**Mekruh** është vepër jo e pëlqyer.  
**Haram** është vepër e ndaluar në mënyrë të prerë.



## Le të mendojmë dhe le të bisedojmë

1. Cili është roli i pastërtisë në mësimin islam?
2. Ku shfaqet më së shumti pastërtia?
3. Çka thënë Allahu xh.sh. e çka Muhamedi alejhis-selam në lidhje me pastërtinë?



## AVDESI

Avdesi është një pastrim i veçantë i muslimanit ose muslimanes me rastin e faljes së namazit, leximit të Kur'anit ose veprave tjera.

Avdesi mund të merret me çdo ujë të pastër, qoftë ujë i lumi, detit, shiut, borës, pusit, burimit etj.


Në fillim bëjmë njët duke thënë: "Vendosa të marrë avdes për t'u pastruar" dhe më pas:

1. lajmë duart deri në nyje –tri herë (sunnet);
2. lajmë gojën dhe hundën –tri herë (sunnet);
3. lajmë fytyrën – tri herë (farz);
4. lajmë krahun e djathët dhe të majtë me gjithë bërrylat –tri herë (farz);
5. me dorë të lagët e fshijmë së paku çerekun e kokës –një herë (farz);
6. me duar të lagëta fshijmë veshët dhe qafën –një herë (sunnet);
7. lajmë këmbën e djathët e pastaj të majtën me gjithë nyjet (farz).


Gjatë marrjes së abdesit, duke larë secilën pjesë duhet thënë: "bismilah". Pas avdesit shqiptojmë shehadetin.




lajmë duart  
deri në nyje



lajmë gojën dhe hundën



lajmë fytyrën




lajmë krahun e djathët  
dhe të majtë



me dorë të lagët  
e fshijmë së paku  
çerekun e kokës



fshijmë veshët  
dhe qafën



lajmë këmbën e djathët  
e pastaj të majtën

## Gjërat që prishin abdesin

Abdesi prishet:

- nëse kryejmë ndonjë nevojë fiziologjike;
- nëse paraqitet ndonjë papastërti në trup;
- nëse vjellim me gojë të mbushur;
- nëse flemë ose e humbim vetëdijen;
- nëse qeshim me zë në namaz aq sa të tjerët mund të na dëgjojnë.



### Aktivitete

- Arsintari përdorë tekste dhe ilustrime dhe ua lexon nxënësve;
- Arsintari sjell CD, DVD dhe forma tjera që përbajnjë tema rrëth pastërtisë në mësimin islam.





Gusli është larje e tërë trupit, të cilin e ka urdhëruar Allahu xhel-le she'nuhu.

Gusli ka tri farze:

1. larja e gojës deri në fyt –tri herë;
2. larja e hundës –tri herë dhe
3. larja e tërë trupit pa mbetur asnjë vend i thatë.

Nëse njeriu është i papastër (xhunub), atij i ndalohet:

- falja e namazit;
- prekja dhe leximi i Kur'anit;
- hyrja në xhami
- tavafi rrëth Qabes.

Larja sunnet është ajo larje, të cilën na e ka urdhëruar për ta bërë Muhamedi alejhis-selam, si p.sh. larja para namazit të xhumasë, larja para namazeve të bajrameve, gjatë veshjes së ihramit në haxh etj.

**Le të mendojmë dhe le të bisedojmë**

1. Çka është abdesi?
2. Me cilat lloje të ujtit mund të merret abdes?
3. Cilat janë farzet e abdesit e cila sunetet?
4. Çka duhet lexuar para larjes së çdo pjese e çka pas marrjes së abdesit?
5. Çka e prish abdesin?
6. Çka është gusli?
7. Cilat janë farzet e guslit?
8. Cilat vepra ndalohen për njeriun e papastër?
9. Kur larja është sunnet?

## FALJA E NAMAZIT NË MËSIMIN ISLAM

Falja e namazit është farz më i rëndësishëm në Islam. Ai mund të falet individualisht dhe me xhemat, në shpi, në xhami dhe në çdo vend të pastër. Gjatë ditës dhe natës, muslimanët obligohen me faljen e pesë kohëve namaz. Në fillim të çdo kohës së namazit thirret ezani.

Namazi është shtylla e Islamit. Kush e falë atë edhe fenë e ka të fortë, ndërsa kush e lenë atë e ka prishur fenë e tij.

Për faljen e namazit ekzistojnë shumë rregulla. Ne e falim atë ashtu siç na ka mësuar Muhamedi alejhis-selam duke thënë: “Faluni siç më keni parë mua duke u falur”.

Ekzistojnë disa kushte (sharte) të cilat duhet t'i plotësojmë para hyrjes në namaz dhe kushte tjera gjatë faljes së namazit.

## ZEQATI NË MËSIMIN ISLAM

Fjala zeqat do të thotë pastrim dhe rritje. Me këtë kuptohet se muslimani që e jep zeqatin, ai së pari bënë pastrimin e pasurisë së tij dhe më pas, Allahu jep bereqet dhe e shton atë. Çdo musliman i pasur, i cili posedon një sasi të konsiderueshme të pasurisë, obligohet që çdo vit të nxjerrë një sasi ta caktuar prej tij dhe t'ua japë nevojtarëve, e në rend të parë të varfërve.

Zeqati luan rol human dhe zbutë gjendjen e vështirë të të varfërve.

### Aktivitete

Arsimtari diskuton me nxënësit rrreth dobisë së zeqatit në islam.

### Le të mendojmë dhe le të bisedojmë

1. Çka do të thotë fjala “zekat”?
2. Sa herë në vit jepet zeqati?
3. Kujti jepet zeqati?

## AGJËRIMI I RAMAZANIT NË MËSIMIN ISLAM

Muaji Ramazan është muaji i nëntë në kalendarin hixhrij.  
Sipas burimeve islame, Kuranit dhe sunetit të Muhamedit alejhis-selam, agjërimi i këtij muaji është farz.

Agjërim do të thotë heqje dorë nga ushqimi, pija dhe çdo kontakt intim.

Me agjërimin e Ramazanit është i obliguar personi, i cili plotëson këto kushte:

- Të jetë mysliman,
- Të jetë mentalisht i shëndoshë,
- Të jetë moshërritur.

Mosha, me të cilën fillon obligimi i agjërimit është arritja e pubertetit. Te femrat fillon më herët se te meshkujt.

Agjërimi fillon qysh para agimit në syfyr dhe vazhdon deri në mbrëmje me perëndimin e diellit.

Ngrënia e ushqimit gjatë natës, para agimit quhet **syfyr**. Pas ushqimit duhet bërë nijet duke thënë: Vendosa të agjeroj këtë ditë të Ramazanit për hir të Allahut. Nijeti bëhet çdo ditë.

Pas perëndimit të diellit dhe me thirrjen e ezanit të akshamit fillon ngrënia e ushqimit që quhet **iftar**.

Në mbrëmje pas namazit të jacisë, muslimanët bashkërisht me xhemat falin namazin e teravisë, i cili është 20 rekate.

Gjatë Ramazanit,jeta e muslimanit duhet të ndryshojë dukshëm nga muajt e tjera. Sepse siç thotë Muhamedi alejhis-selam: “*Ramazani është muaji i durimit, ndërsa shpërblimi i durimit është xhenneti*”.

Me anë të agjërimit muslimani pastron mëkatet e tij. Kjo mund të arrihet duke falur namazin, e në veçanti me xhemat në xhami, duke kërkuar falje prej Allahut xhel-le she'nuhu.

Përveç kësaj, muslimani në këtë muaj duhet t'i shtojë veprat e mira. Duhet të flasë vetëm fjalë të mira dhe të sillet mirë ndaj të gjithëve. Muhamedi alejhis-selam thotë: “*Kush agjeron Ramazanin me bindje të plotë duke larë llogarinë para Allahut, do t'i falen atij mëkatet e mëparshme*”.

Ekziston një lidhshmëri e ngushtë mes Ramazanit dhe Kuranit, ngase shpallja e Kuranit ka filluar pikërisht në këtë muaj. Për këtë, gjatë këtij muaji duhet të shtohet leximi i Kuranit.

Në Ramazan, nëpër xhami vazhdimisht mbahen ligjérata fetare, e në veçanti pas namazit të ikindisë dhe para jacisë. Preferohet që çdo musliman t'i ndjek këto ligjérata.

Dobitë e agjërimit të Ramazanit janë të shumta. Së pari, individi që agjeron bën pastrimin shpirtëror dhe i forcon lidhjet e tij me Allahun xhel-le she'nuhu Me anë të agjërimit zhvillohet vullneti dhe karakteri i besimtarit. Vullneti i fortë i mundëson besimtarit arritjen e

shumë sukseseve.

Agjërimi është edhe faktor social. Me anë të agjërimit besimtari kupton domethënien e varfërësi. Kështu, ai bëhet human dhe zgjatë dorën e ndihmës ndaj të varfërve. Kjo realizohet më së shumta me anë të dhënies së sadekatul fitrit kah fundi i Ramazanit, ku në rend të parë u jepet personave të varfër.

Krahas gjithë kësaj, agjërimi ndihmon në evitimin e shumë sëmundjeve, e sidomos të trashësisë. Muhamed i alejis-selam ka thënë: “*Agjëroni do të shëndosheni*”.

Muaji i Ramazanit mund të jetë 29 ose 30 ditë. Pas kësaj pason dita e Fitër Bajramit.

## ERDHI RAMAZANI

Sot agoi mëngjesi  
Më i bukur se kurdoherë  
Erdhi Ramazani  
Trokiti në derë

Mbushen sot xhamitë  
Me pleq e rini  
Erdhi Ramazani  
Solli plot kënaqësi



### Aktivitete

Arsimtari së bashku me nxënësit bisedon se si praktikohet agjërimi i Ramazanit në familjet e tyre.



### Fjalor

**Syfyr:** ushqimi para agimit  
**Imsak:** ndërprerja e ngrënies në syfyr  
**Iftar:** ushqimi në mbrëmje në Ramazan  
**Teravi:** namazi prej 20 rekateve pas jacisë në Ramazan.



## Le të mendojmë dhe le të bisedojmë

1. Sipas kalendarit hixhri, cili muaj është muaji Ramazan?
2. Kush e ka për obligim agjërimin e Ramazanit?
3. Prej kur dhe deri kur duhet agjëruar?
4. Si quhet ushqimi që hahet para se të fillojë agjërimi e si pas përfundimit të agjërimit?
5. Si bëhet njëti për agjërim dhe cila është lutja gjatë iftarit?
6. Trego një hadith të Muhamedit alejhis-selam që flet për vlerën e agjërimit të Ramazanit
7. Si duhet të sillet muslimani gjatë muajit të Ramazanit
8. Çfarë lidhshmërie ka mes Ramazanit dhe Kuranit?
9. Trego disa nga dobitë e agjërimit të Ramazanit?
10. Sa zgjatë muaji i Ramazanit?



## HAXHI DHE LUTJET NË MËSIMIN ISLAM

Allahu xhel-le she'nuhu është Krijuesi i kohës dhe vendit. Ai me madhërinë e Tij, ka dalluar disa kohëra ndaj tjerave, po ashtu disa vende ndaj tjerave. Ka dalluar muajin e Ramazanit ndaj gjithë muajve të tjerë, gjithashtu ka e dalluar Meken ndaj të gjitha vendeve tjera.

Në Meke është ndërtuar shtëpia e Allahut, Qabeja, xhamia e parë në tokë. Atë e ka ndërtuar Ibrahimini alejhis-selam së bashku me djalin e tij Ismailin alejhis-selam.

Haxhi është kushti i pestë islam. Atë duhet ta kryej çdo musliman ose muslimane, i moshërritur dhe i shëndoshë mentalisht dhe fizikisht. Përveç kësaj, ai duhet të posedojë pasuri përvete dhe përfamiljen e tij.

Haxhi kryhet në qytetin e shenjtë Mekë dhe vendet përreth tij.

Koha e kryerjes së haxhit është muaji Dhul-hixhe, muaji i 12 në kalendarin hixhri. Në ditën e nëntë të këtij muaji është obligim qëndrimi në Arafat.

Rëndësia e këtij ibadeti është se llogaritet kongres botëror, ngase në të njëjtën kohë dhe në të njëjtin vend tubohen një numër i madh i muslimanëve të botës, pa dallim race, kombi ose gjuhe dhe është simbol i unitetit të muslimanëve. Të gjithë i kryejnë të njëjtat obligime.

Haxhi është kryerje e disa obligimeve të veçanta, në kohë të veçantë dhe vende të veçanta.

Kryerja e haxhit është obligim një herë në jetë, për atë që i plotëson kushtet.



Haxhi i kujton muslimanët me gjithë pejgamberët, ngase në Meke kanë jetuar një numër i madh i tyre, e sidomos Ibrahimi alejhis-selam, i cili njihet si babë i pejgamberëve.

Haxhi llogaritet ibadet shpirtëror, fizik dhe material, sepse në këtë obligim aktivizohen të gjitha këto elemente.

### Aktivitete

- Arsintari sjell në klasë video projektor ose mjete tjera audio-vizuale dhe u sqaron nxënësve pamje filmike nga vendet e shenjta.
- Arsintari bisedon me nxënësit se si e përjetojnë përcjelljen dhe priten e të afërmve të tyre që shkojnë në haxh.

### Fjalor

**Arafat:** vend afër Mekës

### Le të mendojmë dhe le të bisedojmë

1. Cilin vend, Allahu xhel-le she'nuhu e ka dalluar nga të gjitha vendet e tjera?
2. Kush obligohet me kryerjen e haxhit?
3. Ku e sheh rëndësinë e këtij ibadeti?
4. Sa herë obligohet muslimani të kryej haxhin gjatë jetës së tij?
5. Çfarë ibadeti llogaritet haxhi?

## ASPEKTI EТИK NË MËSIMIN ISLAM

Islami është një sistem i kompletuar, i cili ofron rregulla etike dhe morale në gjitha sferat e jetës së njeriut. Andaj në vazhdim do të mësojmë për disa nga këto rregulla etike që duhet t'i zbaton besintari në jetën e tij.

### ETIKA ISLAME NË SHKOLLË

Njeriu dallohet nga të gjitha krijesat e tjera me anë të logjikës që e ka. Ai qysh prej lindjes së tij është i përgatitur në atë mënyrë që të arsimohet. I është dhuruar atij shqisa e të dëgjuarit dhe të parit. Andaj, nëpërmjet këtyre dy rrugëve njeriu shton njoburitë e tij dhe arsimohet.

Feja islame ngrihet mbi studim dhe hulumtim e jo mbi besim të verbër. Për këtë, Islami obligon që së pari të studiohen gjërat e mandej të besohen.

Fjalë e parë e zbritur në Kur'anin famëlartë është "Ikra", që do të thotë: lexo, studio, hulumto. Nga kjo nënkuptohet se njeriu i paarsimuar nuk mund të jetë as besimtar i mirë.

Vetëm ai që studion dhe lexon e kuption vlerën dhe rëndësinë e besimit në Allahu xhel-le she'nuhu dhe dobinë e zbatimit të fesë islame.

Shumë ajete kuranore flasin për rëndësinë e arsimimit dhe edukimit. Kjo le të kuptohet se Allahu xhel-le she'nuhu i do njerëzit e arsimuar dhe i urren ata që nuk shkollohen dhe që nuk arsimohen.

Islami nuk kërkon prej besimtarëve të merren vetëm me studimin e fesë, por kërkon prej tyre që t'i studiojnë të gjitha shkencat tjera.

Në mesin e muslimanëve duhet të ketë mjekë, inxhinierë, arsimtarë të gjitha lëmëve, mjeshtër dhe të kualifikuar në gjitha llojet që e kërkon nevoja e jetës së njeriut.

Islami i ka vlerësuar shumë njerëzit e ditur, derisa vlera e të diturit në krahasim me të paditurin është sikur vlera e njeriut të gjallë me atë të vdekur.

Njeriu, i cili nuk arsimohet nuk është në gjendje të adhurojë mirëfilli Allahu xhel-le she'nuhu, sepse për ta adhuruar Atë, duhet mësuar mirë fenë dhe çdo gjë që e ofron njeriun tek Allahu.

Për të realizuar gjithë këtë, çdo besimtar duhet:

- Gjatë shkollimit, në të gjitha fazat, atë fillor, të mesëm, sipëror dhe më pas, të

jetë i kujdeshshëm dhe të shfrytëzojë kohën në maksimum për nxënien e mësimeve;

- Krahas shkollës, të merret edhe më leximin e Kur'anit në mektebin e xhamisë;
- Të merret me lexim vazhdimesht, të lexojë çdo gjë që është e dobishme;
- Të përcjell ligjërata të ndryshme, qofshin me përbajtje shkencore ose fetare;
- Libri të jetë shoku i tij më i ngushtë gjatë tërë jetës së tij.

Nëse besimtarri vepron në këtë mënyrë, ai do të kuptojë qëllimin e krijimit të tij në këtë botë dhe do të dijë si të adhurojë Allahun xhel-le she'nuhu. Me këtë ai do të fitojë sikur këtë botë, po ashtu edhe jetën tjetër të ahiretit..

### **“Talebul ilmi feridatun ala kul-li muslimin”**

“Të kërkuarit e diturisë është obligim (farz) për çdo besimtar (dhe besimtare)”.



#### **Le të mendojmë dhe le të bisedojmë**

1. A e obligon Islami arsimimin për besimtarët?
2. Cilin e do Allahu, të arsimuarin apo të paarsimuarin, pse?
3. A e kërkon Islami studimin e shkencave të tjera?
4. Si i ka vlerësuar Islami njerëzit e ditur?
5. Çka duhet bërë për të realizuar urdhrrin kuranor për arsimim?
6. Çka i siguron arsimimi i mirëfilltë njeriut?



## ETIKA ISLAME NË JETËN FAMILIJARE

Shoqëria islame ngrihet mbi familje të shëndosha. Sa më shumë të ketë familje të shëndosha aq më shumë edhe shoqëria është e shëndoshë.

Për të qenë familja e shëndoshë, Islami ka caktuar disa rregulla. Së pari ka kërkuar prej të rinjve që kur të martohen ta bëjnë atë për hir të fesë dhe moralit.

Bashkëshortët e moralshëm dhe të edukuar do të krijojnë ambient të volitshëm për edukimin e drejtë të fëmijëve.

Fëmijët janë një ndër dhuratat më të mëdha që Allahu xhel-le she'nuhu ua dhuron prindërve.

Andaj, prindërit ndaj fëmijëve obligohen:

- të kujdesen për shëndetin dhe jetën e tyre;
- t'i arsimojnë që t'i njohin çështjet elementare të fesë së tyre;
- t'i edukojnë që sjelljet e tyre t'i kenë konform parimeve islame;
- t'u sigurojnë shkollim të mirëfilltë
- t'i emërtojnë me emra të mirë.

Prindi është i obliguar të kujdeset për fëmijët e tij meshkuj derisa të pavarësohen për jetë, ndërsa për femrat derisa të martohen.

Në lidhje me edukatën e mirë, Muhamed i alejis-selam ka thënë: “**Nuk ka mundur prindi t'i dhurojë fëmijëve diç më të mirë se edukatë të mirë**”.

Prindërit kujdesen për fëmijët e tyre t'u sigurojnë kushte të mira për jetë normale. Ata fëmijëve u ofrojnë ngrëtësinë amnore dhe dashurinë me qëllim që sa më mirë të jetojnë në këtë botë. Andaj, për gjithë këtë, fëmijët janë të obliguar që prindërit e tyre t'i dëgjojnë, t'i duan dhe t'i respektojnë.

Prindërit prej fëmijëve nuk kërkojnë shumë. Mjafton që fëmijët, në rast se kërkohet prej tyre diçka, të mos thonë: “jo”. Të mos e ngritin zërin kundër tyre dhe të mos u thonë ndonjë fjalë që i ofendon ata.

Duhet të dimë se kënaqësia e Allahut është në kënaqësinë e prindërve.

Allahu xhel-le she'nuhu, në Kur'an ka garantuar se ata që i respektojnë prindërit e tyre do të shpërblehen me shpërblime të mëdha.

Krahas prindërve, duhet respektuar edhe vëllezërit dhe motrat, bile edhe të gjithë farefisin dhe më gjerë. Të mëdhenjtë duhet të kujdesen për të vegjlit, por edhe të vegjlit duhet të kenë respekt ndaj të mëdhenjve.

Mes gjithë anëtarëve të familjes duhet të dominon dashuria, toleranca dhe mirëkuptimi.

Nuk duhet të ketë vend për ofendime, sharje, rrahje dhe gjëra tjera që prishin ngrohtësinë familjare.



## Aktivitete

Arsimtari së bashku me nxënësit bisedojnë rreth respektimit të prindërve në shtëpi.  
Arsimtar bashkëpunon me prindërit rreth edukimit të fëmijëve.



## Le të mendojmë dhe le të bisedojmë

1. Cilat janë obligimet e prindërve ndaj fëmijëve?
2. Çka ka thënë Muhamedi alejhis-selam në lidhje me edukatën?
3. Si duhet të jenë sjelljet e fëmijëve ndaj prindërve?
4. Çka ka garantuar Allahu xhel-le she'nuhu për ata që i respektojnë prindërit e tyre?
5. Si duhet të jetë sjellja me vëllezërit dhe motrat?

## FJALË E URTË

“Xhenneti është te këmbët e nënave”



## ETIKA ISLAME GJATË NGRËNIES

Allahu xhel-le she'nuhu i ka krijuar të gjitha krijesat. Krijesave të gjalla u ka siguruar edhe furnizimin. Allahu xhel-le she'nuhu edhe njeriut i ka siguruar furnizimin, por ka kërkuar prej tij të punojë dhe të fitojë.

Njeriu ka nevojë për ushqim, por gjatë ngrënies duhet të kihen parasysh rregullat vijuese:

- t'i pastrojë duart para ngrënies;
- të fillojë hajen me "bismilah";
- të hajë me dorën e djathët;
- të hajë ulur e jo në këmbë;
- ushqimi të mos jetë shumë i ngrohtë e as shumë i ftohtë;
- të mos fryj në ushqim të ngrohtë;
- të mos e mbush gojën shumë me ushqim;
- të hajë nga ajo që e ka para vetes;
- gjatë ngrënies të mos pinë shumë ujë;
- ta ndërpresë ngrënien para se të ngopet;
- ta përfundojë hajen me "elhamdu lilah";
- t'i lajë duart pas ushqimit.



Muslimani duhet të jetë falënderues dhe mirënjohës ndaj Allahut xhel-le she'nuhu për ushqimin që ia jep. Për këtë, nuk lejohet që ushqimi të hidhet, të shahet ose të zhvlerësohet. Nëse i pëlqen e hanë e nëse jo e lenë.

Allahu xh.sh na mëson se nëse e falënderojmë Atë për të mirat që na i jep, Ai do t'i shtojë ato.



### MËSO PËRMENDSH

**"Lein shekertum leezidennekum"**

**"Nëse falënderoni do t'ua shtojë të mirat"**



### Le të mendojmë dhe le të bisedojmë

1. Kush ka siguruar furnizimin e të gjitha krijesave?
2. Trego rregullat e ngrënies?
3. Si duhet të sillemi ndaj të mirave të Allahut?
4. Çka ka premtuar Allahu nëse e falënderojmë Atë?

## ETIKA ISLAME NË PUNË

Allahu xhel-le she'nuhu e krijoj njeriun dhe e përgatiti në atë mënyrë që të jetë i aftë t'i kryej obligimet e tij në tokë. Prej obligimeve të mëdha të njeriut në këtë jetë është edhe zhvillimi dhe përparimi i jetës në të.

Përparimi në këtë jetë mund të arrihet vetëm me anë të punës. Kështu çdo person duhet të punojë. Mësuesi duhet të punojë në shkollën e tij, mjeshtri në puntorinë e tij, bujku në arën e tij dhe çdo person në vendin e punës së tij.

Në familje, duhet të punojnë të gjithë, babai, nëna, vëllezërit, motrat etj. Vetëm kështu përparohet në jetë.

Islami na mëson se çdo punë e mirë duhet të fillojë me emrin e Allahut xhel-le she'nuhu, duke thënë: "baismilah". Ndërsa në fund të çdo pune duhet falënderuar Allahun duke thënë: "elhamdu lilah".

Allahu xhel-le she'nuhu i do shumë punëtorët. Njeriu më i dashur tek Allahu xhel-le she'nuhu është ai që fiton me dorën dhe djersën e vet.

Shumë ajete në Kuran nxisin për punë të mira. Po ashtu Muhamedi alejhis-selam në shumë hadithe potencon rëndësinë e punës. Ai thotë: "Asnjëri prej jush mos të pres furnizim duke u lutur: "Zot na furnizo, ngase e dini se qelli nuk zurret as ari e as argjend".

Një ditë, Muhamedi alejhis-selam pa një njeri me duar të çara nga puna. E mori dorën e tij, e puthi dhe tha: "Këtë dorë e do Allahu dhe i Dërguari i Tij".

Besimtari, së pari duhet të punojë, duke e lutur Allahun t'i ndihmojë në kryerjen e punëve të tij dhe më pas të kërkojë prej Tij ta furnizojë me të mirat e Tij.

Për përtacët nuk ka vend në shoqërinë islame. Ata nuk i do as Allahu, as Muhamedi alejhis-selam e as besimtarët.

### Le të mendojmë dhe le të bisedojmë

1. Pse duhet të punojnë të gjithë?
2. Si duhet filluar çdo punë e mirë dhe si duhet përfunduar?
3. Cilin besimtar e do Allahu xhel-le she'nuhu dhe Muhamedi alejhis-selam?
4. Trego një hadith të Muhamedit alejhis-selam që flet për vlerën e punës?
5. Ai do Allahu xhel-le she'nuhu përtacët?

## ETIKA ISLAME GJATË PËRSHËNDETJES

Feja islame është fe e paqes. Ajo siguron paqe dhe rehati për të gjithë njerëzit.

Islami na mëson se duhet të respektohen të gjithë njerëzit. Respekti më së shumti shfaqet duke i përshëndetur ata.

Sa herë që takohen muslimanët duhet të përshëndeten mes vete. Përshëndetja islame është “es-selamu alejkum”, që do të thotë “paqja dhe shpëtimi qofshin mbi ju”. Çdo besimtar që e dëgjon këtë përshëndetje, obligohet të përgjigjet me “ve alejkumus-selam”, që do të thotë “paqja dhe shpëtimi qofshin edhe mbi ju”.

Përshëndetja, pra është një lutje që e bën muslimani për vëllain e tij musliman.

Islami na mëson se individi duhet ta përshëndes grupin, ai që është në këmbë ta përshëndes atë që është ulur, ai që është hipur ta përshëndes atë që është në tokë dhe i vogli ta përshëndes të madhin.

Feja islame na mëson t'i përshëndesim të gjithë njerëzit, pa marrë parasysh fenë, nacionalitetin ose gjininë.

Me anët të përshëndetjes shprehet një shkallë e lartë e respektit mes njerëzve. Ky respekt duhet të zbatohet kudo që të jetë njeriu.



### Aktivitete

Arsimtari sa herë të hyjë në klasë dhe të dalë prej saj, i përshëndet nxënësit me selam.



### MOS HARRO!

- Sipas Islamit njerëzit i përshëndesim me “es-selamu alejkum”.
- Kësaj përshëndetje i përgjigjemi me “ve alejkumus-selam”.
- Selami është përshëndetja edhe e banorëve të xhenetit.



### Le të mendojmë dhe le të bisedojmë

1. Me cilën fjalë duhet përshëndetur njerëzit?
2. Si duhet të përgjigjemi, në rast se na përshëndet dikush me selam?
3. Trego rregullat islame se kush kë duhet ta përshëndes?
4. A duhet përshëndetur vetëm muslimanët apo të gjithë njerëzit?
5. Cila është përshëndetja e banorëve të xhenetit?

### FJALË E URTË

“Përshëndetja me selam e shton dashurinë”.

## ETIKA ISLAME NË XHAMIT

Xhamia është shtëpia e Allahut xhel-le she'nuhu ku tubohen muslimanët disa herë gjatë ditës dhe natës për të kryer obligimet ndaj Allahut xhel-le she'nuhu.

Sikur në të kaluarën, po ashtu edhe në të tashmen, xhamia luan rol edukativ-arsimor, si nga aspekti shpirtëror, po ashtu edhe nga ai moral e fizik.

Xhamia është vend ku tubohen muslimanët për të adhuruar Allahun xhel-le she'nuhu me namaz, dhikër dhe forma tjera të adhurimit. Në xhami mbahen ligjëratë të ndryshme, ku vaizët u sqarojnë besimtarëve rregullat fetare dhe porositë e Allahut xhel-le she'nuhu dhe të Muhamedit alejhis-selam.

Në xhami të gjithë besimtarët janë të barabartë. Aty nuk ka dallim mes të pasurit dhe të varfrit, të diturit dhe të paditurit, të madhit dhe të voglit, atij që ka post udhëheqës dhe atij që udhëhiqet, pra të gjithë janë të barabartë.

Nga pikësynimet e xhamisë është edhe mbjellja e barabarësisë, unitetit dhe vëllazërisë mes muslimanëve.

Krahas meshkujve, edhe femrat kanë plotësisht të drejta të shkojnë në xhami dhe të kryejnë obligimet e tyre fetare.

### **Përgatitja për shkuarje në xhami**

Besimtari para shkuarjes në xhami duhet bërë parapërgatitjet e duhura. Ai së pari duhet të pastrojë trupin e tij. Të mos jetë i djersitur dhe të mos i vijë erë e keqe. Ai duhet t'i ketë thonjtë e prerë, dhëmbët e lara, rrobat duhet t'i ketë të pastra dhe të parfumoset me aromë të këndshme.

Kur të dalë prej shtëpisë duhet bërë “bismilah”. Duhet të jetë i bindur se çdo hap që e hapëron për të shkuar në xhami, ai shton një sevap dhe shlyen një gjynah.

Gjatë rrugës duhet të ruhet të mos shkelë në vende që i ndotin rrobat e tij. Gjithashtu duhet të jetë shumë i kujdesur të mos flasë fjalë të ndyta që prekin sjelljen morale të tij.

Ditëve të premte duhet shkuar më herët na xhami, sepse këtë ditë sevapi është më i madh. Kur të arrijë në oborrin e xhamisë, nuk duhet të qëndrojë jashtë xhamisë, por duhet menjëherë të hyjë brenda.

### **Qëndrimi në xhami**

Gjatë hyrjes në xhami, besimtari duhet të hyjë me këmbën e djathtë dukë thënë “bismilah” dhe duke u lutur: “*Allahummaftah li evvabe rabmetike*” (O Allah m'i hap mua dyert e

mëshirës Sate!).

Pas hyerjes në xhami duhet të kërkojë vend të zbrazët për t'u ulur. Preferohet të kërkohet vend në pjesën e përparme të xhamisë, por me kusht të mos i shtyj të tjerët.

Muslimani kur të hyjë në xhami duhet të dijë se është mysafir i Allahut xhel-le she'nuhu, andaj duhet të ketë kujdes gjatë qëndrimi në të.

Gjatë qëndrimit ulur në xhami duhet madhëruar dhe falënderuar Allahuun xhel-le she'nuhu me lloje të ndryshme të dhikrit, si p.sh. duke thënë disa herë: "La ilah il-lallah" (Nuk ka zot tjetër përpos Allahut), "Subhanellah" (i lartëmadhëruar është Allahu), "elhamdu lilah" (Falënderimi i takon Allahut), "Allahu ekber" (Allahu është më i madhi), "Estegfirullah" (kërkoj falje prej Allahut) etj. Për ata që dinë të lexojnë Kur'an është mirë të lexojnë diçka prej tij. Lejohet të lexohet edhe nga ndonjë libër tjetër fetar.

Nëse në xhami është duke u mbajtur ligjëratë, muslimani obligohet ta përcjellë atë me vëmendje. Në veçanti ditën e premte duhet të dëgjojë hutben që e lexon hatibi. Në xhami nuk duhet të flitet e as të qeshet. Aty duhet të shkohet me rrobe të pastra dhe obligohemi ta ruajmë pastërtinë e saj.

Gjatë faljes së namazit me xhemat, duhet pasur kujdes në drejtimin dhe plotësimin e safeve.

Xhamia në brendinë e saj përfshinë edhe pjesët përbërëse të saj. Aty gjendet mihrabi, kursija, minberi dhe mahfili. Jashtë xhamisë janë edhe minarja dhe shatërvani.

### Dalja nga xhamia

Pasi muslimani kalon një kohë në xhami, ku ka përjetuar kënaqësi shpirtërore, ka falur



namaz, ka mësuar nga ligjérata e vaizit dhe ka madhëruar Allahun xhel-le she'nuhu, vjen koha të dalë prej saj.

Muslimani gjatë daljes nga xhamia nuk duhet të përshpejtojë të dalë i pari. Ai duhet të bëjë përpjekje të jetë prej të fundit që dalin nga ajo. Besimtar më i mirë është ai që hynë më herët dhe del më vonë. Prej xhamisë del pasi t'i ketë kryer të gjitha obligimet.

Gjatë daljes nuk duhet të flitet e as nuk duhet të shtyen të tjerët. Del me këmbën e majtë duke thënë: "**Allahumme zukni min fadlike**" (o Allah më jep prej mirësive Tua!).

Pas daljes nga xhamia, muslimani kthehet në shtëpi, vendin e punës ose kudo qoftë, duke i dhënë besën Allahut xhel-le she'nuhu se nuk do të veprojë punë të këqija. Do të ruajë pastërtinë e rrugës, shtëpisë dhe vendit ku jeton.



## Fjalor

**Vaiz:** ligjérues në xhami

**Imam:** personi, i cili u prinë besimtarëve gjatë faljes së namazit

**Sevap:** shpërblim me të mira

**Gjynah:** mëkat, vepër e keqe që meriton ndëshkim

**Hutbe:** ligjératë që mbahet ditëve të premte dhe gjatë bajrameve

**Hatib:** personi që mbanë ligjératat

**Safe:** rreshta të drejta të drejtuar me fytyrë kah Kibleja

**Mihrab:** vend ku falet imami

**Kursi:** vend ku ulet personi që ligjëron në xhami

**Minber:** vend i ngritur në formë të shkallëve ku hatibi mbanë ligjératën

**Mahfil:** vendi ku qëndron myezini

**Minare:** objekt i gjatë ku thirret ezani

**Shadërvan:** vend ku besimtarët marrin abdes.



## Aktivitete

- Arsimtari organizon bisedë me nxënësit rrëth xhamisë dhe pjesëve përbërëse të saj.


- Arsimtari me anë të video-projektorit u sjell nxënësve pamje nga xhami të ndryshme

dhe u sqaron mënyrën e hyrjes, qëndrimit dhe daljes nga xhamia.



## Le të mendojmë dhe le të bisedojmë

1. Çfarë roli ka xhamia në jetën e besimtarëve?
2. Çfarë vepra kryhen në xhami?
3. Xhamia siguron barabarësi apo diskriminim mes besimtarëve? Si?
4. Çka duhet të pastrojë besimtarë para shkuarjes në xhami?
5. Çka ka premtuar Muhamed i alejhis-selam për atë që shkon në xhami?
6. Si duhet të sillet besimtarë gjatë shkuarjes në xhami?
7. Në cilën ditë duhet shkuar më herët në xhami dhe pse?
8. Me cilën këmbë duhet hyrë në xhami dhe çka duhet thënë?
9. Ku duhet ulur në xhami dhe cili është vendi më i preferuar?
10. Çka duhet bërë gjatë qëndrimit në xhami?
11. Nëse në xhami mbahet ligjëratë, çka duhet bërë?
12. A lejohet në xhami biseda, qeshja etj.?
13. Gjatë faljes me xhemat, si duhet rregulluar safet?
14. Cilat janë pjesët përbërëse të xhamisë?
15. A duhet përshpejtuar gjatë daljes prej xhamisë?
16. Me cilën këmbë duhet dalë prej xhamisë dhe çka duhet thënë?
17. Çka duhet bërë pas daljes nga xhamia?
18. Cilat janë shtëpitë e Allahut në tokë?



## ETIKA ISLAME NË VESHJE

Allahu xhel-le she'nuhu e krijoj njeriun nga balta. Ai së pari e krijoj mashkullin e pastaj nga brinja e tij e krijoj femrën. Vetëm me ekzistimin e të dy gjinive mund të ekzistojë lloji njerëzor.

Të dy gjinitë janë të barabartë në dinjitetin e tyre njerëzor. Ata janë të barabartë para Allahut xhel-le she'nuhu.

Mes tyre ekzistojnë disa dallime psikofizike. Këto dallime janë në interes të të dy gjinive dhe me to përplotësojnë njëri-tjetrin.

Dallimet psikofizike mes meshkujve dhe femrave imponojnë dallime në sjelljen dhe veshjen e tyre.

Veshja e meshkujve duhet të përshtatet me natyrën e tyre psikofizike, po ashtu veshja e femrave duhet të përshtatet me natyrën e tyre psikofizike.

Islami ka kërkuar prej meshkujve në mënyrë obliguese (farz) ta mbulojnë pjesën prej kërthizës deri nën gjunjë, por sa më shumë të mbulohet trupi është më mirë. Po ashtu ka kërkuar prej femrave të mbulojnë tërë trupin në përjashtim të fytyrës, këmbëve dhe duarve deri te zogu.

Mbulesa e femrës është bukuri dhe mbron nderin e saj.

Veshja e femrave duhet të plotësojë këto kushte:

- Ta mbulojë tërë trupin;
- Të jetë e gjerë dhe jo e ngushtë;
- Të mos jetë e tejdukshme;
- Të mos jetë stoli në vete;
- Të mos jetë me parfum;
- Të dallojë nga veshja e meshkujve.

Meshkujt e kanë të ndaluar bartjen e arit dhe mëndafshit, ndërsa një gjë e tillë është lejuar për femrat.

Veshja e meshkujve duhet të dallojë nga veshja e femrave dhe nuk duhet të bartin rroba të njëjta.

Muhamedi alejhis-selami i ka mallkuar meshkujt, të cilët (me veshjet dhe sjelljet e tyre) u ngajnjë femrave, si dhe femrat, ta cilat (me veshjet dhe sjelljet e tyre) u ngajnjë meshkujve.



### Le të mendojmë dhe le të bisedojmë

1. A janë të barabartë meshkujt dhe femrat?
2. Në çka dallojnë meshkujt dhe femrat?
3. A duhet të ketë dallime edhe në veshje mes meshkujve dhe femrave?
4. Cilët pjesë të trupit obligohet të mbulojë mashkulli e cilat femra?
5. Çfarë kushte duhet të plotësojë veshja e femrave?
6. Cilin e ka mallkuar Muhamedi alejhis-selam?

## MORALI I INDIVIDIT NË SHOQËRI

Prej qëllimeve më të rëndësishme të islamit është edhe ajo që individin ta edukojë të jetë i moralshëm. Aq sa më i moralshëm të jetë njeriu aq është më afër Allahut xhel-le she'nuhu dhe Muhamedit alejhis-selam. Për këtë, Muhamedi alejhis-selam ka thënë: "Më afër meje në ditën e kiametit në xhenet do të jenë ata që janë më të moralshëm".

Muslimani duhet të përpinqet të jetë i moralshëm kudo që gjendet ai, qoftë në shtëpi, shkollë, rrugë, punë dhe gjetiu.

Morali i muslimanit shfaqet në të folurit e tij, në sjelljen e tij, në veprat e tij dhe në gjitha lëvizjet e tij. Ai duhet të jetë i moralshëm me gjithë njerëzit, pa marrë parasysh gjininë, racën apo përkatësinë fetare e nacionale.

Muslimani në sjelljen e tij duhet të jetë i drejtë me gjithë njerëzit. Nuk lejohet në asnjë mënyrë që një musliman të bënë padrejtësi ndaj cilit do qoftë prej njerëzve.

Duhet kuptuar se njeriu është krijuar nga Allahu xhel-le she'nuhu që të jetë bamirës në jetën e tij. Jeta është e shkurtë, andaj duhet vepruar punë të mira për të vërtetuar se kemi jetuar në te.

Për çdo vepër të mirë që e bënë njeriu, Allahu atij do t'i jepë jetë të lumtur në këtë botë, ndërsa në ahiret do ta shpërblejë me xhennet.



### Aktivitete

Bisedë dhe lexim të teksteve rreth edukimit dhe moralit të individit dhe shoqërisë në temën: "Drejtësia në jetë, mos mbyt, duaje të vërtetë".



### Le të mendojmë dhe le të bisedojmë

1. Cili individ është më afër Allahut xhel-le she'nuhu dhe Muhamedit alejhis-selam?
2. Ku dhe me kë duhet të jetë i moralshëm muslimani?
3. A duhet muslimani të jetë i drejtë në sjelljen e tij?
4. Me çka shpërblehet vepra e mirë?

## PËRGJEGJËSIA NDAJ VETES DHE TË TJERËVE

Të gjithë njerëzit kanë një prejardhje. Kanë një babë dhe një nënë. Baba i gjithë njerëzisë është Ademi alejhis-selam, ndërsa nëna e tyre është Hava. Për këtë, dallimet e tyre në racë, gjuhë dhe gjini, nuk kanë aspak vlerë. Kjo na bënë të bindemi se të gjithë njerëzit para Allahut xhel-le she'nuhu janë të barabartë.

Feja është një çeshtje, të cilën e beson njeriu në bazë të bindjes së tij. Feja nuk fitohet me dhunë. Askush nuk ka të drejtë që dikujt tjetër t'ia imponojë një fe që ai nuk është i bindur në të. Për këtë, liria e përqafimit të fesë është e drejtë e çdokujt.

Sot në botë ekzistojnë ithtarë të religjioneve të ndryshme. Feja nuk duhet të përdoret si mjet për mospajtime dhe luftime, por ajo duhet të jetë urë lidhëse mes gjithë njerëzve.

Secili person, ashtu siç respekton fenë e vet, ai duhet të respektojë edhe fenë e të tjerve. Respektimi i fesë së njëri-tjetrit është një pikënisje për një bashkëpunim sa më të ngushtë në mes të gjithë njerëzve.

Feja islame na mëson që të jemi të përgjegjshëm në jetë, sikur ndaj vetes ashtu edhe ndaj të tjerve. Në lidhje me këtë, Muhamedi alejhis-selam thotë: “Njeriu më i mirë është ai që është më i dobishëm për njerëzit”.

Në Maqedoni, ekzistojnë ithtarë të religjioneve të ndryshme. Religjione më të përhapura janë Krishterizmi dhe Islami.

Sikur Bibla, po ashtu edhe Kurani, urdhërojnë për respektimin e feve tjera si dhe respektimin e ittarëve të feve tjera.



Të gjithë jemi të barabartë para Allahut si njerëz. Raca, gjuha e gjinia nuk kanë fare vlerë. Më tē afërt tek Allahu janë më besimtarët dhe më tē devotshmit.

Ja se çka thotë Kurani në lidhje me këtë çështje:

**“O ju njerëz, vërtet Ne ju krijuam juve prej një mashkulli dhe një femre, ju bëmë popuj dhe fise që tē njiheni ndërmjet vete”.** El Huxurat 49/13



## MOS HARRO!

- Baba i gjithë njerëzisë është Ademi alejis-selam, ndërsa nëna Hava.
- Të gjithë njerëzit janë tē barabartë para Allahut xhel-le she'nuhu.
- Njeriu më i mirë është ai që është më i dobishëm për njerëzit.
- Fetë më tē përhapura në Maqedoni janë Krishterimi dhe Islami.



## Le tē mendojmë dhe le tē bisedojmë

1. A kanë tē gjithë njerëzit një prejardhje?
2. Kush është babë e kush nëna e gjithë njerëzve?
3. A janë tē gjithë njerëzit tē barabartë?
4. Feja duhet tē jetë shkas për pérçarje apo bashkëpunim?
5. A duhet respektuar fenë e tjetrit?
6. Sipas Muhamedit alejis-selam, cili është njeriu më i mirë?
7. Në çka thërrasin Bibla dhe Kurani?
8. Cilët njerëz janë më afër Allahut xhel-le she'nuhu?

## BAZAT E MORALIT ISLAM

### CILËSITË E BESIMTARIT TË MIRË

Çdo besimtarë, duhet të cilësohet me cilësi të mira. Këto cilësi mund te merren nga Kurani dhe sunneti i Muhamedit alejhis-selam. Islami e edukon njeriun në atë mënyrë që të jetë i vyshtëm dhe i dobishëm për veten dhe mbarë shoqërinë.

Nuk lejohet në asnje mënyrë që njeriu të jetë egoist, por ai duhet t'i donë gjithë njerëzit. Ai duhet që tjerëve t'ua dëshiron të mirën ashtu siç e dëshiron për veten e tij.

Besimtari duhet që gjithnjë të mendon mirë, të flet mirë dhe të vepron mirë. Muslimani i mirë është solidar me të tjerët, u ndihmon atyre saherë që kanë nevojë.

Prej cilësive shumë të rëndësishme të muslimanit është edhe humaniteti. Ai duhet të jetë bamirës kudo që gjendet. Bamirësia mund të jetë moralisht dhe materialisht.

Mëshira zë një vend të rëndësishëm në jetën e muslimanit. Ai duhet të jetë i mëshirshëm me gjithë njerëzit, qofshin të mëdhenj apo të vegjël, meshkuj apo femra dhe pa marrë parasysh fenë dhe nacionalitetin e tyre. Mëshira shfaqet edhe ndaj shpendëve dhe kafshëve, duke mos i rrahu apo dëmtuar ato.

Përveç asaj që u tha, respekti ndaj gjithë njerëzve është një cilësi shumë e rëndësishme e muslimanit. Ai duhet të shprehë respekt ndaj gjithë njerëzve. Me këtë, muslimani tregon se është i moralshëm dhe i edukuar.

#### Aktivitete

Arsimtari zhvillon bisedë me nxënësit rrreth mënyrave të ndryshme të dashurisë, solidaritetit, humanitetit dhe respektit ndaj të gjithë njerëzve.

#### Le të mendojmë dhe le të bisedojmë

1. A lejohet që besimtari të donë vetëm veten e tij?
2. Muslimani duhet të jetë solidar apo jo?
3. Humaniteti, cilësi e kujt është?
4. Mëshira dhe respekti janë cilësi të besimtarit të mirë apo jo?

## MBROJTJA NGA VEPRAT E KËQIJA

Islami përbëhet prej aspektit teorik që përfshinë besimin me mend dhe zemër si dhe apektin praktik që përfshinë të gjitha veprimet.

Muslimani e di se besimi i tij plotësohet në dy mënyra: duke vepruar atë që është e lejuar (hallall) dhe duke hequr dorë nga ajo që është e ndaluar (haram). Muhamed i alehjis-selam ka thënë: “*Ruaju nga harami do të jesh adhuruesi më madh në mesin e njerëzve*”.

Hallall është çdo veprim që Allahu xhel-le she'nuhu e ka lejuar, ndërsa haram është çdo gjë që Allahu xhel-le she'nuhu e ka ndaluar rrëptësisht.

Islami në vete përmban një sistem të kompletuar që ka për qëllim përgatitjen e njeriut, të jetë dobiprurës për veten, për familjen e tij dhe mbarë shoqërinë.

Islami me anë të dispozitave të tij synon mbrojtjen e nderit të njeriut, qoftë individualisht ose kolektivisht dhe atë në familje, shkollë, rrugë dhe kudo që jeton.

Të qenit njeri “i ndershëm” është shumë i rëndësishëm dhe jetik për mbarë njerëzinë, sepse vetëm në këtë mënyrë do të evitojen të gjitha dukuritë negative.

Muslimani duhet të dijë se Allahu xhel-le she'nuhu e sheh atë kudo që gjendet, andaj nuk duhet të veprojë diç që Allahu e ka ndaluar.

Çdo musliman është i obliguar të veprojë atë që Allahu e ka urdhëruar veprimin e tij, si dhe të heqë dorë nga ajo që Allahu e ka ndaluar dhe e ka bërë haram.

Veprat e këqija sjellin zemërimin e Allahut. Kështu besintari që kryen vepra të ndaluara, Allahu është i zemëruar mbi të. Po ashtu, veprat e këqija jo vetëm që dëmtojnë vetë personin, por dëmi përfshinë edhe shoqërinë.

Veprat e këqija ose gabimet, sipas rëndësisë ndahen në tri grupe: gabime të rënda, të mëdha dhe të vogla.

### **Gabimet e rënda**

Gabimet e rënda janë ato gabime, të cilat nëse veprohen, nxjerrin njeriun nga besimi.



Nëse personi i tillë nuk pendohet dhe nuk përtërinë besimin nuk mund të jetë musliman.

Në mesin e gabimeve të rënda veçojmë:

- kufri (mosbesimi) në Allahun xhel-le she'nuhu, melaiket, librat dhe pejgamberët e Allahut, Ditën e Kijametit dhe urdhurat e Allahut;
- shirku, besimi në zotëra të rrejshëm si p.sh. yje, kafshë, horoskop etj.
- sharja dhe fyerja e Allahut xhel-le she'nuhu;
- sharja dhe zhvlerësimi i simboleve të shenjta islame si p.sh. Kur'anin, Qaben, xhaminë, namazin, agjërimin etj.;
- bartja e simboleve të feve tjera;
- sihiri (magjia), etj.

Personi, i cili vepron ndonjë nga veprat e lartshënuara dhe vdes para se të pendohet shkon si jomusliman.

### Gabimet e mëdha

Gabime të mëdha janë ato gabime për të cila parashihet dënim i ashpër, por megjithatë njeriu nuk e nxjerrin nga besimi. Personi, i cili kryen ndonjë gabim të madh duhet sinqerisht të pendohet dhe të lus Allahun xhel-le she'nuhu për mëshirë dhe falje.

Në mesin e gabimeve të mëdha veçojmë:

- pirja, prodhimi, shitja dhe shërbimi i pijeve alkoolike, narkotike, etj.
- ngrënia e mishit të derrit;
- ofendimi i prindërve, mosrespektimi dhe pakujdesi për ta;
- mbytja e njeriut të pafajshëm;
- gënjeshtra;
- dëshmia e rrejshme;
- dyfytërsia;
- amoraliteti;
- vjedhja;
- matja jo me të drejtë;
- ofendimi dhe nënçmimi i të tjerëve;
- përgojimi;
- mosfrikësimi nga dënim i Allahut;
- moskryerja e obligimeve islame (namazi, zeqati, agjërimi etj.);
- vetëvrasja, etj.

### Gabimet e vogla

Në mesin e gabimeve të vogla veçojmë:

- mosfalja e namazit me xhemat pa arsy;
  - biseda gjatë leximit të Kur'anit, thirrja e ezanit, dhikrit etj.
- Përsëritja e gabimeve të vogla, llogaritet gabim i madh.



## MËSO PËRMENDSH



Kul eudhu birabbil felek.  
Min sherri ma halek.  
Ve min sherri gasikin idha  
vekab.  
Ve min sherrin-neffathati fil-  
ukad.  
Ve min sherri hasidin idha  
hased.

Thuaj:  
I mbështetem Zotit të  
agimit  
Prej dëmit të çdo krijese, që  
Ai e krijon  
Dhe prej errësirës së natës  
kur ngryset plotësisht  
Dhe prej dëmit të atyre që  
lidhin dhe fryejn nyja  
Edhe prej dëmit të  
smirëkeqit kur sipas smirës  
vepron.



### Le të mendojmë dhe le të bisedojmë

1. Kur dhe si plotësohet besimi i muslimanit?
2. Çka është hallalli e çka harami?
3. Çka sjellin veprat e këqija?
4. Si ndahen gabimet sipas rëndësisë?
5. Çka është kufër e çka shirk?
6. Cilat janë veprat që e nxjerrin njeriun nga besimi?
7. Ç'janë gabimet e mëdha?
8. Numëro disa nga gabimet e mëdha?
9. Numëro disa nga gabimet e vogla?

## PENDIMI PREJ VEPRAVE TË KËQIJA (TEVBEJA)

Gjatë jetës së tij, njeriu shpeshherë mund të gabojë. Kështu nuk mund të gjesh asnjë njeri që nuk gabon. Pas bërjes së gabimit, muslimani duhet, pa u vonuar, të kthehet tek Allahu xhel-le she'nuhu dhe ta lusë Atë për falje, e në veçanti nëse gabimi është i madh. Ai person, i cili bën vepra të këqija dhe nuk pendohet, do të dënohet për të në jetën e ahiretit.

Pra, tevbe ose pendim është kërkimi i faljes për gabimin e bërë. Kjo domethënë drejtim tek Allahu xhel-le she'nuhu me kërkësë për falje.

Disa gabime të rënda nuk falen. Nëse personi që i vepron ato gabime nuk pendohet dhe nuk heq dorë prej tyre, do të jetë përgjithmonë në xhehenem.

Pendimi duhet të realizohet me sinqeritet të plotë.

Falja e gabimit kërkon plotësimin e këtyre kushteve:

- të pendohet për veprën që ka bërë;
- të heqë dorë nga ajo vepër dhe
- të japë besën se nuk do të kthehet përsëri në atë vepër.

Nëse gabimi ka të bëjë me ndonjë person, atëherë duhet kërkuar falje prej tij ose duhet t'i kthehet haku atij.

Dyert e pendimit janë gjithnjë të hapura. Njeriu duhet dhe mundet të pendohet gjatë tërë jetës, deri në vdekje.

Ekzistojnë shumë forma dhe mënyra për pendim si p.sh. falja e namazit, agjërimi, haxhi, lutjet e ndryshme, etj.

Prej lutjeve që më së shumti duhet përdorur është: "Estegfirullahe ve etubu ilejhi" (kërkoj falje prej Allahut dhe tek Ai kthehem).

Nëse besimtari është i sinqertë në pendimin e tij, Allahu jo vetëm që do ta falë atë, por ka premtuar se gabimet e tij do t'i shndërrojë në sevape.

### "Estegfirullahel adhime ve etubu ilejhi"

Kërkoj falje prej Allahut të madhërishëm dhe tek Ai kthehem.

### Le të mendojmë dhe le të bisedojmë

1. Çka është pendimi (tevbeja)?
2. Cilat kushte duhet plotësuar në pendim?
3. Deri kur, njeriu ka mundësi të pendohet?
4. Cila është forma më e lehtë e pendimit?
5. Çka ka premtuar Allahu xhel-le she'nuhu për ata që pendohen?

## SJELLJA ISLAME DHE RESPEKTI GJATË FESTAVE

Në Islam ekzistojnë dy festa të mëdha:

- a. Festa e Fitër Bajramit
- b. Festa e Kurban Bajramit.

Festat e Bajramit janë të bekuara, të cilat në mesin e muslimanëve kanë domethënie të veçantë. Me anë të këtyre festave, Islami ofron për muslimanët gëzim të përbashkët. Krahës gëzimit që e përjetojnë muslimanët, ata në këto festa falënderojnë Allahun xhel-le she'nuhu për obligimet e kryera.

### FITËR BAJRAMI

Fitër Bajrami fillon më 1 Sheval dhe zgjatë tri ditë. Kjo festë vjen pas përfundimit të agjërimit të muajit Ramazan.

Pas të gjitha aktiviteteve që i kryen muslimani gjatë Ramazanit, duke përfshirë syfyrin, faljen e namazeve ditore, agjërimin, dhikrin, iftarin, leximin e Kur'anit, namazin e teravive etj., me përfundimin e ditës së fundit të Ramazanit, vjen edhe dita e festës. Kjo është festa e Fitër Bajramit.

Muslimanët festojnë se kanë arritur të kryejnë një obligim shumë të rëndësishëm islam.

Në ditën e parë të Fitër Bajramit, muslimani herët në mëngjes duhet të pastrojë trupin e tij. Është e preferuar që pas kohës së syfrit të hanë disa hurma tek, sepse kështu ka vepruar Muhamedi alejhis-selam

Më pas shkon në xhami duke thënë lloje të ndryshme të dhikrit, e në veçanti tekbirin. Muhamedi alejhis-selam ka thënë: “*Zbukuroni festat tuaja me tekbir (Allahu ekber), tehlil (La ilâha illallah) tehmid (elhamdu lilah)*”.

Pas faljes së namazit të Fitër Bajramit, e që është vaxhib, muslimanët dalin prej xhamisë dhe kthehen në shtëpitë e tyre për të uruar njëri-tjetrit festën.

Në këtë ditë, të gjithë muslimanët, e në veçanti fëmijët i veshin rrrobat më të mira që i posedojnë dhe vizitojnë të afërmit e tyre, fqinjët, miqtë dhe shokët. Në të njëjtën kohë u ofrojnë atyre ëmbëlsira të llojeve të ndryshme.


## KUDO FESTË

Në k'to çaste të Bajramit,  
Buzëqesh fytyra e muslimanit.  
Sot ka gëzim Bota islame,  
Këndon Kur'an e thërret ezan-e.

Ramazanin me plot begati,  
E përcollëm me krenari.  
Me ibadet e dhikër Zotit,  
Kalojnë ditët e motmotit.

Gjithë natyra në formë të vet,  
Madhëron Zotin e vërtetë.  
Ndriçon hëna, shkëlqen dielli,  
Feston toka, feston qielli.

Në çdo shtëpi të muslimanit,  
Shtrohet sofa e Bajramit.  
Përvendet vëllai vëllanë e vet,  
Uron Bajramin për shumë vjet.



### Fjalor

**Sheval:** muaji i dhjetë në kalendarin hixhri.



### Aktivitete

- Arsimtari së bashku me nxënësit bisedon përmënyrën e festimit të fitër bajramit në shtëpitë e tyre.
- Përsëritja e tekbireve dhe recitimi i ilahive.



### Le të mendojmë dhe le të bisedojmë

1. Cilat janë festat më të rëndësishme në Islam?
2. Pas përfundimit të cilit muaj vjen festa e Fitër Bajramit?
3. Për çka festojnë muslimanët këtë festë?
4. Si festohet Fitër Bajrami?
5. Me çka u ndihmohet të varfërvye në këtë festë?

## KURBAN BAJRAMI

Kurban Bajrami është ditë festë për muslimanët. Ajo është në ditën e 10 të muajit dhul hixhe dhe zgjatë katër ditë. Kjo festë është e lidhur ngushtë me kryerjen e obligimit të haxhit, përfundimin e shpalljes së Kur'anit dhe therjes së kurbanit.

Secila prej këtyre tri çështjeve, bartë me vete domethëniet të mëdha islame. Haxhi simbolizon unitetin e të gjithë muslimanëve në një bashkësi të vetme. Përfundimi i shpalljes së Kur'anit simbolizon përfundimin e shpalljeve të Allahut si udhërrëfyes për gjithë njerëzit. Kurbani simbolizon sakrififikimin dhe ndarjen e festës me të tjërët.

Sikur festa e Fitër Bajramit, po ashtu edhe festa e kurban bajramit vjen pas përfundimit të një kushti të rëndësishëm islam, e që është obligimi i haxhit.

Gjatë festës së kurban bajramit duhet të realizohen disa rregulla:

- Është mirë që para faljes së namazit të kurban bajramit të mos hahet asgjë;
- Rrugës gjatë shkuarjes në xhami, me zë të ulët të thuhet tekbi (Allahu ekber);
- Pas kthimit nga xhamia të thërrret kurbani;

Para therjes së kurbanit të thuhet tekbi, mandej duke thënë “bismilah” të theret me thikë të mprehtë;

### Fjalor

**Dhul hixhe:** muaji i dymbëdhjetë në kalendarin hixhari

**Kurban:** kafshë e caktuar që herret për hir të Allahut

### Aktivitete

- Arsimtari së bashku me nxënësit bisedon përmbytjet e festimit të Kurban Bajramit në shtëpitë e tyre.
- Bisedë rreth mënyrës së therjes së kurbaneve.
- Bisedë dhe aktivitet hulumtues rreth temës: “Roli i kurbanit në mësimin islam”.

### Le të mendojmë dhe le të bisedojmë

1. Në cilën ditë është festa e Kurban Bajramit?
2. Me çka është e lidhur ngushtë kjo festë?
3. Trego rregullat, të cilave duhet t'i përmbahemi gjatë festës së kurban bajramit?
4. Si duhet ndarë mishi i kurban dhe çka tregon kjo çështje?

## FESTAT DHE HUMANITETI I NJERIUT

Duke i mësuar përmbajtjet do të mund:

- të kuftosh lidhshmërinë mes festave dhe humanitetit të njeriut ndaj të varfërve dhe jetimëve me sadekatal fitër dhe kurban;
- të kuftosh historikun dhe rolin e kurbanit;
- të mësosh për rëndësinë e Natës së Kadrit;
- të mësosh se fillimi i shpalljes së Kuranit ka ndodhur pikërisht në Natën e Kadrit.

Gjatë dy festave: Fitër Bajramit dhe Kurban Bajramit, shihet qartë edhe humaniteti i muslimanit. Ai gjatë këtyre festave solidarizohet me të varfrit dhe ndanë një pjesë ta pasurisë së tij për të varfrit me qëllim që edhe ata të përfjetojnë gëzimin e këtyre festave.

Në festën e Fitër Bajramit, me anë të sadekatal fitrit që e japid muslimanët, të varfrit sigurojnë përvete një sasi të tē hollave, me të cilat festojnë bashkërisht me muslimanët e tjere.

Gjithashtu, mishi i kurbanit që therret në festën e Kurban Bajramit, duhet ndarë të afërmve, fqinjëve dhe të varfërve, por mund të lihet diçka edhe përvete.

Sikur në Fitër Bajram, po ashtu edhe në Kurban Bajram shihet qartë humaniteti i muslimanit ndaj të varfërve.

Me këtë vërehet se feja islame është fe humanizimi që i përfshinë të gjithë muslimanët bile edhe ithtarët e feve tjera.

### Fjalor

**Sadekatu fitri:** sasi e caktuar e të pasurisë që jep çdo musliman në fund të Ramazanit.

## HISTORIKU I KURBANIT DHE ROLI I TIJ

Një ndër pejgamberët më të dalluar të Allahut xhel-le she'nuhu është edhe Ibrahimim alejhis-selam. Ai ishte i martuar me Sarën, por Allahu nuk u kishte dhuruar fëmijë. Më pas u martua edhe me Haxheren, të cilës Allahu xhel-le she'nuhu ia kishte dhuruar Ismailin. Ibrahimim alejhis-selam kishte premtuar se nëse Allahu ia dhuron një djalë atë do ta bënte kurban.

Me urdhërin e Allahut xhel-le she'nuhu, Ibrahimim alejhis-selam e mori Haxheren dhe prej Palestine ku jetonte e çoi në Hixhaz dhe e la Haxheren me birin e saj të porsalindur, në vendin ku më vonë u ngritë Qabja.

Ai vend ishte një vend i shkretë, nuk kishte as ujë e as njerëz. Kur Ibrahimim deshi të largohej prej atij vendi, doli Haxherja para tij dhe tha: Pashë Zotin! Nga mendja jote po e bënë këtë apo Allahu të ka urdhëruar? Ai tha: Allahu më ka urdhëruar. Haxherja tha: Atëherë, Allahu nuk do të na humbas.

Më pas, Haxhereja filloi të kërkøjë ujë për djalin e saj të vogël. Aty afër ishin dy kodra të vogla: Safa dhe Merva. Haxherja herë shkonte në njérën kodër e herë në tjetrën me shpresë se do të shihte ndonjë burim uji. Këtë e bëri shtatë herë. Kur u kthyte Haxherja tek Ismaili, pa se si ai me këmëbët e veta kishte gjerryer rërën, nga e cila dilte ujë i pastër më vrull. Atëherë, Haxhereja tha: Zem Zem (ndalu ndalu) dhe burimi u qetësua.

Ibrahimim alejhis-selam, kohë pas kohe, prej Palestine vinte t'i vizitojë Haxheren dhe Ismailin. Sa më shumë rritej Ismaili aq më shumë shtohej dashuria e Ibrahimit ndaj tij. Nga kënaqësia më të birin e vet, Ibrahimim alejhis-selam sikur kishte qitur në harresë premtimin e dhënë se nëse Allahu do t'i jepte djalë, do ta bënte atë kurban për Të!

Allahu xhel-le she'nuhu në ëndërr tri herë ia kujtoi premtimin e dhënë Ibrahimit alejhis-selam për të birin.

Një ditë, Ibrahimim alejhis-selam i tha gruas së vet, Haxheres, që ta përgatisë të birin se do të shkojnë me të diku në vizitë. Nëna, duke mos ditur se ç'po përgatitej për të birin e saj, e veshi bukur dhe e përçolli me të atin. Sa u largua Ibrahimim me të birin, shejtani në formë të njeriut iu paraqit Haxheres,



duke i thënë se Ibrahim do t'ia therte të birin! Haxherja duke mos i besuar njeriut të panjohur, e përzuri atë saqë detyrohet ta gjuajë me gurë. Shejtani, tri herë në tre vende iu paraqit Haxheres dhe ajo tri herë duke e gjuajtur me gurë e përzuri atë.

Kur Ibrahim iu afra vendit ku kishte vendosur ta therte të birin, filloi t'i tregojë Ismailit se ka parë ëndërr se e therë atë, duke i thënë:

-Djaloshi im, mua në ëndërr më fanitet se unë ty të theri kurban! Çka thua ti për këtë ëndërr?

-Babë, bën atë çka të urdhëron Zoti, e unë do të duroj!

-M'i lidh sytë dhe therëm sa më shpejtë, që dhimbja të jetë sa më e lehtë!

Kur babë e birë iu dorëzuan urdhrit të Allahut, Ibrahim alejhis-selam e shtriu të birin me kokë për toke, me thikën e tij të mprehtë i ra qafës së Ismailit, por thika as gjurmë nuk la në qafën e tij. Atëherë, Ibrahim alejhis-selam edhe dy herë i ra qafës, por pa kurrfarë efekti. I hidhëruar me thikën që nuk priste, i ra gurit më të afërt, guri u çà përgjysmë. Ibarahimi i habitur i tha thikës:

- Thikë, e përgjysmon këtë gur të fortë e nuk e pret këtë qafë të butë!?

Në atë moment, Allahu xhel-le she'nuhu e thirri:

- Ibrahim, mjafton! Ti e realizove premtimin tënd dhe ëndrrën e bëre realitet.

Që vendimi për therje kurban të shkojë në vend, Allahu xhel-le she'nuhu ia zëvendësoi therjen e të birit me therjen e dashit, që ia solli meleku.

Ja kështu, Allahu xhel-le she'nuhu i shpërblen të sinqertit.

### Le të mendojmë dhe le të bisedojmë



1. Si quheshin gratë e Ibrahimit alejhis-selam?
2. Cilës grua Allahu xhel-le she'nuhu i dhuroi djalë?
3. Ku i vendosi Ibrahim, Haxheren me birin e saj?
4. Mes cilave kodra vraptonte Haxherja për të gjetur ujë?
5. Kur u kthyte Haxherja te biri i saj çka pa?
6. Çka i kishte premtuar Ibrahim alejhis-selam Allahut xhel-le she'nuhu?
7. Çka ndodhi mes Haxheres dhe shejtanit?
8. Si iu përgjigj Ismaili babait të tij kur i tregoj se do të therë kurban?
9. A u realizua therja e Ismailit?
10. Me çka Allahu e zëvendësoi Ismailin?
11. A e realizoi Ibrahim premtimin e dhënë?
12. Me çka Allahu e shpërblye atë?

## DATAT HISTORIKE ISLAME DHE NATA E KADRIT

Gjatë historisë islame ekzistojnë disa data historike, të cilat i kujtojnë muslimanët gjatë vitit.

Prej këtyre datave veçojmë:

- Viti i ri i hixhretit;
- Lindja e Muhamedit alejhis-selam (mevludi);
- Fitër Bajrami;
- Kurban Bajrami;
- Dita e Arafatit;
- Nata e Mi'raxhit;
- Nata e Kadrit.

Nata e Kadrit ose Lejletul Kadri është një ndër datat më të rëndësishme dhe më domethënëse. Kjo natë do të thotë “Nata e Caktimit”. Në këtë natë, Allahu i Madhëruar ka filluar t'i shpall Kuranin Muhamedit alejhis-selam. Prandaj, vlera e saj është sa njëmijë muaj tjerë. Muhamedi alejhis-selam ka kërkuar prej nesh që këtë natë ta presim në netët tek të 10-ditëshit të fundit të muajit të Ramazanit, dmth. në netët 21,23,25,27,29. Pra, është një nga netët teke. Gjatë saj, melekët zbresin me të gjitha vendimet hyjnore për çfarë do të ndodhë në Tokë brenda një viti. Gjatë kësaj nate hapen të gjitha dyert e mëshirës së Allahut xhel-le she'nuhu.

Nga ajo që mësuam më lart, pamë se vlera e kësaj nate është shumë e madhe, por vlera kryesore e saj qëndron në dy gjëra më të rëndësishme:

- Në këtë natë ka filluar shpallja e Kuranit dhe
- Në këtë natë melekët zbresin në tokë dhe luten për besimtarët.

Gjatë kësaj nate besimtari duhet të përkushtohet në:

- Faljen e namazit të natës;
- Leximin e Kur'anit;
- Dhikër ndaj Allahut në forma të llojlojshme;
- Lutje të ndryshme etj.

Gjatë kësaj nate duhet lexuar lutjen që na e ka mësuar Muhamedi alejhis-selam:


**“Allahumme inneke afuvvun tuhibbul afve fa'fu anni”.**

O Allah me të vërtetë Ti je Falës. E do faljen, pra, më fal mua.



### Le të mendojmë dhe le të bisedojmë

1. Trego disa nga datat më të rëndësishme në kalendarin islam?
2. Cila është nata më me vlerë gjatë vitit dhe pse llogaritet si e tillë?
3. Kur është nata e kadrit?
4. Si duhet të veprojë muslimani në këtë natë?
5. Përsërите lutjen që e ka përdorur Muhamedi alejhis-selam gjatë kësaj nate!





**PËRMBAJTJA**

Parathënie	4
<b>Tema I: Etika si shkencë për të mirën dhe moralin</b>	5
Etika	5
Kuptimi i etikës	9
Morali	12
Rëndësia e moralit	14
E mira si vlera më e lartë etike	15
<b>Tema II: Etika e religjioneve</b>	17
Principet e përbashkëta etike të mësimeve religjioze	17
Bazat teorike të ortodoksisë	21
Bazat etike të krishterizmit ortodoks	23
Bazat e moralit të krishterë ortodoks	25
Bazat teorike të mësimeve katolike	27
Bazat etike të mësimeve katolike	29
Bazat e moralit katolik	31
Bazat teorike të mësimeve evangjeliste – metodiste	33
Bazat etike të mësimeve evangjeliste – metodiste	36
Bazat e moralit evangjelist – metodist	39
Bazat teorike të hebraizmit	41
Bazat etike të hebraizmit	43
Morali në hebraizëm	45
<b>Tema III (zgjedhore): Etika në mësimin islam</b>	47
<b>Bazat teorike të islamit</b>	47
Bazat e mësimit islam (besimi islam)	49
Kushtet e bindjes (imanit)	49
Allahu xh.sh. në mësimin islam	53
Allahu dhe cilësitë e tij	54
Krijimi i njeriut të parë	56
Falënderimi drejtuar Alahut	57
Muhamedi alejhis-selam në mësimin islam	58
Jeta e Muhamedit alejhis-selam	59
Fillimi i shpalljes dhe thirrja në Mekë	61
Jeta e Muhamedit alejhis-selam në Medine dhe vdekja e tij	63
Kurani në mësimin islam	65
Kushtet e islamit në mësimin islam	68
Kushtet (shartet) e islamit	68
Pastërtia në mësimin islam	70
Avdesi	72
Gusli	74
Falja e namazit në mësimin islam	75
Zeqati në mësimin islam	76

Agjërimi i ramazanit në mësimin islam	77
Haxhi dhe lutjet në mësimin islam	80
<b>Aspekti etik në mësimin islam</b>	82
Etika islame në shkollë	82
Etika islame në jetën familijare	84
Etika islame gjatë ngrënies	86
Etika islame në punë	87
Etika islame gjatë përshëndetjes	88
Etika islame në xhami	89
Etika islame në veshje	93
Morali i individit në shoqëri	95
Përgjegjësia ndaj vetes dhe të tjerëve	96
<b>Bazat e moralit islam</b>	98
Cilësitë e besimtarit të mirë	98
Mbrojtja nga veprat e këqija	99
Pendimi prej veprave të këqija (tevbeja)	102
Sjellja islame dhe respekti gjatë festave	103
Festat dhe humaniteti i njeriut	106
Historiku i kurbanit dhe roli i tij	107
Datat historike islame dhe nata e kadrit	109
Përbatjtja	110